

Qershor 2012
Numri: 51
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 150 Lek
Kosovë: 1 Euro
Maqedoni: 60 Den



**DASHURI
MËSHIRË
DHE QETËSI**





Editorial

A ka probleme familja, te ne dhe në botë?

Pa dyshim që ka.

Treguesit e këtyre problemeve gjenden në jetën e të gjitha shoqërive, në atë masë që nuk mund të llogaritet.

Shumë shoqëri në botë, janë duke përjetuar atë katastrofë, që mund të cilësohet si konsumimi i familjeve.

Në shumë shoqëri të tjera, ku hyjnë edhe shoqëritë myslimane, mund të bëhet fjalë për humbje të koordinatave të familjes.

Në vend të vatrës së lumtur familjare, të cilën Kurani e shpreh me fjalët **“familje e qetë”**, pra të vatrës ku bashkëshortët janë prehje për njëri- tjetrin, janë duke ndodhur përherë e më shumë grindje, luftë ligjore ndarjesh, marrëdhënie të ftohta, shpërbërje dhe kriza.

Pra, me pak fjalë, në familje përjetohet pakësimi apo humbja e mëshirës.

Kjo do të thotë se ekziston një problem në burimin e dashurisë dhe mëshirës, në mesin e anëtarëve të familjes, pra një problem në marrëdhëniet me vetë Krijuesin.

Jo më kot edhe fjala hyjnore e ka shprehur dashurinë me fjalën “mevedetun”, ndërsa mëshira është shprehur me fjalën “rahmetun”.

E vërteta është se problemet nisin në marrëdhëniet mes njeriut dhe Krijuesit, atëherë kur fillon të dobësohet dhe të këputet lidhja që krijohet si rrjedhojë e krijimit.

Kjo vlen, jo vetëm për familjen, por edhe për shoqërinë.

Do të ishte mashtrim i madh, në qoftë se pohohet se njeriu ka marrëdhënie me Krijuesin, por nuk ka lidhje me familjen dhe shoqërinë.

Siç ekziston një “ligj” i Krijuesit për njeriun dhe objektin, ekziston edhe një “ligj” i Tij, në lidhje me rrjedhën e shoqërive. Kurani na ofron edhe kyçin e reflektimeve të “ligjit të Allahut”, në lidhje me këtë fushë. Në ajetin 21, të sures Rum, përcillen edhe elementët që përfshijnë këto zgjidhe.

“Argumente që tregojnë ekzistencën e Zotit janë faktet se Ai krijoi nga lloji juaj bashkëshortet tuaja, që të gjeni prehjen tek to dhe vendosi në mesin tuaj dashurinë dhe mëshirën. Nuk ka dyshim se këto janë mësimet e qarta për një popull që mendon.” (Rum, 21.)

Fjala mevedet (dashuri) vjen nga atributi i Allahut, që është Vedud.

Fjala rahmet vjen nga atributet e Allahut, që janë Rrahman dhe Rrahim.

Pra, në qoftë se do të ndërtojmë mëshirën dhe rahmetin në familje, kjo do të thotë se ne jemi të detyruar që mëshirën dhe rahmetin, ta lidhim me burimin bazë.

Në qoftë se pyetet: **“Cila është lidhja e njeriut me këtë burim kryesor?”**, përgjigja është lidhja e “robërisë së njeriut ndaj Zotit.”

Kjo do të thotë se njerëzit nuk duhet ta harrojnë lidhjen e robërisë së tyre ndaj Zotit, në mënyrë që të formojnë një klimë dashurie dhe mëshire në kornizën e familjes.

Do të lexoni:




- Ahmet Tashgetiren / 4** Trekëndëshi i artë dashuri, mëshirë dhe qetësi
- Ma. Valjeta Bajraktari / 7** Të rinjtë në përballje me sfidat e kohës
- Vehap S. Kola / 8** Familja tradicionale, familja islame
- Prof. dr. Sadije Bushati / 11** Interneti në familje
- Salih Zeki Meriç / 14** Je mysafir në këtë shtëpi, o zemër!
- Prof. dr. Mustafa Nutku / 15** Jeta përbëhet nga çasti në të cilin jetojmë
- Edison Çeraj / 16** Metafizika e "asgjësë"
- Ali Riza Temel / 18** Kush është më e rëndësishme për lumturinë, pamja apo natyra e njeriut?
- M. Sami Ramazanogllu / 21** Shenjat e një familjeje të lumtur
- Nuredin Nazarko / 22** Familja në perspektivën e realitetit
- Mustafa Erish / 24** Kalorësi më i mirë Ukkashe ibn Mihsani (r.a.)
- Shaban Ishlek / 26** Rëndësia e familjes dhe edukimi i rinisë
- Nureddin Jëlldëz / 31** Problemi më i vjetër

Ahmet Tashgetiren



4

Edison Çeraj



16

Shaban Ishlek



26

Viti: VI | Numri: 51 | Qershor 2012

Drejtor & Kryeredaktor:

Alban Kali

albankali@yahoo.com

+355 67 20 86767

Redaktor:

Zija Vukaj

Korrektore:

Ma. Irida Hoti

Përkthyesit:

Albert Halili / Artur Tagani

Fatmir Sulaj / Ilir Hoxha

Dizajn-Grafik:

Bledar Xama

Për artikuj:

e-mail: revistaetika@progresibotime.com

e-mail: kosova@progresibotime.com

e-mail: maqedoni@progresibotime.com

Qershor 2012

40

Osman Nuri Topbash



Udhëzimi i Kuranit
për paqen familjare

32/ Dr. Adem Ergyl

Leximi i ajetit Kursij

34 / Xhafer Durmush

Fotoja e Muajit

36 /

Një ajet - Një hadith

38-39 /

Zotëruesi i Kuranit

40 / Osman Nuri Topbash

Vlerësimi në nivel shkolle
domosdoshmëri për rritjen e cilësisë

46 / Kujtim Dervishi

Gruaja shqiptare, faktor i rëndësishëm
në konsolidimin e familjes
dhe vlerave të saj

48 / Zenepe Dibra

Kultura e paqes në fenë islame

50 / Soc. Raimonda Draçini

Mosha e tretë dhe respekti ndaj saj,
vlerë e shoqërisë shqiptare

53 / Donika Selimi

Menaxhimi sjelljeve
të papëlqyeshme të fëmijëve

54 / Prof. as. dr. Fatmir Vadahi

Esma-i Husna

57 / Dr. Metin Jurdagyr

Ajetet dhe Suret e Kuranit

58 / Ma. Gilman Kazazi

Kryengritja e patrona Halilit

60 / Ma. Ermal Nurja

Arti Islam

62 / Ma. Artur Tagani

Namazi me imam, namazi i Xhumasë
dhe namazi i Bajrameve

64 / Ma. sci. Flamur Sofiu

Vlera e punës në Islam

70 / Imam Naim Drijaj

54

Prof. as. dr. Fatmir Vadahi



64

Ma. sci. Flamur Sofiu



PROGRESI
BOTIME
www.progresibotime.com

Adresa:

**L: Vasil Shanto / Rr: Çajupi
Shkodër / Albania
Tel: +355 22 254 634
Fax: +355 22 254 633**

Zyra e përfaqësimit Maqedoni

Rr. Stiv Naumov / nr. 9 / lokal 25
Shkup / Maqedoni
+389 71 956 271

Zyra e përfaqësimit Kosovë:


Rr. Ardian Zurnaxhiu / pn. Ralin
Prizren / Kosovë
Tel: +381 29 222 795
Fax: +381 29 222 797
+377 4411 98 48

Çmimi:

**Shqipëri: 150 Lekë
Abonim (një vjetor): 1500 Lekë
Kosovë: 1 Euro
Abonim (një vjetor): 10 Euro
Maqedoni: 60 DEN
Abonim (një vjetor): 720 DEN
Europë: 2 Euro
Abonim (një vjetor): 24 Euro**

TREKËNDËSHI I ARTË: DASHURI, MËSHIRË DHE QETËSI!

Ahmet Jashgetiren



Duhet të kemi të qartë se kjo punë, ashtu si çdo punë tjetër, varet nga Allahu, sepse:

Allahu krijoi secilin prej dy bashkëshortëve.

Allahu krijoi dashurinë mes bashkëshortëve.

Allahu vendosi mëshirën mes bashkëshortëve.

Falë dhurimit hyjnor, u arrit dhe do të arrihet qetësia dhe prehja.

Duhet menduar dhe kuptuar se kjo është nga ato punë, që ka të bëjë me të gjithë shoqërinë.

Duhet menduar dhe kuptuar shumë mirë se një shoqëri, që mendon thellë rreth vazhdimësisë së saj, ka shumë për të mësuar nga këto të vërteta të jetës.

Fjala hyjnore e vë familjen mbi baza të atilla, sa e fton

të gjithë shoqërinë të mendojë gjerë e gjatë, në lidhje me çështjen e **familjes**, ashtu siç ndodhi, për shembull, në ajetin që cituam në fillim të artikullit.

Në këtë kontekst, nga fjala hyjnore kuptojmë se çështja nuk duhet trajtuar sipërfaqësisht, se çështja nuk fillon dhe mbaron me individët apo se është një çështje individuale që mbyllet brenda mureve të një familjeje, prandaj edhe përsiatja mbi këtë çështje, do ta shpjerë shoqërinë drejt të kuptuarit më të mirë të fenomenit familje dhe duhet ta çojë në këtë pikë, ashtu siç e thotë edhe fjala hyjnore.

Kjo do të thotë se shoqëria duhet të interesohet për faktin që në një familje nuk ka dashuri ose sundon marrëdhënia e ftohtë mes anëtarëve të saj.

Kjo do të thotë se shoqëria duhet të interesohet përse në një familje nuk ka mëshirë, por dhunë brenda saj.

Në qoftë se **në një familje ka dhimbje**, kjo do të thotë që shoqëria është candidate për të përjetuar dhimbje.

Atëherë, mund të arrihet te ky përfundim: në qoftë se në një shoqëri myslimane ka **familje me probleme**, pavarësisht se çfarë ndodh në pjesën tjetër të botës, kjo ndodh se myslimanët nuk tregohen të kujdesshëm në

lidhje me koordinatat që përmenden në fjalën hyjnore.

A ka probleme familja, te ne dhe në botë?

Pa dyshim që ka.

Treguesit e këtyre problemeve gjenden në jetën e të gjitha shoqërive, në atë masë që nuk mund të llogaritet.

Shumë shoqëri në botë, janë duke përjetuar atë katastrofë, që mund të cilësohet si konsumimi i familjeve.

Në shumë shoqëri të tjera, ku hyjnë edhe shoqëritë myslimane, mund të bëhet fjalë për humbje të koordinatave të familjes.

Në vend të vatrës së lumtur familjare, të cilën Kurani e shpreh me fjalët **“familje e qetë”**, pra të vatrës ku bashkëshortët janë prehje për njëri-tjetrin, janë duke ndodhur përherë e më shumë grindje, luftë ligjore ndarjesh, marrëdhënie të ftohta, shpërbërje dhe kriza.

Pra, me pak fjalë, në familje përjetohet pakësimi apo humbja e mëshirës.

Kjo do të thotë se ekziston një problem në burimin e dashurisë dhe mëshirës, në mesin e anëtarëve të familjes, pra një problem në marrëdhëniet me vetë Krijuesin.

Jo më kot edhe fjala hyjnore e ka shprehur dashurinë me fjalën “mevedetun”, ndërsa mëshira është shprehur me fjalën “rahmetun”.

E vërteta është se problemet nisin në marrëdhëniet mes njeriut dhe Krijuesit, atëherë kur fillon të dobësohet dhe të këputet lidhja që krijohet si rrjedhojë e krijimit.

Kjo vlen, jo vetëm për familjen, por edhe për shoqërinë.

Do të ishte mashtrim i madh, në qoftë se pohohet se njeriu ka marrëdhënie me Krijuesin, por nuk ka lidhje me familjen dhe shoqërinë.

Siç ekziston një “ligj” i Krijuesit për njeriun dhe objektin, ekziston edhe një “ligj” i Tij, në lidhje me rrjedhën e shoqërive. Kurani na ofron edhe kyçin e reflektimeve të “ligjit të Allahut”, në lidhje me këtë fushë. Në ajetin 21, të sures Rum, përcillen edhe elementët që përfshijnë këto zgjidhe.

Fjala mevedet (dashuri) vjen nga atributi i Allahut, që është Vedud.

Fjala rahmet vjen nga atributet e Allahut, që janë Rrahman dhe Rrahim.

Pra, në qoftë se do të ndërtojmë mëshirën dhe rahmetin në familje, kjo do të thotë se ne jemi të detyruar që mëshirën dhe rahmetin, ta lidhim me burimin bazë.

Në qoftë se pyetet: **“Cila është lidhja e njeriut me këtë**



Në qoftë se zemra

*nuk është e ngopur me dashuri dhe mëshirë,
si të jetë zhytur mirë e mirë në bojë,
atëherë të gjitha njësitë shoqërore,
që kanë të bëjnë me edukimin, siç janë
familja, shkolla, xhamia, media etj.,
e kanë të detyrueshme të marrin përsipër
misionin e veshjes së zemrave
me dashuri dhe mëshirë.*

**bu-
r i m
kryesor?”**,
përgjigja
është lidhja
e “robërisë
së njeriut
ndaj Zotit.”

Kjo do të thotë se njerëzit nuk duhet ta harrojnë lidhjen e robërisë së tyre ndaj Zotit, në mënyrë që të formojnë një klimë dashurie dhe mëshire në kornizën e familjes.

Çfarë do të thotë të mos harrosh marrëdhënien e robërisë së njeriut ndaj Zotit, brenda familjes?

Përgjigja e kësaj pyetjeje është të shndërrosh mjedisin e familjes në një mjedis **“pushtet”**. Mjedisin e familjes është mjedisi, në të cilin të gjithë anëtarët janë në statusin e robit të Zotit. Në qoftë se individët e një shoqërie, cilido qoftë statusi i tyre, të pasur ose të varfër, të shëndoshë ose të sëmurë, drejtues apo vartës, janë në statusin e **“robit të Zotit”** dhe nuk i rregullojnë marrëdhëniet mes tyre si të ishin fuqi hyjnore, Zot na ruaj!

Në qoftë se **“ndërgjegjësimi i robërisë”** vendoset në zemra sa duhet, atëherë realizohet edhe një gjë tjetër: ndërgjegjësimi i jetës nën kontrollin dhe nën vërtetimin e Allahut. Me fjalë të tjera, ndërgjegjësimi që i dërguari i Allahut e ka shprehur me fjalët **“të jetosh sikur je duke e parë Allahun”**. Atëherë hyn në mes edhe një lloj kërkimi, siç është kërkimi për të fituar kënaqësinë e Zotit. Fillon kërkimi për **“qetësi dhe prehje”**, si rezultat i përjetimit të **“dashurisë dhe rahmetit”**, të cilat Zoti i konsideron si

të domosdoshme për jetën bashkëshortore.

“Ndërgjegjësimi tek njeriu se ai është rob i Zotit”, e bën individin më të ndjeshëm edhe ndaj “të drejtave së të tjerëve.” E drejta e tjetrit është mbase ajo gjë, që nënvleftësohet më shpesh në një mjedis familjar. Qasja se bashkëshortët janë bërë një me njëri-tjetrin në çdo aspekt, kështu që nuk kanë ç’ të kërkojnë të drejtat e tyre tek njëri-tjetri, nuk është e drejtë. Meqë **“regjistri i punëve të kryera”** është i veçantë për çdo person dhe, në ditën e gjykimit, secili njeri ka për të dhënë llogari për ato që ka punuar në këtë botë, do të thotë se secili ka të drejtat që i takojnë.

Edhe në qoftë se në këtë botë nuk jepet llogari për fjalët apo veprimet e dhunshme, mungesën e ligjit dhe gjynahet në mes të çiftit bashkëshortor, në botën tjetër secili ka për të dhënë se s’bën llogari për atë që ka punuar. Edhe nëse në këtë botë nuk ka marrëdhënie marrje-dhënie huash, në jetën tjetër ka për të ekzistuar një marrëdhënie huadhënieje dhe huamarrjeje gjatë dhënies llogari.

Për këtë arsye, në momentin e caktuar të ndarjes, kërkohet “hallallëku”. Kjo nuk është aspak diçka formale. Kur bëhet fjalë **“për të drejtat e njeriut”,** përpara të drejtës hyjnore, feja islame na mëson se nuk ka për të pasur as favorin më të vogël për mashkullin apo për femrën. Kjo është shumë e rëndësishme për një shoqëri që “mendon mirë”.

Për t’u realizuar “qetësia dhe prehja në familje”, kushti themelor është që bashkëshortët të ushqejnë **“dashuri”** dhe **“mëshirë”** për njëri-tjetrin.

Nga ajeti mësojmë se Krijuesi e ka krijuar, si mashkullin, ashtu edhe femrën me aftësinë që të ushqejnë në zemrat e tyre këto dy ndjenja, madje janë të përshtatshëm për këtë gjë.

Po kështu, nga ky ajet mësojmë se, kur çifti bashkëshortor hyn poshtë çatisë hyjnore, ai e pasuron edhe më shumë potencialin e dashurisë dhe të mëshirës që ka në zemër.

Pra, të arrish dashurinë, mëshirën dhe bashkë me to, qetësinë gjatë jetës bashkëshortore, nënkupton edhe një shfaqje të veçantë të dhuntisë hyjnore, ngaqë kjo do të thotë se është vënë në jetë edhe një tjetër ajet i Zotit.

Ajo që kuptojmë është se, në qoftë se njeriu është i drejtuar me të vërtetë drejt fitimit të kënaqësisë së Zotit, atëherë ai i është drejtuar njëkohësisht edhe dashurisë edhe mëshirës. Pra, mungesa e dashurisë dhe e mëshirës brenda jetës familjare, do të thotë t’i pritët rruga dashurisë dhe mëshirës që dhuron Allahu, madje edhe më keq, do të thotë të pengosh shirat e mëshirës, që të lagin zemrat.

Një tjetër gjë, që mësojmë nga ajeti, është të jemi të vullnetshëm që të realizojmë një udhëtim drejt dashurisë dhe mëshirës, atëherë kur vendosim të hyjmë në botën e të martuarve.

Në qoftë se zemra nuk është e ngopur me dashuri dhe mëshirë, si të jetë zhytur mirë e mirë në bojë, atëherë të gjitha njësitë shoqërore, që kanë të bëjnë me edukimin, siç janë familja, shkolla, xhamia, media etj., e kanë të detyrueshme të marrin përsipër misionin e veshjes së zemrave me dashuri dhe mëshirë.

Edukimi i dashurisë... Edukimi i rahmetit dhe mëshirës...

Që zemrat të marrin hise nga dashuria dhe mëshira hyjnore...

Veshja me shfaqjet etributeve hyjnore...

Nuk duhet harruar se ky dimension i dashurisë dhe mëshirës, është i ndryshëm nga dashuria dhe mëshira, që konsumohet veçanërisht në shekullin tonë, në marrëdhëniet mes femrës dhe mashkullit.

Pra, tek dashuria dhe mëshira duhet kërkuar dimensionin hyjnor. Për këtë arsye, zemrat duhet të jenë gati dhe të përshtatshme për shfaqjet e Rrahmanit, Rrahimit dhe Vedudit.

Për këtë arsye, gjuhët dhe zemrat duhen drejtuar ndaj dergjahut hyjnor, për t’iu lutur Allahut dhe për t’iu përgjyruar Atij.

Dashuria dhe mëshira në familje, është padyshim një punë e mundimshme...

Të parët që do të kontribuojnë në ngritjen e një mjedisi plot dashuri dhe mëshirë, janë bashkëshortët...

Ata do t’i edukojnë fëmijët në këtë klimë mëshire dhe dashurie, në mënyrë që, kur të rriten, të jenë të përgatitur dhe t’i kenë zemrat plot dashuri dhe mëshirë, kur të krijojnë familjet e tyre të ardhshme.

Nga ky aspekt, familja është mësonjëtorja e dashurisë dhe e mëshirës.

Qetësia dhe prehja në familje, janë dhuratë hyjnore.

Dhurata hyjnore mbërrin tek ai që nuk ia pret rrugën asaj, me mungesë dashurie dhe mëshire. Prova e kësaj jete ka të bëjë me faktin se sa të hapura janë zemrat tona përpara kësaj dhurate hyjnore.

Këtu nisin dhe rrugët e asaj që ne e quajmë **“lumturia e dy botëve”**.

Zoti bëftë që familjet tona edhe si bashkëshortë edhe me fëmijët e tyre, të krijojnë atë klimë shpirtërore, që do t’i shpjerë drejt lumturisë së dy botëve!

Amin.



TË RINJTË NË PËRBALLJE ME SFIDAT E KOHËS

Ma. Valjeta Bajraktari

Realiteti i sotëm na përball me sfida nga më të ndryshmet, në vorbullën e të cilave bëjmë pjesë secili prej nesh, por gjenerata më e prekshme është ajo e të rinjve.

Zhvillimet e vullshme ekonomike, sociale, teknologjike na vënë përpara disa përgjegjësi mjaft të mëdha, të cilat në detyrën si prind dhe mësues, na ftojnë të kuptojmë sfidat e realitetit të sotëm, si dhe t'i nxisim fëmijët tanë drejt së ardhmes së tyre me një përkushtim e vetëbesim.

Një shprehje e pedagogut të njohur Hamit Beqja thotë: *"...personaliteti njerëzor formohet dhe afirmohet në jetë si një dukuri shumë e pasur dhe shumë e ndërlikuar shumëfaktorësh, shumëkohësh, shumëvlerëshe e polivalente..."*

Shoqëria, shkolla dhe familja janë faktorë me shumë rëndësi për edukimin e mirë të fëmijëve. Është shumë e rëndësishme të krijohet një koncept më i qartë rreth partneritetit mësues – nxënës – prindër, që ka si synim kryesor përparimin e të rinjve dhe përgatitjen e tyre sa më të mirë për t'u përballur me sfidat e shumta që u dalin përpara.

Por cilat janë disa nga sfidat, me të cilat përballen të rinjtë tanë?

Së pari, shkollimi, një temë mjaft e ndjeshme mes prindërve dhe vetë fëmijëve. Përmes shkollës, thellohen dijet për botën që na rrethon dhe njëkohësisht formohet personaliteti.

- Sa të rinj kanë dëshirë të mësojnë sot, e aq më tepër, të interesohen për perspektivën e tyre?

- Sa të rinj kërkojnë përballjen me sfidën e botës akademike?

- Sa të rinj e vlerësojnë shkollimin?

Së dyti, vetëbesimi është një hallkë kyçe, drejt së cilës çdo i ri duhet të kërkojë të arrijë të bëhet i vlefshëm në shoqëri. *"Vetëvlerësimi është të rimësuarit për të menduar në mënyrë afektive për veten. Ai përbën një aftësi që mund të fitohet. Të paktë janë ata që e zotërojnë natyrshëm."*¹ Një mungesë vetëbesimi çon në aftësi të kufizuara biseduese dhe ankth social. Ndrojtja mund të bëhet armiku më i keq i fëmijës, duke vepruar në mënyrë insinktive e të pamatur, duke krijuar një hendek mes ndërgjegjësimit dhe pasigurisë e, për rrjedhojë, mosbesim të vetja e tyre. Atëherë, le t'i vlerësojmë fëmijët tanë e t'i bëjmë të jenë vetëbesues e madje vendim-marrës.

Së treti, zgjedhja e degës në universitet është një tjetër sfidë me të cilën përballen të rinjtë sot. Zgjedhja e profesionit fillon me dëshirën që ata kanë pas përfundimit të

maturës. Në këtë sfidë, një rol të rëndësishëm luan prindi, por sa mundet prindi të ndihmojë fëmijën e tij? A duhet të influencojë në zgjedhjet e tij?

Prindi i sotëm është dhe s'është i informuar me ndryshimet e vullshme të kurrikulave a kriterëve, të cilat, si "të vështira" për t'u kuptuar, i kushtëzojnë prindërit të jenë konfuzë dhe në të shumtën e rasteve, të priren drejt Degëve të Mëdha, e jo drejt prirjes së fëmijës. I riu nga ana tjetër, ndikohet edhe nga përzgjedhjet e shoqërisë, duke mos kërkuar prirjen e tij... apo një përballje sfide me vetveten.

- Sa të rinj pyesin veten: A jam i aftë të konkuroj, të fitoj dhe të realizoj ëndrrën time?

- Sa janë realisht të qartë për perspektivën e profesionit, ku dëshirojnë të ushtrojnë dijet e tyre profesionale?

Së katërti, diplomimi dhe studimet pasuniversitare, një sfidë tjetër që e ngushton ose e zgjeron marrëdhënien prind – fëmijë. Kjo përballje e re e bën të riun ose ambicioz, ose indiferent. Në rastin e parë kemi një të ri, i cili është i qartë në rrugën e ndërmarrë dhe kërkon me çdo kusht të arrijë përplotësimin e kriterëve të veta. Në rastin e dytë, ku bëjnë pjesë shumica e të rinjve, duke arritur në shkallët e universitetit mendojnë se ato ngjiten vetë. Kjo i bën ato të çalë në rrugëtimin e tyre akademik dhe për rrjedhojë, të sfiduar nga realiteti i sotëm, i cili kërkon njerëz punëtorë, të aftë dhe kërkues të vazhdueshëm.

Modeli i një të riu në përballje me sfidat e realitetit të sotëm, është sa kompleks, aq edhe një realitet i brishtë, ku herë – herë modelet e përzgjedhura nga vetë ata ... nuk janë prindërit, por shoqëria. Komplexiteti qëndron pikërisht në përballjen e tyre me sfidat e kohës: provimet e maturës shtetërore, përzgjedhja e degës së studimit, diplomimi, studimet pasuniversitare, punësimi etj., sfida këto jo të lehta për çdo njeri.

Pyetjet e shtruara më sipër, në lidhje me sfidat me të cilat përballen të rinjtë sot, janë pyetje të cilat kërkojnë përgjigje të një sërë pyetjeve të tjera: Sa?, Si?, Pse?, të cilat kërkojnë informim të mirë, ndërgjegjësimit të të riut, si dhe shumë përgjegjësi për të qenë në kërkim të shfaqjes së dijeve të tij, të marra në vite të shumta shkollimi, si dhe një angazhim për të kërkuar një të ardhme të sigurt për veten e tyre, duke u bërë individë të dobishëm e të vlefshëm për shoqërinë.

Vetvetiu, përgjigjja e pyetjeve të mësipërme qëndron në binomin **Formim-Vlerësim**, të një procesi të mësuarit, i cili zgjat gjatë gjithë jetës së njeriut.

1. Gëzim Dibra, *Vetëvlerësimi i ulët dhe pasojat psikologjike te njerëzit*, Buletin Shkencor, nr. 58., Shkodër, 2008, f. 101.

FAMILJA TRADICIONALE FAMILJA ISLAME

Vehap S. Kola

Nëse vendosim të flasim për familjen, do të kemi gjithnjë ndërmend vetëm dy forma të saj: familjen shekullare dhe familjen myslimane, pasi vetëm këto dy botëkuptime kanë krijuar një model të familjes. Familja shekullare është një lëshim i detyruar i botëkuptimit materialist nga nevoja për të organizuar shoqërisht dhe ekonomikisht jetën e tij. I paaftë për të edukuar individët në laboratorin e madh social, për të menaxhuar ekonominë në nivel individual dhe për të përballur pasojat e papërgjegjshmërisë së jetës jashtëmartesore, botëvështrimi materialist vendos të pranojë një formë të reduktuar të familjes. Nga pikëpamja teorike e materializmit, nuk mund të gjejmë asnjë premisë për ekzistencën dhe funksionimin e familjes si të tillë. Sidoqoftë, familja moderne i ngjan më shumë një sipërmarrjeje të braktisur, një nisme të lënë në mes, sesa një synimi të mirëfilltë, të cilit i shërbehet sistematikisht.

Modeli i dytë është familja islame. Arsyeja pse Islami ka një model për familjen, është shumë e thjeshtë: sepse familja është një institucion origjinalisht dhe ekskluzivisht islam. Shtjellimi i këtij argumenti nuk është në qëllimin e kësaj trajtесе. Një argumentim i pakundërshtueshëm dhe mahnitës i kësaj teze është kryer nga i ndjeri Alija Izetbegoviç, në veprën e tij "Islami ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit". Qëllimi i kësaj esejeje është të trajtojë fatin dhe sfidat e familjes myslimane në Shqipëri.

FAMILJA SHQIPTARE NË DIKTATURË

Instalimi i diktaturës komuniste në vitin 1945 në Shqipëri, ishte guri i themelit të një botëkuptimi të ri, që ngriti ngrehinën e tij të mendimit dhe veprimit zyrtar e të kulturës masive në vend. Me një bazë të fortë ideologjike dhe me një eufori tipike revolucionare, aparatura e re qeverisëse filloi menjëherë me uzurpimin e prerogativave të nënës dhe kompetencave të familjes, përmes ideologjizimit të nxënësve dhe ngritjes së mi-teve të udhëheqësit të dashur e nënës parti.

Nuk ishte aspak e befasishme që reforma në mendim të niste me pozitën dhe rolin e gruas në shoqërinë e re. Me plot gojën mund të thuhet se pavendosmëria ishte tipari kryesor i qëndrimit komunist ndaj gruas, duke shfrytëzuar padrejtësitë e vuajtura nga pjesëtarët femra të shoqërisë shqiptare të paraluftës së dytë botërore. Nga njëra anë, gruaja duhej të ishte një nënë pjellore që do të lindte djem luftëtarë dhe vajza të bukura (motive tipike folklorike, një shfrytëzim i nacionalizmit për qëllime të ngushta politike), çka thekson, vetvetiu, rolin dhe detyrimin qendror familjar të gruas. Ndërkohë, ajo duhej të punonte krah për krah burrit, me të njëjtat të drejta dhe detyrime, pasi të dy ishin të barabartë dhe njësoj të aftë për të ndërtuar atdheun e ri socialist. Në këtë mënyrë, gruaja ishte ngarkuar me një përgjegjësi të dyfishtë dhe të troshitur. Periudha e paqes pas përfundimit të luftës, favorizoi uljen e vdekshmërisë së fëmijëve dhe rritjen e prodhimit, por shpejt urbanizimi uli lindshmërinë. Përfundimisht, troshitja midis dy roleve të papërputhshme, e çoi gruan shqiptare drejt dështimit në rolin e saj të nënës. Ajo vendosi të heqë dorë nga roli i saj i natyrshëm dhe të pranojë rolin e ri: si e barabarta e burrit në jetën ekonomike, politike dhe sociale.

Familjet e shterrura emocionalisht dhe shpirtërisht, u shndërruan në fjetina dhe njësi ekonomike, gjersa prodhuan probleme të pakthyeshme emocionale, mendore dhe sociale të fëmijëve. Trajtimi i foshnjeve në çerdhet shtetërore me programe standard, që nuk përfshinin më shumë se strehimin, ushqimin dhe kujdesin shëndetësor, nuk mund të sillte pasojat tjera përveç krijimit të qenieve monsturoze dhe egocentrike. Se

çfarë mund të shkaktonte ky shformim i individit në jetën shoqërore, do të shihej disa dekada më vonë, kur kërcërimi i ligjit të ashpër të reshtte së ekzistuari.

Një tjetër problem i krijuar nga mendimi i ri zyrtar dhe nga kultura masive, ishte zbehja e rolit të babait dhe zëvendësimi gradual me rolin e udhëheqësit të dashur, i cili mendon për të gjithë si për fëmijët e tij. Duke imituar Zotin, ideologjia komuniste u rrëmben prindërve role të rëndësishme në emër të parimeve të reja dhe u jep fëmijëve të drejtë t'i gjykojnë prindërit e tyre sipas paradigmës së re e të relativizojnë figurën e tyre. Kësisoj, këto pikë vlerësimi i transferohen partisë dhe udhëheqësit.

Sipërmarrja më e pamundur e diktaturës karshi familjes shqiptare, ishte orvatja për të ndërtuar një moral pa Zot. Në mungesë të motivit të vërtetë, të përhershëm dhe të besueshëm, që mund ta bënte të vlefshëm përmasën morale të njeriut, shteti përdori shtrëngimin ligjor dhe terrorin për të shmangur veset dhe veprat penale. Por, ndërsa veprat penale me pasoja konkrete ekonomike apo të sigurisë mund të kundërbalancoheshin përmes sanksioneve, degradimi moral dhe zvetërimi i karakterit të individit, që nuk përbënin ndonjë vepër penale, nuk mund të kuroheshin pa Zot. Së këndejmi, gjatë asaj periudhe u ruajt një nivel i lartë si-gurie dhe korrektese nga pjesa dërrmuese e popullsisë, por u shpërbënë tërësisht fibrat moralë që mbanin të lidhur jetën në familje dhe forconin solidaritetin shoqëror.

Në konkluzion të kësaj analize të gjendjes së familjes gjatë periudhës së diktaturës, mund të përmbledhim se ajo çfarë bëri më shumë diktatura ishte ngulitja e themeleve të një skene, ku do të luhej tragjedia më e madhe e familjes shqiptare prej sa mbahet mend. Duke ndalur me dhunë thjesht vënien në skenë të kësaj tragjedie, diktatura arrinte të bindte lehtësisht njerëzit se ajo ishte mbrojtësja e vërtetë e vlerave morale dhe pasurisë shpirtërore të kombit. Se çfarë dëmsh të pariparueshme kishte shkaktuar komunizmi në strukturën dhe substancën e familjes, kjo do të kuptohej vetëm

pasi ngrehina e amortizuar e terrorit të plandosej në tokë në fillim të viteve 1990.

FAMILJA SHQIPTARE NË TRANZICION

Rrëzimi i diktaturës dhe shpallja e pluralizmit politik në vitin 1990, nxori në pah dëmet e pandreqshme që ajo i kishte shkaktuar familjes shqiptare. Nëse diktatura me tërësinë e mendimit, institucioneve, metodave dhe instrumentave të saj i dha goditjen më të rëndë familjes tradicionale shqiptare, tranzicioni që nisi me ndryshimet politike të viteve 1990-1992, shërbeu si faza e fundit e çinte grimit dhe shformimit vështirësisht të kthyeshmë të saj.



Familjet e shterrura emocionalisht dhe shpirtërisht, u shndërruan në fjetina dhe njësi ekonomike, gjersa prodhuan probleme të pakthyeshme emocionale, mendore dhe sociale të fëmijëve.

Në tranzicion, familja shqiptare vijoi të ruante problematikën e papërcaktueshmërisë së rolit të gruas dhe zvetënit të fibrit moral të shoqërisë. Ndonëse papunësia e shkaktuar nga shoku ekonomik e detyroi gruan të kthehej në pozitën e shtëpiakes, ajo ishte pothuaj e paaftë për të kuptuar, pranuar dhe aktualizuar rolin e saj si nënë dhe edukatore e fëmijëve. Ajo nuk ka as kultivimin moral, formimin intelektual, as disiplinën shpirtërore të nevojshme për të rrokur kompleksitetin e misionit të edukimit të fëmijëve, përtej plotësimit të nevojave të jetesës dhe sigurimit të mundësive për arsimim e formim profesional.

Gjatë kësaj kohe, familjes shqiptare iu shtuan edhe një listë e gjatë problemesh dhe kërcënimesh.

Një ushtri të divorcuarish dhe të pamartuarish në moshë të pjekur dhe të thyer i kanë dhënë shoqërisë tipare të thella individualiste dhe një ngjyresë të fortë vetmie e anomie. Bindja e përhapur gjerësisht se martesë është një përgjegjësi që duhet menduar gjatë dhe që kërkon kohë për ta pranuar, konditat e shtuara ekonomike dhe sociale për të realizuar një martesë mesatare, si dhe forma të reja të jetës ndërgjigjnore jashtëmartesore e ndesh institucionit tradicional të martesës, i kanë dhënë një dorë të madhe ndihme kësaj dukurie të re.

Ashtu siç është përvijuar më lart, tranzicioni e gjeti familjen shqiptare me një fibër moral tërësisht të shpërbërë. Kësisoj, imuniteti i saj ndaj çdo forme të re të degjenerimit dhe zvetënimit, që buron nga sulmi konsumerist dhe nga botëkuptimi (dhe jeta) pa Zot e modernitetit, ishte tërësisht i pamjaftueshëm për të garantuar vazhdimësinë e shëndetshme dhe të vërtetë të saj. Mungesa e fibrës moral reflektohet në një përhapje të gjerë të dukurive të korrupsionit dhe krimit, të mosdhënies së drejtësisë nga sistemi gjyqësor dhe të qeverisjes klienteliste.

Familjet shqiptare të periudhës së tranzicionit nuk janë të afta të shërbejnë si elementë bazë komunitarë dhe nxitëse të frymës së bashkekzistimit dhe bashkëndarjes me fqinjët dhe fafesisin. Solidariteti, edhe ashtu i cunguar, i 50-viteve të diktaturës komuniste i ka lënë vendin kaosit shoqëror dhe individualitetit. Pothuaj, nuk mund të gjesh asnjë lagje apo komunitet në Shqipëri që të dëshmojë kujdes dhe vlerësim për pasuritë dhe të drejtat e përbashkëta, që nga infrastruktura, mjedisi apo rendi publik. Sakaq, janë të rralla ato komunitete që kanë ngritur institucione dhe infrastrukture sociale e shpirtërore të përbashkët. Shumica e objekteve të kultit janë ngritur dhe administrohen me ndihmën e donatorëve të huaj dhe të organizatave të financuara nga jashtë komunitetit përkatës. Mobilizuesit më të mëdhenj dhe kryesorë të komuniteteve janë partitë politike, kurse vullnetarizmi apo vetorganizimi shihen si tabu dhe propozime jo aq të mençura.

FAMILJA MYSLIMANE SI MUNDËSI

Familja myslimane, prej shumë kohësh, shihet si një formë arkaike e organizimit të njerëzve, veçanërisht kur asaj i mvishen tipare rurale, e destinuar për t'iu nënshtruar modernizimit dhe tjetërsimit të natyrës së saj. Po çfarë është familja myslimane? Si është e kompozuar ajo? A është e mundur që ajo të rilindë si një model real i familjes shqiptare?

Familja myslimane është familje e zgjeruar, që integron vertikalisht të paktën tre breza dhe horizontalisht tre rrrathë të anëtarëve. Gjyshërit, prindërit dhe fëmijët jetojnë nën të njëjtin "kulm" shtëpie, me një udhëheqje

të vetme, zakonisht nga mashkulli më i moshuar në familje, me buxhet të përbashkët dhe me veprimtari të unifikuar përgjithësisht. Horizontalisht ajo ka në qendër bërthamën e sipërpërmendur. Rrethi i dytë përfshin një numër familjarësh shumë të afërt, jetojnë apo jo së bashku, të cilët kanë të drejta të veçanta ndaj njëri-tjetrit, që lëvizin lirisht nëpër shtëpi dhe ndërmjet të cilëve nuk është i nevojshëm hixhabi (mbulesa). Të tillë janë ungjit dhe emtet, fëmijët e njërit prej prindërve, etj. Në rrethin e tretë bëjnë pjesë vjehrra, vjehrra, kunetërit dhe kunatat, fëmijët e bashkëshortëve, bashkëshortët e fëmijëve dhe njerëzit.

Është mjaft me interes të vihet re përputhshmëria thuajse e plotë e familjes tradicionale shqiptare me modelin e familjes islame. Ngjashmëria dhe përputhjet midis dy këtyre familjeve zgjatohen edhe në mënyrën e funksionimit dhe udhëheqjes së familjes, kur dihet se që të dyja janë familje patriarkale, me një rol më të gjerë të gruas brenda shtëpisë dhe me përgjegjësi kryesore të burrit për të siguruar jetesën e anëtarëve të saj. Shpeshherë, familja tradicionale sulmohet dhe gjykohet, duke marrë si shembull trajtën e deformuar të saj. Në këto raste, pozita e keqe e gruas dhe natyra maskiliste e familjes, i mvishen karakterit të saj patriarkal. Modeli islam i familjes, pra familja e zgjeruar, nuk ka si synim të krijojë një mbretëri të vogël për çdo burrë të padrejtë, por të garantojë reflektimin e unitetit hyjnor (*teuhidit*), që në fazën embrionale të shoqërisë njerëzore. Realizimi me sukses i këtij synimi në këtë nivel të organizimit shoqëror, është *conditio sine qua non* i aktualizimit të unitetit në shoqërinë e tërë.

Pikëtakimet e shumta të modelit të familjes islame me atë tradicionale shqiptare, si dhe pranimi i dështimeve të së kaluarës, mund të shërbejnë si një mundësi krejt realiste për familjen bashkëkohore shqiptare. Përqafimi i këtij modeli përfaqëson një shans, me gjasë, të fundit për të shpëtuar familjen shqiptare nga rrënimi dhe shpërbërja dhe shoqërinë nga rrokullisja drejt degradimit të pakthyeshëm, apo, edhe më keq, nga rënia e lirë në një humnerë, që për ne sot nuk është aspak një parabolë.





INTERNETI NË FAMILJE

Prof. dr. Sadije Bushati

Interneti në Shqipëri hyri në vitin 1991, nga SOROS dhe deri në gjysmën e parë të viteve '90, ai hyri shumë pak në familjet shqiptare. Në institucionet e arsimit të lartë kishte ndonjë kompjuter të rrallë, të përdorur, të dhuruar zakonisht nga universitetet e huaja, mbas rinovimit të teknologjisë së tyre. Më pas, vjen duke u rritur pajisja me kompjuter kryesisht e institucioneve kryesore; biznesi përdor kompjuterat me lojra për fëmijë dhe adoleshentë, të instaluar në salla të caktuara dhe me çmim të caktuar për një orë ose familjet më të mëkëmbura, i instalojnë në banesën familjare.

Në vitet 2000, rritet interesi për teknologjinë e re në të gjitha fushat. Interneti fillon t'u interesojë gjithnjë e më shumë sidomos intelektualëve, të cilët marrin informacione të çmuara. Në vitet në vazhdim, numri i përdoruesve të internetit shtohet vazhdimisht, jo vetëm në familje, por edhe në "Internet kafe". Në vitin 2001 numri i kontratave të internetit fiks për 100 banorë ka qenë 0,16. Në 2003-shin ky indikator shkoi në 0,64, apo 4 herë më i lartë se në 2001-shin. Pas vitit 2009, ky indikator tregoi se rreth 3 në 100 banorë kanë një kontratë për shërbimin e internetit. Sipas Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikimit, në vitin 2010 janë regjistruar 111.717 kontrata interneti. Shtojmë edhe faktin se në një kontratë, zakonisht ka më shumë se një përdorues.

Interneti ofron mundësi, si për të rriturit, ashtu dhe për fëmijët dhe adoleshentët. Përfitimet nga interneti do t'i përmbledhim si më poshtë:

- Mundësi për të marrë informacione dhe njohuri për probleme e çështje të ndryshme në kohë shumë të shkurtër;
- Mundësi të shumta për kërkim shkencor, për të dhënat sekondare statistikore;
- E-commerce, reklama dhe shitblerje mallrash të çdo lloji;
- Komunikim shumë i shpejtë nga çdo distancë ndër-

mjet institucioneve dhe miqve;

- Shoqërim nëpërmjet rrjeteve sociale, shtimi i vetë-shprehjes dhe komunikimit;
- Argëtim me lojra, muzikë e sport.

Interneti sot është pjesë e mjedisit natyral të fëmijëve dhe shumë prej tyre kanë akses në të, në shtëpi, shkollë apo mjedise të tjera të komunitetit.

Por interneti, përveç se është i dobishëm për fëmijët, mund të jetë edhe i dëmshëm për ta. Meqenëse informacioni është i lirë, fëmijët mund të jenë të ekspozuar ndaj materialeve të papërshtatshme për zhvillimin e tyre fizik dhe psikik, si p.sh. me natyrë seksuale, të dhunshme, apo që inkurajojnë tek ata aktivitete të rrezikshme apo të paligjshme. Disa faqe të tjera mund të nxisin përdorimin e drogës, duhanit, ose alkoolit. Pedofilët gjithashtu, përdorin e-maillet për të kërkuar fëmijë, pastaj, duke komunikuar dhe fituar besimin e tyre, realizojnë edhe takime me ta. Në këtë moment, mund të themi që fëmija është në rrezik të madh fizik dhe psikologjik.

Është shumë e qartë që fëmijëve nuk mundemi tërësisht t'u ndalojmë qëndrimin në internet, por është detyrë e çdo prindi që të kontrollojë se në cilat adresa në internet navigon fëmija i tij. Mjekët dhe psikologët rekomandojnë edhe kohën që duhet të qëndrojë fëmija në internet për mosha të ndryshme: për fëmijët 4-6 vjeç, koha maksimale e qëndrimit para kompjuterit është 30 minuta, për ata 7-10 vjeç 45 minuta, 11-13 vjeç 1 orë, ndërsa fëmijët nga 14 e lart, një orë e gjysmë. Gjithashtu, mjekët dhe psikologët japin disa këshilla për prindërit e fëmijëve, për mosha të ndryshme të këtyre të fundit. Ja p.sh. disa këshilla që u jepen prindërve të fëmijëve deri 10 vjeç:

1. Nuk është kurrë shumë herët për të nxitur komunikim të hapur dhe pozitiv me fëmijët. Është një ide e mirë të bisedoni me ta në lidhje me kompjuterin dhe t'u përgjigjeni në mënyrë të hapur pyetjeve dhe kureshtjes

së tyre.

2. Gjithmonë rri me fëmijët tuaj të kësaj moshe, kur ata janë online.

3. Përcaktoni rregulla të qarta për përdorimin e internetit.

4. Insistoni që fëmijët tuaj të mos japin informacione personale, si emrin e tyre të vërtetë, adresën, numrin e telefonit, ose password me njerëz që ata njohin në internet.

5. Nëse një website i detyron fëmijët të paraqesin emrat e tyre, në mënyrë që të personalizojnë përmbajtjen e web-it, ndihmoni fëmijët tuaj të krijojnë online pseudo-nime që nuk japin informacion personal.

6. Përdorni mjetet e sigurisë së familjes për të krijuar profile të përshtatshme për çdo anëtar të familjes dhe për të ndihmuar në filtrimin e informacioneve që mund të marrin nga interneti dhe faqet që mund të hapin.

Do të bëhet problem i rëndë, nëse fëmijën nuk e sqarojmë përse i ndalojmë diçka që është e zakonshme për njeriun e shekullit tonë – përdorimin e internetit. Bile, edhe në qoftë se e bëjmë këtë gjë në shtëpi, ai fëmijë do të

gjejë shkak të shkojë te ndonjë shok i tij, të cilit i është lejuar interneti dhe do ta përdorë atë.

Pra, nuk rekomandohet që fëmijës t'i ndalohet tërësisht qëndrimi në internet, por është detyrë e çdo prindi ta kontrollojë se cilat adresa të internetit viziton fëmija i tij.

ÇFARË BËJNË FËMIJËT NË INTERNET?

Komunikojnë me fëmijë të tjerë; vizitojnë web-sajte me përmbajtje argëtuese; e shfrytëzojnë si burim informatah për projektet shkollore dhe për detyrat e shtëpisë.

Edhe pse dobitë janë të shumta, në internet ekzistojnë edhe rreziqe, që u përmendën më sipër.

Ato dalin nga këto karakteristika të internetit:

mundëson anonimitet, sepse gjithkush mund të fshehtë identitetin e vet në internet; nuk ka kufizim për përmbajtjet që mund dhe lejohen të futen; shpesh ato janë përmbajtje të papërshtatshme për fëmijë, si pornografi dhe material tjetër seksual; fotografi të frikshme të personave të vrarë apo të plagosur rëndë; urrejtje, drogë, armë dhe dhunë.

Kur janë në internet, fëmijët në mënyrë naive mund të pranojnë apo shkëmbejnë fajle që mund ta vënë në rrezik të gjithë familjen prej vjedhësve-sajber apo ta infektojnë kompjuterin me viruse. Ata mund të hasin në **dhunues-sajber (cyberbullies)**, të cilët do të përpiqen t'i trembin apo t'i turpërojnë. Edhe më keq, fëmijët, pa ditur, mund të komunikojnë me **rrëmbyes online (online predators)**, të cilët e përdorin internetin për të vendosur marrëdhënie me fëmijë; ata hiqen ose si moshatarë të tyre ose si të rritur, tek të cilët mund të kenë besim, e më vonë përpiqen t'i bindin që të takohen drejtpërdrejt.

FAKTE STATISTIKORE NGA BOTA

- Më shumë pornografi në internet konsumohet në moshën, prej 12 deri në 17 vjeç;
- Industria pornografike në internet tregon se 20-30% të qarkullimit në sajtet e tilla e realizojnë fëmijët;
- Në ditë dërgohen 2.5 miliard mesazhe e-mail pornografike;
- 26 emra të karaktereve për fëmijë (pokemon, eks-henmen etj.) çojnë në mijëra porno sajte;
- 27% e fëmijëve, prej moshës 7 deri në 17 vjeç do ta jepnin adresën e vet të shtëpisë nëpërmjet internetit, kurse 14% , adresën e vet të e-mailit;
- 40% e adoleshentëve kanë lënë informacione personale në internet që të tjerët të mund t'i kontaktojnë;
- Një në pesë fëmijë, që përdorin "dhoma për bisedë" (chat) janë kontaktuar nga pedofilë online;
- 76% e rasteve të eksploatimit seksual, të iniciuar nëpërmjet internetit, kanë qenë fëmijë të moshës 13 deri në 15 vjeç. 75% kanë qenë vajza. Shumica e rasteve kanë



vazhduar me takim të drejtpërdrejtë, kurse në 93% të këtyre takimeve ka pasur seks të paligjshëm;

• Gjatë një viti, mesatarisht, një ndër pesë fëmijë ka marrë propozim seksual nëpërmjet internetit, kurse vetëm 25% e tyre u kanë treguar prindërve të vet për këtë gjë;

• 89% e të gjitha kërkesave seksuale janë realizuar nëpërmjet "dhomave për bisedë" apo mesazheve instant.

Disa rekomandojnë që prindërit të vendosin rregullore familjare për internetin, kryesisht për adoleshentët. Duke i trajtuar si të rritur, rregullorja të shikohet si një marrëveshje në mes tyre dhe të mbyllet në fund me nënshkrimin e dy palëve: prindit dhe fëmijës.

Gjithsesi prindërit duhet të ushtrojnë kontroll të vazhdueshëm. Në ndihmë të tyre për këtë qëllim ofrohen shumë softe me karakteristika dhe çmime të ndryshme. Disa nga këto, kanë shkallë filtrimi të siteve të ndryshme të web, sipas moshave të fëmijëve; disa bllokojnë automatikisht të gjitha reklamën që mund të përmbajnë "fjalët" kyçe të bllokuara, disa kufizojnë automatikisht kohën: "mjaft ndenje në PC... do të të lodhen sytë... do të bllokohen neuronet" dhe kompjuteri fiket automatikisht në momentin e caktuar. Disa softe mund të përdoren për më shumë qëllime, përfshijnë shumë opsione për filtrim, mbikëqyrje dhe kufizim të përmbajtjeve dhe aktiviteteve online. Po rendisim më poshtë disa nga këto softe, që vendosin kontroll të prindërve mbi aktivitetet online të fëmijëve:

1. Crawler Parental Control është një prej softuerëve të rrallë për kontroll të prindërve, që jepet falas dhe plotësisht funksional. Mundëson kontroll të kohës që përdoruesi kalon online, si dhe kufizim të saj. Mund të vendosen web-sajte të caktuara, të cilat përdoruesi nuk lejohet t'i vizitojë, të tjera që janë të lejueshme, si dhe fjalë, të cilat, në qoftë se gjenden në ndonjë web-faqe, do ta bëjnë të pamundur futjen në të.

LINKU PËR SHKARKIM:

<http://www.crawlerparental.com>

2. Glubble është një mjet mjaft popullor familjar, që shfrytëzohet si shtojcë për shfletuesin e internetit Mozilla Firefox. **Linku për shkarkim:** <http://glubble.com>

3. K9 Web Protection është pa pagesë për filtrim të web-përmbajtjeve dhe vendosje të kontrollit të prindërve mbi aktivitetet e fëmijëve, kur ata janë online. Për për-

dorimin e tij duhet liçencë, të cilën mund ta merrni pa pagesë, nëpërmjet e-mailit, në qoftë se e kaloni procedurën e regjistrimit. **Linku për shkarkim:** <http://www.k9webprotection.com>

4. Ndoshta nuk do të keni nevojë për softuer shtesë për kontroll të prindërve, në qoftë se e shfrytëzoni versionin aktual të sistemit operativ Windows – **Windows Vista**. Tani, falë mjetit **Parental Controls**, i cili gjendet në **Control Panel**, prindërit mund të krijojnë profile të veçanta shfrytëzuesish për fëmijët e tyre dhe ato të jenë të përshtatshme me moshën dhe interesat personale të tyre.

5. Shfrytëzuesit e versionit të fundit të sistemeve Mac OS X – **Leopard** mund të përdoren për kontroll të prindërve që vjen me vetë sistemin. Opsionet e ofruara për përshtatje janë standard dhe mundësojnë qasje të kufizuar në web-sajte të caktuara, kufizim kohor, si dhe

mbikëqyrje të të gjitha aktiviteteve online të fëmijës suaj: webfaqet e vizituara, aplikacionet e përdorura dhe njerëzit me të cilët ai ka komunikuar nëpërmjet dhomave për bisedë etj.

Ka edhe shumë softe të tjerë, me ose pa pagesë (shih [3]).

Sipas ekspertëve të IT-së, mbikëqyrja prindërore bëhet e vështirë në këtë kohë dixhitale dhe të zhvillimit të hovshëm të teknologjisë, por ajo i mundëson prindërit të kontrollojnë përmbajtjet e padëshiruara, pra, të kenë një internet të sigurt për familjen. Gjithashtu, ekspertët e IT-së kanë krijuar softe edhe për arsimtarët që përdorin në klasë internetin, në mënyrë që edhe ata të mbrojnë nxënësit nga rreziqet e internetit.

Dita ndërkombëtare e mbrojtjes nga rreziqet e internetit (7 shkurti) i kujton të gjithë për të shtuar masat e sigurisë.

LITERATURA

1. "10 fishohet numri i kontratave të internetit" – abc news 27 Mars 2012, internet, "open.data.al"

2. Fakte statistikore nga bota :sipas <http://www.familysafemedia.com>

3. "Doracak për TIK" <http://www.crisp.org.mk/besim>

4. Igli Totozani, Avokati i Popullit, fjala në konferencën me temë "Të gjithë së bashku për një internet më të sigurtë" 17 Shkurt 2012, internet.

5. Pollo: "Të angazhohemi për një internet më të sigurtë për fëmijët dhe të rinjtë"-internet, Albanews, 7.02.2012



Je mysafir në këtë shtëpi, o zemër!

Salih Zeki Meriç



Ejani ta fillojmë fjalën e zemrës me fjalët e një sulltani zemrash, që ngjallin zemrat. Të digjemi përbrenda me ndjenjat më të pastra për hallin e zemrës. Ankimet e zemrës sonë t'i qajmë me njerëzit e zemrës... Përzemërsisht.

Mevlana i nderuar, u thërret zemrave të shkretuara, me gjuhën e zemrës:

Je mysafir në këtë shtëpi, o zemër
Qesh me atë që gjen dhe jo me atë që shpreson
Çfarë të thotë i zoti i shtëpisë, ajo bëhet,
As mos mbaj mëri dhe as mos u hidhëro...

O zemër! Ti je mysafir në këtë botë. Prej nga erdhe dhe për ku po shkon? A nuk të trondit kjo pyetje? Të pyesim edhe një herë: Ku po shkon?

Nëse e di se prej nga ke ardhur, e di edhe se ku do të shkosh. Çdokush i cakton vetes një rrugë. Ndjek një gjurmë. Vrapo kot dhe pashpresë. Ti je mysafir në këtë botë. Si mysafir, vështro përreth teje. Si mysafir, shijo prej atyre që të gostiten. Si një udhëtar, qëndro i gatshëm për udhë. Udhë është e gjatë, vendi është i largët. Ata që ke lënë pas, nuk bëjnë *ah* pse nuk je. Prandaj në këtë udhëtim, mos shih pas. Çfarë do të shpiësh në vendin ku do të shkosh? Çfarë ke në trastë, atë shiko. Rrëzoji muret që ke përbrenda, ngreji perdet dhe lidhu pas kësaj bote, aq sa lidhet një udhëtar. Dije se kjo botë është e mbushur me shijet kalimtare të sarajeve prej letre. Si mysafir bëj edhe takimin.

Eh çfarë mysafirësh ka parë kjo shtëpi! Të gjithë erdhën dhe ikën. Të gjithë ishin të vdekshëm. Edhe ti je e vdekshme o zemër. Edhe ditët e tua janë të numëruara. Pastaj do të shkosh në një vend ku do të pish sherbetin e përjetësisë dhe do takohesh me të Pafundmin. Kjo botë nuk është vendi yt. Ktheji sytë nga horizonti. Shiko, dielli i pafundësisë po lind. Hapi krahët dhe ik prej kësaj bote në botën tjetër, o zemër.

O zemër! Çfarë pret prej të tjerëve? E çfarë mund të të japin, përveç dhimbjes dhe hidhërimit? Ti ke për detyrë të heqësh vuajtjet që të kanë rënë për pjesë. A do të mundesh të japësh llogari për mirësitë, të cilat janë në llogarinë tënde, që i lidh shpresat tek të tjerët? Mos i lidh shpresat tek askush tjetër, përveç Zotit tënd, që u përgjigjet lutjeve të tua!

Kush mund të t'i qetësojë dhimbjet? Kush, përveç Tij, mund të të japë lumturinë për shpëtimin e botës së përjetshme? Çfarëdo që të presësh, prite prej Allahut. Drejtohu nga Ai, strehohu tek Ai, kërkoje Atë, sepse kjo botë dhe ato që janë në të, nuk janë gjë tjetër veçse një kupë e zbukuruar me diamante dhe e mbushur me helm.

Falënderimi është kapitali yt më i madh, ndërsa hamdi¹ le të jetë limani në të cilin strehohesh. Ka prej atyre që humbasin në kënaqësitë e mahnitshme të kësaj bote. Por

1. Lavdërimi dhe falënderimi i Allahut.

trasta jote le të jetë e mbushur me dertet dhe vuajtjet e ambicies për pafundësinë.

O zemër! Bëj panik sa të duash. Përpëlitu e mundohu sa të duash. A mund ta ndrysh qoftë edhe një germë që është shkruar në lidhje me ty? Mos harro se je veç mysafir. Çfarë të ketë caktuar i zoti i shtëpisë, ajo bëhet. Dorëzohu, duke marrë masat. Por marrja e masave të mos kalojë para dorëzimit. Merr masat për çdo gjë, por caktimin dhe mbështetjen lërja të zotit. Thuaj si Ibrahim (a.s.), **“Unë iu dorëzova Zotit të botëve”** dhe shpëto. Thuaj **“Jam i kënaqur me atë që më vjen prej teje. Të vijë, ç’të vijë. Edhe nëse vjen hidhërim, edhe nëse vjen gëzim, me të gjitha jam i kënaqur.”** Thuaj që mbi ty të zbresin shirat e mëshirës dhe të gjelbërojnë dorëzimin tënd.

O zemër! Le të gjejnë qetësi në zemrat e tyre ata që të shohin. Bëhu pasqyra e zemrave të pastra. Ata që vijnë tek ti, të bëhen si një det pa fund. Askujt mos ia var fytyrën. Mos u lëndo prej askujt. Mos mbaj mëri askënd. Kush je ti që mban mëri! A të ka mbajtur mëri, qoftë edhe njëherë për gjynahet që ke bërë Ai, që të ka dhënë gjithë këto të mira? A t’i mbylli dyert e faljes pas gjithë kësaj shkujdesjeje që ke treguar? A nuk i mbajti gjithmonë hapur dyert e pendimit?

O zemër! Nuk ke të drejtë të mbash mëri. As të hidhërohesh. Mbajta mëri është punë e atyre që kanë zemra të thara. Zemra e besimtarit duhet të jetë gjithmonë duke falënderuar Allahun. Çdo çast i zemrës, duhet të mbushet me ndjenja falënderimi. Elikhiri i zemrave është tek djegia e zemrës, për shpëtimin e të tjerëve përveç vetes.

Digju o zemër digju! Digju dhe çohu prej gjuimit. Padyshim, dikush të dëgjon. Të dëgjon vajtimin dhe të kupton hallin.

O zemër! Digju, që të shkrihen zemrat e atyre që u është ngurtësuar nefsia. Mos u hidhëro prej ndarjes, mos ngri krye pa shkak dhe mos mbaj mëri. Kjo është ilaç për zemrën që ka hidhërim. Zemra ka nevojë për dertin, në rrugën e dashurisë. Tashmë, zhvishu prej egoizmit.

O zemër! Mos u fyej, mos u zemëro, mos lëndo, mos u lëndo. Bëhu det i pafund i atyre që vijnë tek ti! Bëhu ujëvarë me dashurinë tënde! Ti je aq sa bota që mban brenda vetes. Nëse vrapon pas ëndrrave të vogla dhe dëshirave të kota, ato të tërheqin poshtë dhe jo lart. Ndërsa ti shkatërrrohesh e zhdukesh, bashkë me ndjenjat e tua të ulëta.

Jeta përbëhet nga çasti në të cilin jetojmë

Prof. dr. Mustafa Nutku

E shkuara dhe e ardhmja nuk janë në dorën tonë. Ne duhet të përpigemi t’i jetojmë në mënyrën e duhur, çastet në të cilat ndodhemi. Nëse një pikë e shndritshme lëvizet, duket si një vijë e shndritshme. Mirëpo, në fakt ajo nuk është një vijë e shndritshme, por një pikë e shndritshme.

“Vija e jetës sonë”, është si “vija e shndritshme” në këtë shembull. Po ashtu edhe çasti në të cilin jetojmë, është si “pika e shndritshme” që jepet në shembull. Pra, kjo është e vërteta e jetës sonë.

Atëherë, të jetosh, do të thotë të jetosh çastin në të cilin ndodhesh. Vallë, sa jemi të vetëdijshëm për këtë dhe sa i përshatemi kësaj të vërtete me vetëdijen tonë?

Do të ishte shumë e dobishme për ne nëse në këtë çështje bëjmë një vetëllogaritje të nefsit tonë.

* * *

Të vizatojmë një vijë të drejtë dhe mbi këtë vijë, ta lëvizim një pikë në të djathtë. Kjo pikë që lëviz, largohet nga skaji i majtë me të njëjtë shpejtësi, që afrohet në skajin e djathtë.

Njëlloj si ky shembull, edhe jeta jonë në këtë botë është si një pikë që lëviz mbi vijën e kohës. Nëse mendojmë se po shkojmë nga një fillim, drejt një fundi, shpejtësia drejt fundit të jetës sonë, është e njëjtë me shpejtësinë e largimit nga fillimi i jetës sonë.


Me fjalë të tjera, e ardhmja afrohet tek ne me të njëjtën shpejtësi që largohet e shkuara.

Jetët e shumicës së njerëzve në këtë botë, i shoqëron një dobësi, e cila quhet “ëndërr për përjetësi”. Pra, njerëzit duan të mendojnë “sikur do të jetojnë përjetësisht në këtë botë”.

Ndërsa disa të tjerë, shkojnë më tej dhe kërkojnë rrugët për të jetuar përjetësisht në këtë botë.

Allahu Teala, ka futur tek njeriu dëshirën për të jetuar përjetësisht, për shkak se do t’ia japë jetën e përjetshme në jetën tjetër, pas kësaj bote.

Kjo dëshirë duhet të shpenzohet për jetën e botës tjetër, në përputhje me qëllimin e dhënies. Prandaj, duhet të përgatitemi në këtë botë dhe t’i japim rëndësi më shumë se çdo gjëje tjetër besimit dhe namazit, të cilat do të na duhen në “jetën e përjetshme”.



metafizika e "asgjësë"

Edison Çeraj

Në esenë e njohur "*Ç'është metafizika*", që njëherësh është dhe leksioni inaugurues në Universitetin e Freiburgut, Heidegger-i, ndër të tjera, trajton edhe çështjen e "asgjësë". Qëndrimi i Heidegger-it për "asgjënë", ose për realitetin e papërcaktuar të saj, paraqitet gati proverbial, pasi autori e mbyll duke mos e përkufizuar dhe përcaktuar atë, dhe mbi të gjitha, duke mos e identifikuar me një "gjë" a ekzistencë, pavarësisht se deri në këtë përfundim ai vjen përmes dhënies së disa pa-përcaktimeve, të cilat mund të jenë dhe përcaktime në vetvete, por të domosdoshme (të paktën në atë kontekst që trajtohet prej autorit), pa të cilat nuk mund të shtrohej qëndrimi i qëndrueshëm i autorit.

"...ajo që lipset¹ të shqyrtojmë, janë vetëm qeniet², e përveç tyre – asgjëja; vetëm qeniet, e më pas – asgjëja; qeniet dhe vetëm qeniet, e përtej kësaj – asgjëja³."

Kjo është pjesa ku, pak a shumë, nis dhe trajtimi i asgjësë në esenë e lartpërmendur, duke e lidhur atë me qeniet, që janë pjesa më e rëndësishme e ekzistencës (sipas asaj që dimë ne), "e përtej kësaj – asgjëja".

Meqë është kështu ose duhet të jetë kështu, a paraqitet si ontologjike *asgjëja* në këtë rast, në kuptimin që ka një lidhje të drejtpërdrejtë me ne? Apo duhet vetëm ta pranojmë në qetësinë e paqëndrueshme të qenies dhe të mos rrahim ta trajtojmë atë me një mënyrë a me një tjetër? Zgjidhja më e mirë do ishte pikërisht kështu: të mos i jepnim asaj një trajtë, meqë ne nuk kemi rënë aspak dakord për burimin e dijës së mundshme mbi *asgjënë*. Nga ana tjetër, çështja si e tillë, nuk qenka e mundur të rrijë pa u shtruar, dhe mu për këtë, bëhet i nevojshëm re-

flektimi mbi të, qoftë edhe (sidomos) për të treguar mbi domosdoshmërinë e pa-përcaktueshmërisë së *asgjësë*.

"Po ç'mund të thuhet për asgjënë, që është hedhur poshtë nga shkencat dhe është lënë mënjanë, përpikmërisht si e pavlefshme? Po pse, duke e lënë mënjanë në këtë mënyrë, mos vallë bëjmë të kundërtën, e pranojmë atë? E më tej, a mund të flasim vallë për pranimin, kur ky pranim nënkupton të pranojmë asgjënë? Apo mos vallë, shprehja jonë, tashmë e përshtjelluar, shturet në një zënkë boshe mbi fjalët? Për këtë arsye, kundrejt saj, shkencat lipset të ripohojë sot gjithë seriozitetin dhe kthjelltësinë e saj mendore, duke këmbëngulur që ajo të merret me qeniet dhe vetëm me qeniet. Se tek e fundit, asgjëja ç'mund të jetë tjetër për të, përveçse një fyerje dhe një fantazmë? E nëse shkencat ka të drejtë, atëherë diçka është vërtetë e sigurt: se ajo nuk dëshiron të dijë asgjë për asgjënë. Aq më tepër që ky është dhe koncepti shkencërisht rigoroz i asgjësë. Ne e njohim atë, domethënë, asgjënë, në kuptimin se nuk duam të dimë asgjë⁴ për të."⁵

Për sa i takon pranimit apo mospranimit të *asgjësë*, kjo është një çështje krejtësisht individuale, që kthehet dhe vendoset përballë çdo njeriu, kurse çështje në vetvete nuk ka të bëjë dhe nuk varet nga pranimi apo mospranimi i qenieve. *Asgjëja* mbetet e tillë – ajo që është – pavarësisht qëndrimit tonë.

Ndërsa shkencat si e tillë (jo shkencëtari), sigurisht që do e mohojë *asgjënë*, pasi, së pari, ajo mohon metafizikën, që sipas saj është e barsvlerëshme me *asgjënë*, përderisa nuk kapet nga shqisat dhe mjetet që janë zgjatime të tyre. Në këtë kuptim, shkencat nuk merret as me qeniet, sepse ajo

1. Ose që na duhet.

2. Ose Qenia.

3. Heidegger, M. (2003) *Leksione dhe konferenca*. Tiranë: Plejad.

4. Joshkencore.

5. Po aty.

studion vetëm funksionin e tyre, e asnjëherë *telos*-in⁶.

Në njëfarë kuptimi të epërm për nga natyra, vetë ne jemi *asgjë*, sepse ne nuk ishim para se të lindnim dhe nuk do jemi, sepse jemi të vdekshëm. Pikërisht me këtë merret shkenca, me asgjënë, me kalimtarin, pra me atë që është një iluzion i pazgjithur. Dhe kësaj, duke qenë një iluzion, shkenca mbetet pre e një iluzioni, ose e iluzioneve që rrjedhin së andejmi. Në këtë mënyrë, edhe qytetërimet e ngritura vetëm mbi disiplina racionale, janë të parapërcaktuara të merren me këtë iluzion, duke mos dhënë kështu kurrfarë përgjigjeje se ku do të na çojë besimi i tyre tek i ashtuquajtur *progres*.

Deri në këtë pikë, mund të themi se u morëm me një shfaqje të caktuar të *asgjësë*, por jo (ndoshta) me “*asgjënë*” në vetvete, që nuk mund të përcaktohet, që nuk i përngjet askush dhe *asgjë*.⁷

“Shkenca nuk do të dijë *asgjë* për *asgjënë*. Mirëpo edhe kështu, është më se e sigurt se sa herë ajo përpriqet ta shprehë me përpikmëri thelbin e vet, i duhet detyrimisht t’i drejtohet *asgjësë* për ndihmë. Pra, kërkon ndihmë nga diçka që e ka hedhur poshtë. Atëherë, shtrohet pyetja: Ç’situatë vallë papajtueshmërie arrin të zbulojë kështu vetveten? Duket që, me këtë lloj reflektimi mbi ekzistencën tonë bashkohore të determinuar nga shkenca, ne e gjemë veten të pleksur në një debat. E në udhën e trajtimit të këtij debati, një pyetje nis menjëherë të evoluojë vetveten, duke kërkuar si e si një formulim sa më të qartë: Si duhet të trajtohet çështja e *asgjësë*? Përpunimi i pyetjes mbi *asgjënë*, lipset të na sjellë në atë pikë, ku të bëhet e mundur një përgjigje ose të bëhet e qartë pamundësia e një përgjigjeje. Tashmë, *asgjëja* është e pranuar, ndërkohë që me një nënvlerësim të studiuar, shkenca vazhdon ta braktisë atë, si diçka që s’ekziston.”⁸

Domethënë, shkenca së bashku me të gjitha disiplinat e saj racionale, duke futur pa dyshim edhe psikologjinë, vazhdon ta mohojë *asgjënë*, pikërisht duke u nisur nga arsyetimi bazë i saj: ajo nuk ekziston. Kështu, gjithë çfarë është transcendent, me në krye Zotin, rrjedhimisht rezulton të jetë, ose të reduktohet në *asgjë*. Më konkretisht, meqë Zoti nuk bën pjesë në territorin⁹ e përvetësuar të

6. Qëllimin, thelbin.

7. Por, në Kuran gjemë një përcaktim të “*asgjësë*”: “*Asgjë* nuk i sh - mbëllen Atij.” (42/11)

8. Heidegger, M. (2003) *Leksione dhe konferenca*. Tiranë: Plejad.

9. Nëse do shpreheshim përmes një metafore, mund të pohojmë që bëhet fjalë për një territor të marrë me qira nga ana e shkencës, por

shkencës, sepse ajo merret vetëm “me qeniet”, siç thotë Heidegger-i, pra me gjithë çfarë është e mundshme t’i nënshtrohet asaj si objekt studimi.

Në fakt, këtu ka të drejtë shkenca, vërtet Zoti nuk mund t’i nënshtrohet asaj për t’u bërë objekt studimi¹⁰ dhe jo sepse nuk do apo nuk e pranon shkenca, por thjesht, sepse është pafundësisht larg mundësive të saj një hap i tillë.

Po ashtu, është larg një hapi të tillë, sepse shkenca merret gjithnjë vetëm me një pjesëz/grimcë të qenieve (natyrës në përgjithësi), dhe vetëm me funksionin (aspektin sasiar), jo me qëllimin (aspektin cilësor). Së këndejmi, shkencat nuk mund të zbulojnë kurrë qëllimin (urtësinë, filozofinë) e qenieve, pasi, siç e thamë, ato kanë interes vetëm për aspektin sasiar të ekzistencës.

Kësaj, duke mos u marrë me *asgjënë*, – në këtë rast Zoti dhe gjithë çfarë është transcendent – shkenca vetë është kthyer në një “provë” për Zotin.

Duke qenë se shkenca ka shkaktuar dhe po shkaktonte një trysni në rritje mbi jetën tonë, mund të themi që shumëçka, për sa i takon mënyrës se si ne e përftojme “*asgjënë*”, e kemi nga ndikimi i kësaj trysnie, trysni e cila ka ndërhyrë, së pari e mbi të gjitha, ndërmjet nesh dhe rendit transcendent si një ndërmjetëse e pafundësisht nga ne, me përjashtim të atyre eksponentëve të saj, të cilët e krijuan dhe e ushqejnë si të tillë, duke na kthyer kësaj të gjithëve në profanë të lindur¹¹, që pa ndihmën e saj, nuk lidhemi dot me “*asgjënë*”.

Pa u ndërgjegjësuar si duhet mbi këtë trysni, ne nuk do ia dalim të kuptojmë realitetin e “*asgjësë*” dhe lidhjen ontologjike që kemi me të.

Kjo ishte vetëm një anë, – për aq sa ishte – e asaj që mund ta quajmë shfaqje e “*asgjësë*”, as më shumë e as më pak.

qiraja nuk është paguar asnjëherë, sepse nuk po gjen dot pronarin.

10. Në këtë pikë, mund të kujtojmë edhe *teologjinë* (*Theos* – Zot, dhe *logos* – fjalë/disiplinë/trajtesë/shkencë etj.), e cila për aq sa ka synuar të jetë shkencë e mirëfilltë (në mos qoftë e tillë), ka sjellë më shumë probleme se zgjidhje, probleme të cilat përgjatë historisë, qoftë të krishterë, qoftë islame, kanë shkaktuar jo pak devijime/shkarje nëpër ekstreme nga më të ndryshmet nga eksponentë të caktuar të këtyre feve.

“Theology moves back and forth between two poles, the eternal truth of its foundations and the temporal situation in which the eternal truth must be received.” (Paul Tillich, *Systematic Theology*, 1951)

11. Duke përvijuar, me sa duket, idenë (pse jo dhe besimin), se një - riu nuk lind, por bëhet, që në fakt përbën një nga mohimet më radikale që mund t’i jenë bërë ndonjëherë asaj që ne njohim (ose duam të njohim) si *njerëzore*.



Kush është më e rëndësishme për lumturinë, pamja apo natyra e njeriut?!

Ali Riza Jemel

Njeriu vjen në këtë botë me formë fizike dhe pamje të caktuar, pasi Allahu ia jep formën që dëshiron, që në mitrën e nënës. Një nga atributet e Zotit është edhe Musavir (Ai që u jep formën krijesave). Ngjyrat dhe format e shumëllojshme janë shenja që tregojnë fuqinë e Zotit.

Meqë askush nuk e përcakton formën e tij që prej lindjes, por është Zoti Ai që përcakton gjatësinë, ngjyrën e lëkurës, formën e tij, atëherë kuptohet që të gjithë këto karakteristika nuk janë fryt i përpjekjeve dhe punës së tij personale. Njeriu nuk mund të tregohet superior ndaj të tjerëve me gjëra që nuk i fiton me punën e tij. Vlera e secilit matet në përputhje me ato që ai fiton. Allahu thotë kështu, në lidhje me këtë çështje: “Çdo njeri do të marrë atë që ka punuar.” (Tur, 21). Në thelb, dëshirohet një zemër e pastër, një iman që nuk u lë vend dyshimeve dhe veprat e mira. I dërguari i Allahut ka thënë: “Allahu nuk ju sheh pamjen e jashtme apo pasuritë që keni, por zemrat dhe veprat tuaja.” (Ibn Maxhe, Hadith no: 4143)

Natyrisht që çdo person dëshiron të ketë pamje dhe fizik të bukur. Vetëm se bukuria fizike nuk është kriteri themelor. Për më tepër, bukuria është relative dhe ndryshon nga personi në person. Mund të ndodhë që diçka, që dikujt i duket e bukur, të mos i duket e tillë dikujt tjetër. Ta shohësh Lejlanë me sytë e Mexhnunit, është tërësisht e ndryshme sikur ta shohësh atë me sytë e një personi tjetër.

Bukuria trupore është kalimtare dhe e improvizuar. Ata që janë të bukur në rini, nuk janë të tillë në pleqëri. Edhe nëse zbukurohen sadopak me anë të makijazhit apo operacioneve estetike, kjo bukuria e improvizuar

nuk do të vazhdojë përherë dhe, për më tepër, nuk e zëvendëson kurrë bukurinë natyrale. Gjithë këto duhet ta mësojnë njeriun të ndjekë bukurinë që nuk vyshket dhe nuk zhduket, e cila është bukuria morale. I dërguari i Allahut pati thënë se një mashkull martohet me një femër për hir të bukurisë, të pasurisë, të prejardhjes së saj, por ai i këshillonte myslimanët që të preferonin të martoheshin me një femër, për shkak të fetarisë së saj, sepse aty gjendej edhe begatia martesore. Sa e sa njerëz e kanë fytyrën të ndritshme si dielli, por zemrën e kanë sterrë. Mund të ndodhë edhe e kundërta. Bilali e kishte fytyrën të zezë si nata, por zemra e tij qe e bardhë si bora. Ebu Lehebi e kishte fytyrën të ndritshme, por përbrenda ishte i zi sterrë. Sado të zbukurohet dhe të ndriçohet nga jashtë, një ditë trupi i njeriut do të bëhet dhe. Shpirtat vlerësohen sipas hijeshisë apo pabukurisë shpirtërore. Ata nuk do të zhduken. Sa bukur e ka shprehur Junus Emre: "Vetëm trupi do të vdesë, sepse shpirti nuk di ç'është vdekja. Trupi që ushqen, një ditë do të bëhet ushqim për krimbat."

Edhe evlijatë theksojnë rëndësinë e shpirtit dhe jo të trupit, kur shprehen: "Sa e parfumos lëkurën, parfumose më mirë shpirtin, se trupi një ditë do të bëhet dhe."

Bukuria e vërtetë është të ecësh në vijën e moralit, etikës dhe njerzillëkut, por në përgjithësi njerëzit i japin rëndësi bukurisë fizike dhe stolive të improvizuara, duke hedhur pas krahësh bukuritë shpirtërore. Kjo dobësi vihet re tek njeriu, në çdo kohë dhe në çdo vend. Dëshiroj të jap një shembull mahnitës se si duhen ndarë nga njëra-tjetra dhe duhen vlerësuar bukuria fizike dhe ajo shpirtërore:

Sad Sulejmi qe një skllav i zi, nga brezi i sahabëve. Ai qe një mysliman i devotshëm. Një ditë shkoi në xhami, fali namazin dhe iu afrua Profetit Muhamed. Njerëz të ndryshëm e kishin rrethuar Profetin dhe i bënë pyetje, në lidhje me punët e kësaj jete.

Sadi u ngrit në këmbë dhe e pyeti: "O i dërguari i Allahut! A thua vallë, unë nuk do të hyj në xhenet, sepse nuk kam pamje të bukur dhe jam i zi?" I dërguari i Allahut i tha: "Betohem tek Allahu, falë fuqisë së të Cilit jetoj, se ti do të hysh në xhenet, në qoftë se do të respektosh urdhrat e Zotit dhe do të besosh tek ato që të thotë Profeti i Tij."

Pas këtyre fjalëve, Sadi tha: "Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është i dërguari

i Tij. Zotohem se do të luftoj në rrugën e Allahut. Çfarë do të fitoj unë në këmbim të këtyre që sapo thashë?" Profeti tha: "Ti do të gëzosh të gjitha të drejtat dhe detyrimet që kanë të gjithë besimtarët. Ti u bërë vëlla me ta në fe." Pas këtyre fjalëve, Sadi tha: "Unë kam kërkuar dorën e bijave të atyre që janë dhe nuk janë krah teje, por që të gjithë refuzuan, sepse e kam fytyrën e zezë dhe nuk jam i pashëm. Unë rrjedh nga fisi i beni Sulejmëve."

Pas këtyre fjalëve, profeti tha: "Shko tek shtëpia e Amr bin Vehbit, trokiti në derë, jepi selamin tim dhe thuaj se i Dërguari i Allahut më ka martuar me bijën tënde!" Sadi shkoi tek shtëpia e Amr bin Vehbit, siç e urdhëroi Profeti. Trokiti në derë. Kur u hap dera dha selam dhe tha: "Më ka dërguar Profeti i Zotit. Ai më tha që të të them të më japësh vajzën tënde për grua!"

Amr b. Vehb e shtyu me dhunë Sadin. Sadi u kthye që të largohej. Vajza e Amrit kishte dëgjuar pas perdes së çfarë kishte ngjarë dhe i thirri me zë të lartë Sadi: "O robi i Zotit! Në qoftë se është ashtu siç thua ti, se i dërguari i Allahut ka urdhëruar që ne të dy të martohemi, edhe unë jam e kënaqur me atë që është i kënaqur Allahu dhe i dërguari i tij!" Sadi ndali një çast, por pastaj u largua me mendimin se vajza nuk kishte të drejtën e fjalës së martesës, për sa kohë që kishte të atin gjallë.

E bija i tha të atit: "Baba! Shko menjëherë tek i dërguari i Allahut dhe pranoje propozimin e tij, para se të zbresë ndonjë ajet në lidhje me këtë çështje dhe pastaj të turpërohesh përgjithmonë në mesin e arabëve. Allahu urdhëron dhe thotë: "Besimtarët dhe besimtarët nuk kanë të drejtë të bëjnë çfarë të dëshirojnë, në lidhje me një çështje për të cilën kanë vendosur Allahu dhe i dërguari i Tij." (Ahzab, 36) I ati e kuptoi se e bija qe më e ndjeshme dhe më e ndërgjegjësuar në këtë pikë, sesa ai, prandaj u ngrit menjëherë dhe u nis për tek i Dërguari i Allahut që t'i kërkonte ndjesë dhe t'i thoshte se ishte i kënaqur me urdhrin e tij. Sadi kishte mbërritur më parë tek i Dërguari i Allahut dhe i kishte treguar ç'kishte ngjarë. Kur erdhi Amri, i dërguari i Allahut e pyeti përse e kishte refuzuar Sadin për dhëndër. Amr b. Vehb i qe përgjigjur: "O i Dërguari i Allahut! Kujtova se nuk po më thoshte të vërtetën, prandaj erdha këtu tek ju që të mësoj si qëndron e vërteta. Tani që e shoh se ai më ka thënë të vërtetën, unë shpall këtu para të gjithëve se bija ime do të martohet me Sadin."

Bukuria e vërtetë është të ecësh në vijën e moralit, etikës dhe njerzillëkut, por në përgjithësi njerëzit i japin rëndësi bukurisë fizike dhe stolive të improvizuara, duke hedhur pas krahësh bukuritë shpirtërore.

I Dërguari i Allahut e uroi për këtë martesë Sadin dhe i tha: "Shko dhe hyr në gjerdek me gruan tënde." Sadi qe shumë i lumtur. Ai shkoi në treg të merrte diçka për vete dhe për gruan e tij.

Kur mbërriti në treg, dëgjoi një zë që thërriste me të madhe: "O kalorësit e Allahut! Hipuni kuajve, që të gëzoheni me sihariqin e Allahut me xhenet!" Myslimanët po bëheshin gati për xhihad. Sadi hoqi dorë nga ato që donte të blinte për martesë dhe shkoi te tregu i armëve dhe i kuajve. Aty bleu një kalë, një shpatë dhe një shigjetë. Mori pjesë në betejë, ku luftoi si kalorës dhe si këmbësor dhe në fund fare, ra shehid. I Dërguari i Allahut i shkoi pranë, e mori në gushë dhe ia përkëdheli kokën. Kalin dhe shpatën e Sadit urdhëroi t'ia çonin gruas së tij dhe pastaj shtoi: "Thuajuni të afërmve të Sadit se Allahu e martoi Sadin me një hyri, shumë më të mirë se bija juaj. Kjo është trashëgimia që ju ka lënë." Pastaj Profeti lexoi ajetin: "Nuk ka dyshim se ata që e ruajnë veten e tyre nga të këqijtat, do të jenë në vende, në kopshte dhe në burime të sigurta. Ata do të rrinë kundruall njëri-tjetrit, të veshur me rroba të holla pambuku dhe me rroba të ndritshme prej atllasi. Ja kështu! Ne do t'i martojmë ata me hyri që kanë sy të bukur, të zinj dhe të mëdhenj." (Duhan, 51-54) (Ahmet Muhamed Asaf, Kabisatun min hajati-r-Rasul, fq. 164-166)

Ashtu siç kuptohet nga kjo ngjarje, nuk është e rëndësishme nëse njeriu e ka fytyrën të zezë dhe nuk është i bukur, por e rëndësishme është që ai të ketë zemrën e bardhë dhe jetën e rregullt. Gjëja më e pranueshme tek Allahu, është zemra e pastër. **"Atë ditë nuk do të bëjnë punë, as pasuria dhe as fëmijët. Atë ditë do të fitojnë vetëm ata që kanë një zemër të pastër."** (Shuara, 88-89.)

Vlera e vërtetë e një njeriu, matet me vlerat morale dhe shpirtërore që ai zotëron. Do të ishte krejt pa vend dhe e panevojshme të shtrohej pyetja: Më mirë i varfër, por i ndershëm apo i pasur dhe i pandershëm? Çdo gjë fiton vlerë me anë të njeriut të mirë. Edhe gjërat e bukura, në vetvete bëhen të shëmtuara, kur i zotëron një njeri i keq.

Le të tregoj edhe një ngjarje tjetër, që nxjerr në pah vlerën e vërtetë të njeriut:

Një ditë, një person erdhi tek profeti. Profeti e pyeti personin që qëndronte pranë tij:

- Çfarë mendimi ke për këtë njeri?

Ai u përgjigj:

- Ky njeri është nga paria dhe njeri me famë. Në qoftë se ai kërkon dorën e një femre, e meriton t'ia japësh, në qoftë se kërkon të bëjë ndërmjetësim, e meriton t'i dëgjohet fjala.

Pastaj aty kaloi një person tjetër, për të cilin Profeti e pyeti atë që kishte pranë:

-Po për këtë person, çfarë mendon?

Këtë herë, ai u përgjigj:

-O i dërguari i Allahut! Ky është një mysliman i varfër. Po kërkonte dorën e një vajze, ia refuzojnë, po deshi të bëjë ndërmjetësim, nuk e respektojnë dhe, kur kërkon të flasë, nuk e dëgjon kush.

Pas këtyre fjalëve i dërguari i Allahut tha: "Ky njeriu i fundit është më i vlefshëm, sesa njeriu i dhënë pas botës, siç ishte ai tjetri." (Buhari, Nikah 15; Ibn Maxhe, Zuhd 5)

Nga ky hadith mësojmë se varfëria nuk është më e mirë sesa pasuria apo se dobësia është më e mirë sesa forca, por njerëzit nuk mund të nënvleftësohen, për shkak se janë të dobët apo të varfër. Vlera e njeriut nuk matet me prejardhjen, pasurinë dhe pozitën e tij, por me devotshmërinë që ka.

Njerëzit shpeshherë mund të japin vlerësime të gabuara. Pasuria, pozita, fama dhe pamja e jashtme të gënjejnë. Në mënyrë që të peshosh dhe të vlerësosh drejt gjërat, duhen përdorur masat e peshës hyjnore. Për të treguar se njerëzit vlerësojnë edhe gabim profeti, ka thënë:

"Ditën e gjykimit do të vijnë njerëzit, që në jetën e përkohshme kanë pasur fizik të madh dhe famë, ndërsa, përpara Allahut nuk do të kenë vlerë më shumë, sesa flatra e një mize." (Rijadu's-Salihin, Hadith no: 257.)

Në lidhje me ata njerëz, që nga pamja e jashtme janë të mahnitshëm, por nga brenda janë të zbrazët, Zoti urdhëron dhe thotë: **"Kur i sheh, ty të mahnitin ata që janë trupmëdhenj. Kur të flasin, ua dëgjon fjalën. Ata janë në të vërtetë si dordolecë të veshur me rroba."** (Munafikun, 4)

E gjithë çështja është të jesh njeri, jo me pamje, por me sjellje. E para është imitim, ndërsa e dyta është origjinale. Zoti na bëftë njerëz të vërtetë! Amin.



Shenjatat e një familjeje të lumtur

M. Sami Ramazanogllu

Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve sellem, ka thënë:

"Tri gjëra e bëjnë të lumtur njeriun në këtë jetë dhe e bëjnë të pikëlluar, në qoftë se nuk i zotëron ato.

Ato që e bëjnë njeriun të lumtur janë: një bashkëshorte e mirë, besimtare dhe e ndershme, një kafshë transporti e mirë, e lehtë dhe e shpejtë, si dhe një shtëpi e gjerë dhe e rehatshme. Ndërsa jetën njeriut ia bëjnë të vështirë tri gjëra: një shtëpi e keqe, e ngushtë dhe me probleme, një kafshë transporti e keqe dhe një bashkëshorte e paedukatë." (Ebu Davud)

Me kafshën e transportit nënkuptohet çdo lloj kafshe apo mjeti transporti. Rasti i shtëpisë që nuk është e ngushtë, e keqe dhe me probleme, duhet trajtuar në varësi të gjendjes ekonomike të individëve të ndryshëm, sepse ka shtëpi të ngushta, që për një pjesë të njerëzve konsiderohen të mëdha.

"Martohuni, sepse unë do të mburrem me numrin e pasuesve të mi përpara umeteve të tjera." (Taberani)

"Martohuni dhe mos u divorconi, sepse Allahu nuk i do, as meshkujt dhe as femrat, të cilëve u intereson vetëm qejfi dhe rehatia e tyre."

"Njeriu më i keq është ai që përdor dhunën ndaj familjes së tij." (Taberani)

Autori i librit Menavi, shkruan se hadithi nga është shkëputur kjo pjesë, është kështu:

Sahabët e pyetën profetin:

- O i Dërguar i Allahut! Si mund të bëjë presion njeriu mbi familjen e tij?

Ai tha:

- Kur njeriu vjen në shtëpi, e shoqja dridhet nga frika dhe fëmija nuk do t'i vijë pranë, ndërsa kur ai del nga shtëpia, gruas së tij i qesh fytyra. Familja e tij bie sërish në qetësi dhe prehje, kur ai largohet.

"O të rinj! Ai që ka mundësi ekonomike të martohet, le të martohet, sepse martesë është pengesa e syve kundër haramit dhe zgjidhja që ruan nderin. Ai që nuk ka mundësi ekonomike të martohet, le të agjërojë nafle, sepse agjërimi do ta ndihmojë atë të mbrohet nga harami. Agjërimi e gjunjëzon nefsën dhe e zhdruk epshin." (Buhari, Muslim)

"Gruaja që sjell me vete më shumë bereqet, është ajo që ka kërkesa më të pakta ndaj burrit." (Ahmed b. Hanbel)

Gratë, një pjesë e të cilave, si në martesë ashtu edhe pas tyre hapin dyert e shpenzimeve të llojllojshme, të panevojshme, duke e lodhur për këtë arsye, si familjen e tyre, ashtu edhe shoqërinë me këto shpenzime, si rezultat i të cilave shkaktohen mosmarrëveshje, ndarje dhe divorcime të shumta, duhet t'ia vënë veshin këtij hadithi të Profetit Muhamed, në qoftë se janë besimtare:

"Në qoftë se Allahu zgjon në zemrën e një personi dëshirën që të martohet me një grua apo një vajzë të re, nuk është gjynah që mashkulli ta shohë femrën me të cilën dëshiron të martohet." (Ibn Maxhe)

Kushti që të dëshirosh të shohësh me synim martesën, jo vetëm që e ndalon mashkullin të shohë me epsh, por edhe e pengon të shohë femra që nuk janë të së njëjtës sërë (kufv) me të. Ashtu siç kuptohet edhe nga komentatorët e këtij hadithi, mashkulli do të mjaftohet vetëm duke parë duart dhe fytyrën e femrës, me të cilën dëshiron të martohet. Ai mund ta shohë atë më shumë se një herë.

"Martesë më e hairit është ajo që nuk sjell vështirësi dhe probleme ekonomike." (Ebu Davud)

"Në qoftë se gruaja lyhet me erë të mirë, që ta nuhasë dikush tjetër përveç burrit të saj ka, për të fituar me këtë veprim vetëm zjarrin e xhehenemit." (Taberani)



Familja në perspektivën e realitetit

Nuredin Nazarko

Formimi i familjes

Qenia njerëzore vjen në jetë nëpërmjet formimit të familjes nga paraardhësit e saj, në themel të së cilës qëndron institucioni i martesës. Martesa është institucioni legal që lidh, bashkon një burrë dhe një grua në lidhje martesore, duke iu mundësuar të jetojnë si bashkëshortë, çka iu jep të drejtën të kenë edhe pasardhës, të cilët nga ana e tyre, në një stad të caktuar të jetës do të jenë protagonistë të formimit të një familjeje të re. Që të mbërrihet deri në formimin e familjes, paraprakisht individët e dy gjinive të kundërta duhet të kenë rënë dakord që të bashkohen në një lidhje legjitime. Ky është një hap i rëndësishëm dhe bazik, pasi që gjithë rrjedha e ngjarjeve të mëpasshme në familje dhe më gjerë, merr trajtën dhe ngjyresat që përftohen nga veprimi i personaliteteve të burrit dhe gruas. Nuk është e rëndësishme që thjesht dhe vetëm të bashkohen një burrë dhe një grua, në një martesë dhe ja, e formuam familjen. Pyetja më e rëndësishme që shtrojmë këtu, është se çfarë personaliteti kanë burri dhe gruaja që do të bashkohen në martesë, për të formuar familjen? E shtrojmë këtë pyetje, sepse formimi dhe edukimi i pasardhësve, pavarësisht faktorëve të tjerë që implikohen në formimin dhe edukimin e fëmijëve, varet në masën kryesore nga mjedisi familjar. Prandaj është e rëndësishme që protagonistët e formimit të familjes së ardhshme të bëjnë një vlerësim respektiv të personalitetit të njëri-tjetrit, para se të marrin vendimin përfundimtar për t'u bashkuar në martesë, për të shmangur me aq sa është e mundur të shmangen, pasojat e padëshirueshme, të cilat mund të kenë një influencë negative në raportet e familjes së re. Shtruan çështjen e personalitetit si më të rëndësishmen, pasi jeta njerëzore asnjëherë nuk mund të ketë ecuri konstante. Herë – herë rrjedh e qetë, aq sa të krijohet përshtypja se punët ecin vaj, herë – herë dallgëzohet dhe të përfund nën shkulmet e saj e herë – herë të vërvit në lartësira të rrezikshme. E në gjithë këtë ecuri oshilative, ata të cilët durojnë dhe mbeten, janë personalitetet e edukuara dhe të ndriçuara nga sistemi i vlerave që burojnë nga parimet e epërme, edukim që ka arritur deri në thellësinë e zemrës, e jo vetëm si shfaqje përjashtësore e bindjes ndaj këtyre parimeve. Njeriu di çfarë ka kaluar, por kurrë nuk mund të dijë se çfarë surprizash i ka rezervuar fati në të ardhmen. Gjithsesi mbetet të themi që ekzistenca e personaliteteve të mirëfillta dhe përfshirja e tyre në martesë, është një premisë qenësore, për mënyrën se si do të operojë familja e re në përballimin e surprizave që fati iu ka rezervuar. Nuk duhet të lëmë jashtë vëmendjes rolin e personalitetit prindëror në ndihmën që duhet t'u ofrojë

pasardhësve të vet, në momente të tilla deçizive, pasi shpesh aktorët e formimit të familjes së re, duke qenë të përfshirë nga situata emocionale të forta dhe ndoshta nga një vlerësim përjashtësor i gjërave, mund të vendosin nën efektin e emocionalitetit dhe ndjesive momentale, ndaj personit të gjinisë së kundërt, me të cilin apo me të cilën dëshirojnë të formojnë një familje, duke anashkaluar pjesërisht apo tërësisht këshillat e personalitetit prindëror.

Familja përballë sfidave

Njeriu lind, rritet, zhvillohet, formohet, edukohet në mjedisin e tij familjar. Aty mëson fjalët e para, aty hedh hapat e parë, aty ndjen dhe përjeton përkëdhelitet e para, shprehjen e dashurisë dhe vëmendjes ndaj tij, aty ndjen dhe përjeton edhe "ndëshkimet" e para. Por mbi të gjitha, aty përballet drejtpërdrejt me modelet, me shembujt e parë të sjelljes dhe qëndrimeve të prindërve apo gjyshërve të tij, në qoftë se familja është paksa e zgjeruar, lloj në zhdukje e sipër kjo e fundit. Sidoqoftë, nuk është e rëndësishme që thjesht të kesh pasardhës biologjikë, që do të vijojnë trungun e pemës gjenealogjike të familjes. Çështja nuk është thjesht të kesh, por si do t'i përdorësh ato që ke, duke mbajtur gjithmonë në konsideratë qëllimin, përse? Në lidhje me çështjen në fjalë, nuk është çështja thjesht të kesh pasardhës, por mbi të gjitha si do t'i edukosh ata, çfarë shembulli dhe modeli do t'u ofrosh atyre për t'i sendërtuar si personalitete të qëndrueshëm përballë oshilacioneve të jetës dhe sfidave të kohës në të cilën jetojmë? Prandaj dhe i rikthehemi rëndësisë që ka personaliteti prindëror si premisë për edukimin e pasardhësve, sepse, në qoftë se njeriu nuk ka, atëherë nuk ka as çfarë të japë, përveçse aq sa ka prej personalitetit apo impersonalitetit. E çështja e të qenit ose jo personalitet i mirëfilltë, mbetet një sfidë e hapur ndaj njeriut, për aq sa ecën dhe merr frymë mbi sipërfaqen e dheut. Çdokush që bën një zgjedhje, mbart një përgjegjësi e, bashkë me të edhe pasojat që shkakton vendimmarrja. Kushdo që merr vendimin për të formuar familje apo për të pasur pasardhës, duhet të dijë se është përgjegjës direkt mbi atë çfarë ka marrë përsipër të jetësojë. Kjo nuk do të thotë që kush vepron të kundërtën i ka shpëtuar përgjegjësisë, pasi në çdo moment të jetës, njeriut i duhet të zgjedhë, i duhet të vendosë se çfarë do të bëjë me jetën e tij apo të atyre që i ka nën përgjegjësinë e tij. Më sipër përmendëm se, përveç mjedisit familjar në sendërtimin e njeriut si personalitet ose jo, përveç familjes, implikohen aktorë të tjerë, herë eksplicitë e herë implicitë e askush nuk mund të shmanget ndaj kësaj përballjeje, sepse njeriu është i rrethuar përçdoanshëm me përballje. E në qoftë

se njeriu i shmaget kësaj përballjeje, a thua nuk do të përballet me ikjen nga përballja? Le të qëndrojmë me këmbë në tokë dhe jo duke u endur ëndërrimeve që përvihen si hije në natën e errët, për të demoralizuar njeriun nga përballja me të vërtetën e realitetit në të cilin gjendet dhe me të cilin jeton, e ta kundrojmë realitetin me një vështrim depërtues, deri në thellësinë e tij, për të njohur dhe kuptuar sfidat, të cilat na qëndrojnë përkundruall, si për të na thënë se ku janë fjalët e bukura dhe teorizimet? A kanë buruar prej thellësisë së zemrës së sinqertë apo kanë qenë shtrembërim i këtij sinqeriteti dhe mbulojë e deformimeve të personalitetit e, duke shkuar më tej, na thonë se ne jemi vlerësuesit tuaj se çfarë në të vërtetë jeni ju.

Dinamika e zhvillimeve në ditët që jetojmë është kaq intensive, sa që tendosja tradicionale për ta mbajtur familjen të bashkuar dhe nën disa rregulla të caktuara, ku në rend të parë ishte morali, jo i përkthyer thjesht në çështje ndershmërie, qenësore për mbajtjen në këmbë të familjes, është duke u bjerrur dita më ditë. Familja tradicionale, jo në kuptimin e atij përfytyrimi negativ të patriarkut fisnor që ushtron përdhunshëm autoritarizmin e tij ndaj atyre që i ka nën pushtetin e tij, është gjendur dhe vazhdon të gjendet nën trysinë e disa ideve të caktuara, të cilat duke u shfaqur si tepër rrezëlitëse përsëjashmi, kanë mikluar dhe joshur jo pak brezin e ri, duke krijuar më së pari kundërvënien mes brezave, duke e prezantuar si një kundërvënie mes të resë dhe të vjetrës, e cila duhet të hiqet osh, përballë zhvillimit dhe emancipimit të së resë, që gjithmonë merr salutime pa fund, për rezistencën dhe luftën që zhvillon ndaj gjërave të vjetëruara. Kjo mendësi e kundërvënies mes brezave, gjeneron konflikte pa fund mes atyre familjeve ku janë prezentë dhe gjyshërit me gjyshet, aq sa respekti dhe mëshira ndaj këtyre të fundit janë përkthyer në urrejtje të papërmbajtshme, ndaj normave të tyre të vjetëruara e të dala boje. Kësisoj, thyhet uniteti familjar dhe ekzistenca e një familjeje të bashkuar e raportet brendafamiljare janë të rrezikuara paq. Një tjetër ide mjaft nderzullitëse, për të mos thënë më nderzullitsja që qarkullon dendur, është barazia gjinore, e cila merr ngjyrimë dhe interpretime sipas kahjes së interesave që mëton të yshtë. Përballë kësaj ideje, më të impresionuara ndihen femrat, të cilat kërkojnë të rivalizojnë me burrat në çdo fushë të jetës. Megjithatë, le të kthehemi tek çështja e familjes. Askush nuk e mohon rëndësinë që ka respekti ndaj gruas në familje, madje duhet ta theksojmë fort se familja është një unitet mes burrit dhe gruas, pasi që secili prej tyre shpërfaq natyrë krejt tjetër nga gjinia e kundërt dhe këto kundërti shkrihen e bëhen një në familje. Barazia gjinore nuk mëton të respektojë këtë diversitet të shkrirë mrekullisht në unison prej institucionit të martesës, madje ajo ecën në kahje krejt të kundërt. Njëpërmytet përpjekjeve për jetësimin e kësaj ideje, ngjarjet brenda familjes rrjedhin me një mbrapshtkim që gjeneron konflikte mes vetë bashkëshortëve, pasi që gratë kërkojnë të njëjtën pozitë dhe status me burrat, duke dalë nga natyrshmëria e natyrës në të cilën janë krijuar, a thua se do të arrijnë të dalin përtej kufijve që iu janë përcaktuar të mos i kalojnë kurrsesi. Dhe një mjedis konfliktual nuk është kurrsesi një mjedis model dhe shembull i mirfilltë për brezin që rritet në këtë lloj mjedisi familjar. Ky konflikt është forcuar, pasi është i ndihmuar edhe nga punësimi i grave jashtë familjes, si rezultat i nevojës për të përballuar financiarisht jetesën. Nuk është se jemi kundër punësimit të

grave në tërësi, por duhet ditur që rolin e nënës në edukimin e pasardhësve do ta marrë në rastin më të mirë gjyshja dhe gjyshi dhe kjo është ajo që kërkohet, por në mungesë të tyre, sepse nuk jetohet me ata që prodhojnë vjetërsi erëmykëse, edukimi i fëmijëve mbetet në dorën e zinxhirit të mekanizave që sistemi ka ofruar, për të lehtësuar barrën e nënave prej fëmijëve të tyre. Pavarësimi ekonomik i gruas e bën më kapriçoze dhe ndoshta e vetëvlerëson vetveten më tepër nga sa e meriton ta vlerësojë e, si rrjedhojë rebelohet ndaj autoritetit dhe jo autoritarizmit të burrit. Kur nuk kuptohen gjërat sipas natyrshmërisë së tyre edhe veprimet do të kryhen po sipas denaturshmërisë. Kësisoj, duke dalë nga rendi natyror i gjërave, përplasjet brendafamiljare, forca e tyre dhe pasojat varen nga shkalla e denaturshmërisë dhe thellësia e saj. E çfarë iu prezantohet fëmijëve në kësilloj situatash? Ideja e barazisë ka bërë që njerëzit të mos njohin asnjë lloj autoriteti, sepse të gjithë janë të barabartë pa dallim e, si rrjedhojë, humbet respekti për më të vjetrit, gjyshin dhe gjyshen, për babain dhe nënën, duke minuar së brendshmi unitetin familjar. Nuk ndërmendim aspak ta kategorizojmë gruan në gjendjen e një statusi fare të papërfillshëm, në raport me statusin e burrit, madje na duhet të pranojmë që, pas edukimit të burrave dhe grave të së ardhmes, qëndron personaliteti i nënës. Kjo do të thotë që, në qoftë se do që t'i vjedhësh personalitetin brezit të ardhshëm, atëherë duhet t'u shkatërrosh personalitetin prindërve dhe kryesisht nënës, pasi në pikëpamjen tradicionale, nëna ka pjesën më të madhe në edukimin e fëmijëve. E civilizimi bashkëkohor pikërisht këtë ka realizuar.

Civilizimi e shpalli amësinë robëri dhe femrës i premtoi ta lirojë. Me mburrje ai jep të dhëna se sa gra i ndau (i liroi – thotë ai) nga familja dhe fëmijët, për t'i bërë nëpunëse. Përkundër kësaj, e tërë kultura, që nga lashtësia e deri më sot, është në shenjën e apologjisë së nënës. Nga nëna ajo bëri simbol, mister, shenjteri. Vargjet më të bukura, tonet më tronditëse dhe pikturat e skulpturat më të dalluara, ia kushtoi nënës. Gjersa në botën e civilizimit vazhdon agonia e nënës, Picasso krijon pikturën e vet madhështore *Amësia* – dhe me këtë himn të mrekullueshëm për nënën, shpall se për kulturën Nëna është ende gjallë. (Izetbegović, A. (2000) *Islami ndërmjet Lindjes dhe perëndimit*. Shkup: Furkan ISM: 233)

Duke yshtur jetësimin e të tilla mendësive, medoemos që pasojat nuk do të vonojnë të rëndojnë mbi ata që shihen me optimizëm si brezi i së ardhmes. Këto mendësi kanë prodhuar brezin e çakërrqejfit, prindër flamurbardhë përballë forcës rinore të pasardhësve të tyre, dhe shprishje të personalitetit njerëzor, si pasojë e keqeducimit që origjinon prej mendësisë: një jetë kemi dhe njëherë do ta jetojmë. E në këtë mjedis që nxit dhe prodhon konfliktualitet, vështirësohet komunikimi prindër-fëmijë dhe si rezultat i moskomunikimit të hapur dhe konstruktiv, këta të fundit gjejnë prehje në mjedisin social, duke zëvendësuar dashurinë dhe ngrohtësinë familjare me "dorën e ngrohtë" të këtij mjedisi. Prandaj është e rëndësishme të kuptohen drejt çështjet që kërcënojnë stabilitetin dhe shprishjen e familjes si fole e dashurisë, ngrohtësisë, harmonisë dhe tolerancës mes anëtarëve të saj, në mënyrë që të krijohet një mjedis familjar i shëndetshëm, për të dhënë fryte me personalitet të shëndetshëm. E së fundi, le të mos harrojmë se më i miri prej nesh, është ai që është më i miri me familjen e tij.

Kalorësi më i mirë

Ukkashe Ibn Mihsani (r.a.)

Mustafa Erish

Ukkashe ibn Mihsani, radijallahu anh, ishte një sahabi që fitoi lavdërimin e të Dërguarit të Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, i cili e quajti: *"Kalorësi më i mirë!.."*

Ai ishte një djalë i ri që nuk i humbiste shanset, i kujdesshëm, i zgjuar dhe trim!..

Ai ishte një hero që printe përpara në betejat e luftërave dhe që binte në sy me sjelljet e tij prej fisniku!..

Ai ishte një trim që njihej me nofkën "njeriu më i bukur", për shkak të bukurisë fizike dhe morale që kishte!..

Lindi dhe u rrit në Mekë. I përkiste fisit të beni Esedëve. Kur ishte njëzet vjeç, e mësoi Islamin në mënyrë të fshehtë. Bashkë me vëllanë e tij, Ebu Sinanin, iu dorëzuan të Dërguarit të Allahut, sallallahu alejhi ve sellem dhe u nderuan me Islamin.

Ai nuk u nda kurrë nga dielli i dy botëve, nga i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem. Ka qëndruar në shtëpinë e Erkamit. Falte namaz bashkë me Hz. Pejgamberin dhe mësonte ajetet e Kuranit që vinin me anë të shpalljes. Islamin ua kumtoi të afërmeve të tij dhe u përpoq që edhe ata të bëheshin myslimanë. Motra e tij, Ummu Kajs, radijallahu anha, u bë myslimane për shkak të tij.

Politeistët mekas nuk mund ta pranonin faktin se një

djalë i ri dhe i pashëm si Ukkashe, ishte bërë mysliman. Ata u përpoqën ta largonin nga feja, duke e torturuar dhe duke i bërë presion, por nuk ia arritën qëllimit. Ai nuk e la kurrë besimin dhe nuk doli prej Islamit.

Kur dhuna, tortura, padrejtësia dhe poshtërimi u shtuan në Mekë, Ukkashe, radijallahu anh, shkoi në Medine bashkë me Abdullah ibn Xhahsh, radijallahu anh, i cili ishte po prej të njëjtit fis.

Kur u bë xhamia, qëndroi në suffe dhe vazhdoi të mësojë dijen e urtësinë nga i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem.

Politeistët e Mekës nuk i lanë rehat myslimanët edhe në Medine. Atyre u hapën luftë, që të shfarosnin Islamin. Kur Allahu dha leje për xhihad, lufta filloi.

Ukkashe, radijallahu anh, mori pjesë në të gjitha luftërat, si Bedri, Uhudi, Hendeku etj. (el-Istiab, III, 1080.)

Ai mori pjesë në betejën e Abdullah ibn Xhahshit, e cila filloi e para. Aty tregoi mençuri dhe zgjuarsi. Këto cilësi që shfaqti aty, tregohen kështu:

"I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, një vit e gjysmë pas hixhretit, në muajin Rexhep, dërgoi një grup prej dymbëdhjetë burrash në vendin e quajtur Batn en-Nahle, për të ndjekur karvanin e Kurejshëve.

Karvani po pushonte. Kur i panë myslimanët, menjëherë u mblodhën. Ukkashe, radijallahu anh, e rruajti kokën dhe u afrua te ata, që të mos ikinin.

Kur e panë Ukkashen në këtë gjendje, thanë: "Këta kanë ardhur për të bërë umren". Kështu u qetësuan.

Sahabët përfituan nga qetësimi i tyre. Kështu që i sulmuan, i kapën robër dhe u kthyen në Medine. Ndërsa Abdullah ibn Hadramin, që tentoi të ikte nga karvani, e vranë. Kjo ishte beteja e parë, përplasja e parë dhe hera e parë që myslimanët vrisnin një njeri." (Bejhaki, Delail, III, 17-21; Ibn Sa'd, II, 10.)

Ukkashe, radijallahu anh, ishte një trim që nuk i trembej syri dhe i guximshëm. Në luftën e Bedrit, shfaqti heroizëm të madh me degën e hurmës që kishte në dorë. Ai e tregoi kështu atë ditë:

"Hyra në mes të rreshtave të armikut, dhe e hidhja në tokë atë që më dilte përpara. Në një moment, m'u thye shpata. Menjëherë shkova te i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem dhe i tregova. I Dërguari i Allahut (s.a.s.), më dha një degë hurme dhe më tha: "Lufto me këtë, o Ukkashe!"

Unë nuk refuzova. E mora degën e hurmës dhe u ktheva në mejdanin e luftës. Dega që kisha në dorë, u kthye në një shpatë të fortë e shumë të bardhë. Unë luftova me këtë shpatë, derisa politeistët e humbën luftën." (Ibn Kethir, el-Bidaje ve'n-Nihaje, III, 291; Usdu'l-Gabe, IV, 64.)

Një ditë, kur i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, po qëndronte me shokët e tij, foli për heroizmin e atij dhe tha: "Kalorësi më i mirë, është i yni." Sahabët i thanë:

"Kush është ai, o i Dërguari i Allahut?" I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, u përgjigj: "Ai është Ukkashe ibn Mihsani."

Ukkashe, radijallahu anh, komandoi edhe në luftën e Gamres. Ishte viti i gjashtë i hixhretit. Myslimanët ishin njoftuar se beni Esedët do t'i sulmonin.

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, përgatiti një grup ushtarak prej dyzet vetësh me në krye Ukkashen, radijallahu anh dhe i dërgoi në Gamre, i cili ishte vendi ku banonin beni Esedët. Ukkashe kapi disa njerëz rob, mori dyqind deve dhe u kthye në Medine.

Ai ishte i mençur, trim dhe kishte një personalitet shumë të spikatur. Mundësitë që i jepeshin, i përdorte menjëherë për Islamin. Ai mbështetej shumë te Allahu. Sjelljet e tij të zgjuara dhe të kujdesshme, përmenden në këtë hadith.

"Një ditë, i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, njoftoi se Allahu Teala do t'i mbrojë në dynja dhe në ahiret robërit, që i mbështeten atij dhe se ata do të hyjnë në xhenet, pa dhënë llogari dhe pa u ndëshkuar. Ai (s.a.s.), tha:

"Mua më janë treguar popujt e kaluar.

Pashë peygamber, që pranë tij kishte një grup katër-pesë vetësh.

Pashë peygamberë, që kishin pranë vetëm një-dy vetë.

Po ashtu, pashë peygamberë, që nuk kishin asnjë me vete.

Në ato momente, përpara meje doli një kallaballëk i madh.

Kujtova se është umeti im.

Mua më thanë: "Këta janë umeti i Musait. Ti shiko në horizont!"

Pashë. Shikova një turbullirë.

Ja, ky është umeti yt.

Ndërmjet tyre ka shtatëdhjetë mijë vetë, që do të hyjnë në xhenet, pa dhënë llogari dhe pa u ndëshkuar."

Ibn Abbasi, radijallahu anhuma, thotë: "Kur tha këtë, i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, u ngriti dhe shkoi në shtëpinë e tij. Sahabët që ndodheshin aty, filluan të bisedonin rreth faktit se kush mund të ishin ata shtatëdhjetë mijë vetë.

Disa thoshin: "Ata janë njerëzit që kanë qenë prezentë në kuvendet e peygamberëve." Disa të tjerë, thoshin: "Ata janë njerëz që kanë lindur pasi ka ardhur Islami dhe nuk kanë bërë shirk asnjëherë." Kur ata po bisedonin rreth kësaj çështjeje, erdhi i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem. Sahabët e nderuar, i thanë:

"Po flasim rreth atyre që do të hyjnë në xhenet, pa dhënë llogari dhe pa u ndëshkuar." I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, u tha:

"Ata janë njerëz që nuk bëjnë magji, nuk urdhërojnë për diçka të tillë, nuk i besojnë fatit të keq dhe i mbështeten Allahut."

Ukkashe ibn Mihsani, sapo e dëgjoi këtë, u ngriti nga vendi dhe tha:

"Bëji dua Allahut që edhe mua të më bëjë prej tyre, o i Dërguari i Allahut!"

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, i tha:

"Ti je prej tyre!"

Pastaj u ngriti një sahabi tjetër dhe tha:

"Lutu që edhe unë të jem prej tyre, o i Dërguari i Allahut!" I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, këtë herë, tha:

"Ukkashe veproji më shpejt se ti, për ta vlerësuar këtë mundësi. Ukkashe të kaloi në këtë çështje." (Muslim, Iman, 374; Buhari, Rikak, 50.)

Hazreti Ebu Bekri, radijallahu anh, në kohën e hilafetit të tij, në vitin e dymbëdhjetë të hixhretit, dërgoi nën komandën e Halid ibn Velidit, radijallahu anh, një ushtri te banorët e Tulejhas, të cilët kishin lënë fenë. Ukkashe, radijallahu anh, gjendej në këtë ushtri.

Ai, bashkë me Thabit ibn Erkamin, radijallahu anh, u dërguan atje si forcë e hekurt kundër armikut. Kur sulmoi për t'iu afruar Tulejhas, ra dëshmor në moshën dyzet e katër vjeçare. (Usdu'l-Gabe, IV, 64.)

Allahu qoftë i kënaqur me të!

Allahu Teala na e mundësoftë të jetojmë si kalorës të mirë, në shërbim të Islamit dhe na e bëftë të mundur të marrim pjesë nga shefati i Ukkashes, radijallahu anh. Amin.

Rëndësia e familjes dhe EDUKIMI i rinisë

Shaban Ishlek

Unë dëshiroj të shtjelloj një temë, e cila ka rëndësi të madhe në shoqërinë tonë, por faktikisht, rëndësia e kësaj çështjeje është neglizhuar pak, si brenda dhe jashtë vendit. Tema për të cilën dua të flas është: "Rëndësia e familjes dhe edukimi i rinisë".

Familja është një vatër e ngrohtë dhe një bashkim i shenjtë, ku përjetohej ndjenjat, si butësia, mëshira, sakrificat etj., në të cilin gëzimet dhe fatkeqësitë ndahen me individët e tjerë dhe një pjesë e jetës, pa të cilën njerëzit nuk do të jetonin dot. Sepse në familje gjenden nënat, që janë heroinat e butësisë dhe kurorat e kokës, baballarët që janë shtylla e shtëpisë, edhe pse nuk e shfaqin ndjesinë e tyre dhe fëmijët që janë bebjë e syrit, lulja dhe fryti i saj.

Burimi i qetësisë familjare është një vatër e ngrohtë, në të cilën zemrat e njerëzve, që ndoshta nuk jetojnë në luks, por janë të qetë, ndoshta nuk janë të pasur, por të gëzuar e që ndjejnë për njëra-tjetrën, pra, një vatër e ngrohtë, që e formojnë njerëzit që mbartin pasurinë dhe lumturinë e kësaj bote e të botës tjetër.

Martesa dhe jeta familjare kanë dobi dhe urtësi të shumanshme, për shkak se i mundëson bashkëshortët të formojnë një shoqëri të përjetshme, duke e ndihmuar njëri-tjetrin shpirtërisht dhe materialisht brenda kornizës së dashurisë, mirëkuptimit dhe tolerancës reciproke. Mbi të gjitha në kurbet, ngrohtësia familjare ka një rëndësi të veçantë.

Rëndësi të madhe ka edhe edukimi i fëmijëve dhe i të rinjve, që janë fryti i familjes. Kjo është akoma edhe më e rëndësishme, kur njerëzit që kanë kultura të ndryshme, jetojnë bashkë dhe ndajnë të njëjtin ambient. Kjo faktikisht, nuk është diçka shumë e vështirë.

Nëse individët i zbatojnë vlerat e tyre nacionalo-shpirtërore brenda kornizës së respektit, mirëkuptimit dhe tolerancës, duke u bashkuar reciprokisht në gjërat e përbashkëta dhe nëse në të njëjtën kohë formohet një brez dinamik, punëtor, i ditur dhe i edukuar, duke respektuar gjykimet e vlerave të shoqërisë ku jetojnë, atëherë formohet një mirësi dhe kompozicion i veçantë.

TË DREJTAT E PRINDËRVE DHE RESPEKTI NDAJ TË MOSHUARVE

Familja është institucioni i parë më efikas për transmetimin të brezat e rinj dhe për përjetësimin në shoqëri, të vlerave sociale, kulturore, fetare dhe etike. Individit e mëson në familje solidaritetin, ndarjen, ndihmën reciproke, shërbimin pa kushte, mbrojtjen e të drejtës, dashurinë, respektin dhe mëshirën. Gjërat që përjetohej në familje, kanë shumë rëndësi nga aspekti i të ardhmes së shoqërisë.

Dashuria dhe respekti janë bazat themelore të vatrës familjare, e cila është mbështetësja më e fortë e solidaritetit, kompromisit, bashkimit dhe unitetit.

RESPEKTI DHE MIRËSIA NDAJ PRINDËRVE, JANË URDHËR I ALLAHUT

Siç kanë të drejta fëmijët në familje, kundrejt prindërve të tyre, po ashtu edhe prindërit kanë të drejtat e tyre kundrejt fëmijëve. Vlen të theksohet se të drejtat e prindërve kundrejt fëmijëve, janë më të rëndësishme dhe më primare. Respektimi i të drejtave të prindërve, zë një vend ndërmjet përgjegjësisë besimore dhe morale në fenë islame.

Në Kuranin fisnik dhe në hadithe, menjëherë pas adhurimit dhe bindjes ndaj Allahut, theksohet domosdoshmëria e res-

pektimit të prindërve. Nëse një njeri i bën shirk Allahut, sillet keq ndaj prindërve dhe vret fëmijët e tij, duke u frikësuar nga varfëria, ai ka bërë disa vepra që konsiderohen si mosbindja më e madhe që mund të bëhet kundrejt Allahut. Kjo çështje shprehet kështu në Kurandin fisnik:

Thuaju: “Ejani t’ju lexoj çfarë ju ka urdhëruar Allahu: të mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim); të silleni mirë me prindërit; të mos vrisni fëmijët tuaj për shkak të varfërisë...” (el-En’am, 151)

Siç nuk ka ndonjë justifikim shirku ndaj Allahut, edhe sjellja e keqe ndaj prindërve nuk ka ndonjë arsye të drejtë e të pranueshme. I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, shprehet se këto sjellje janë prej mëkateve më të mëdha:

Ai (s.a.s.), tha tri herë: “A t’ju tregoj mëkatet më të mëdha? Shirku ndaj Allahut, mosbindja ndaj prindërve dhe dëshmia e rreme (ose gënjeshtria).”¹

Ndërprerja e marrëdhënieve me prindërit, ndërprerja e marrëdhënieve me farefisën dhe çdo sjellje apo fjalë që ua thyen zemrën atyre, është mosbindje ndaj prindërve. Për këtë arsye, ne duhet ta dëgjojmë fjalën e atyre në çështje që nuk janë mëkat për t’i bërë apo për t’i thënë.

Prindërit janë shkaku i ekzistencës së fëmijëve dhe njerëzit që i kanë rritur e edukuar ata me dashuri. Sakrificat që përballojnë prindërit, për shkak të dashurisë që kanë ndaj fëmijëve dhe lumturisë së të qenit prindër, vlen më shumë se çdo gjë. Pothuajse është e pamundur të shprehet me fjalë shkalla e interesit dhe e përpikërisë që shfaqin prindërit në zhvillimin, pastrimin, edukimin dhe në çdo lloj nevoje tjetër të fëmijëve.

Për këtë arsye, Zoti i lartësuar, që ka krijuar njeriun dhe që ia di më mirë gjendjen shpirtërore atij, këtë çështje e shpreh me fjalë hyjnore dhe në mënyrë të përshtatshme ndaj natyrshmërisë së njeriut:

“Zoti yt ka urdhëruar, të mos adhuroni askënd tjetër përveç Atij dhe të silleni mirë me prindërit. Nëse njëri prej tyre ose të dy arrijnë pleqërinë te ti, mos u thuaj atyre as “uh!”, mos i kundërshtoj, por drejtoju atyre me fjalë respekti. Lësho para tyre krahët e përuljes prej mëshirës dhe thuaj: “O Zoti im, mëshiroji ata, ashtu siç më kanë rritur, kur unë isha i vogël!” (el-Isra, 23-24)

Fjalët “Rabb” dhe “murebbi”, që kanë kuptimin, dhënës i riskut, ushqyes, rritës dhe edukues, janë fjalë që vijnë nga e njëjta rrënjë. Rabb përdoret për Allahun, ndërsa murebbi, përdoret për njerëzit. Edukuesit e parë të fëmijës, nga aspekti njerëzor, janë prindërit. Për shkak se ata e kanë marrë përsipër këtë detyrë dhe përgjegjësi hyjnore, njeriu duhet të sillet mirë ndaj prindërve, sepse kjo është e rëndësishme

1. Muslim, Iman, 143, I, 91.

sa adhurimi dhe ibadeti që bëhet ndaj Zotit, i cili, në kuptim absolut, i ka dhënë risk atij dhe e ka krijuar me një natyrë të pastër.

Hadithi fisnik, i transmetuar nga Abdullah b. Amr dhe që ka lidhje me këtë çështje, është shumë domethënëse:

“Një ditë, Hz. Pejgamberit (s.a.s.), i erdhi një burrë dhe i tha:

“Po të jap besën për hixhret dhe xhihad. Ndërsa shpërblim e kësaj e pres nga Allahu.” I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, e pyeti:

“A e ke gjallë ndonjërin prej prindërve?” Burri iu përgjigj:

“Po! Madje të dy!” I Dërguari i Allahut (s.a.s.), i tha:

“A kërkon shpërblim nga Allahu?” Burri u përgjigj:

“Po!” Pastaj, i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, i tha:

“Atëherë, kthehu menjëherë pranë prindërve dhe bisedo këndshëm me ta.”²

BESIMTARËT NUK DUHET TË SHFAQIN SJELLJE QË I BRENGOSIN PRINDËRIT

Të moshuarit, për të cilët mund të themi se janë guri bazë i shoqërisë dhe të cilët kanë më shumë përvojë se individët e tjerë të familjes, qofshin të rriturit apo fëmijët, kanë një rol shumë të rëndësishëm në bashkimin familjar. Në këtë periudhë të veçantë të tyre, duhet të kemi kujdes në fjalët dhe në sjelljet që do të shfaqim ndaj atyre. Veçanërisht, në kohën e pleqërisë, te njeriu mund të shfaqet më shpesh humbja e energjisë, gjallërim, aftësia e përdorimit të ndjenjave, fillimi i pakësimit të fuqisë së gjykimit dhe problemet në komunikim.

Edhe pse e njëjta gjë nuk shfaqet te të gjithë të moshuarit, nganjëherë vihet re se pleqëria sjell me vete edhe disa fobi.

Të moshuarit kanë një strukturë më delikate në këtë periudhë. Për këtë arsye, nuk duhet t’i lëndojmë, nuk duhet t’i shikojmë me zemërim, nuk duhet ta ngremë zërin pranë tyre dhe duhet t’u shërbejmë që t’i bëjmë të lumtur. Sjelljet, të cilat bëhen shkas që ata të mendojnë se janë njerëz të padëshiruar, ua shkatërrojnë ndjenjat e besimit në vetvete dhe ua pakësojnë harmoninë individuale e shoqërore.

Kur njerëzit me pozitë të lartë zyrtare bëjnë vizitë në ndonjë qendër shëndetësore, përgjithësisht në pavijonin ku mjekohen të moshuarit, përballen me ndalimin e vizitës në katin ku gjenden të moshuarit e sëmure rëndë. Shkaku i këtij ndalimi shprehet kështu: “Të sëmuret që ndodhen aty, e kanë frymën të numëruar.”

2. Muslim, Birr, 6, IV, 197.

Ndoshta po jetojnë momentet e fundit të jetës, që Allahu i lartësuar u ka dhënë atyre. Shprehja e fytyrës suaj, që do të shfaqet para tyre, mund t'ua shuajë gëzimin për të jetuar. Në këtë mënyrë, mund të bëhet shkak për pikëllimin e tyre. Nisur nga kjo, nuk është parë e arsyeshme që t'i vizitoni ata. Nëpunësit që u shërbejnë atyre, veprojnë duke i pasur parasys këto gjëra."

Kjo ndjeshmëri që tregohet ndaj njerëzve të sëmurë dhe të moshuar, që po jetojnë çastet e fundit të jetës, duhet të përfshijë të gjitha momentet e jetës së tyre.

SHËRBIMI NDAJ PRINDËRVE, BËHET SHKAK QË NJERIU TË HYJË NË XHENET

Çdo shërbim që bëhet me zemër kundrejt prindërve dhe çdo fjalë që i gëzon ata, nuk të jep vetëm sevape, por bëhen shkak që fëmijëve t'u falen edhe mëkatet, sepse, krahas besimit dhe punëve të mira, duhet që edhe mëkatet të jenë të falura, në mënyrë që njeriu të hyjë në xhenet. I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, me këto fjalë të tij, shpreh se sa e rëndësishme është te Allahu sjellja e mirë ndaj prindërve, kur arrijnë pleqërinë:

"Allahu e poshtëroftë! Allahu e poshtëroftë! Allahu e poshtëroftë!" Sahabët e pyetën:

"Kë poshtëroftë Allahu, o i Dërguari i Allahut?" Ai (s.a.s.), u përgjigj:

"Atë që nuk mund të hyjë në xhenet, për shkak të prindërve apo ndonjërit prej tyre, kur i zë pleqëria pranë tij."³

Çështja që duhet të kemi më shumë kujdes në përgjithësi, është fakti se ne nuk duhet t'ua thyejmë zemrën prindërve në kohën e pleqërisë, kur ata kanë më shumë nevojë për interesim dhe përkujdesje. Ky është urdhër nga Allahu dhe borxh i besnikërisë. Madje, atyre duhet t'u afrohem me një zemër të mbushur plot dashuri e mëshirë, duhet t'i gëzojmë dhe të kërkohet shëndet për ta, kur të shikojmë gjendjen e tyre të dobët e të pafuqishme. Kjo është një detyrë që duhet ta bëjë çdo fëmijë.

Njeriu kalon nëpër procese të ndryshme, nga lindja deri në vdekje dhe fiton përvoja të shumta. Shprehja, "sikur të dinin të rinjtë dhe sikur të bënin të moshuarit", nxjerr në pah të vërtetën se të dy brezat kanë shumë gjëra për të marrë nga njëri-tjetri. Përfitimi i njeriut të ri nga përvojat e të moshuarve, që i kanë ngjitur shkallët e jetës më parë se ai, konsiderohet si sjellja më e mençur.

Në strukturën e familjes sonë, e cila ndërtohet mbi baza të forta, marrëdhëniet me të afërmit janë të mira. Kjo i mundëson individët të sillen ndaj njëri-tjetrit me një mirëkuptim

dhe koncept më të lartë se detyrimet që kanë në familje. Kur kjo përjetohet si një vlerë shoqërore dhe transmetohet te brezat e rinj si një kod i kulturës, struktura e familjes sonë do ta ruajë më lehtë ngrohtësinë e saj.

Por sot jemi ballë për ballë me shumë faktorë negativë, që e kërcënojnë strukturën e familjes sonë. Devijimi moral, pasioni për rehatinë, kriza e identitetit, "uni" që ka zënë vendin e "ne"-së, për shkak se nuk kuptohet drejt dimensionin terminologjik i shprehjeve liri e pavarësi dhe struktura, e cila po zvogëlohet me kalimin e kohës, janë prej faktorëve që duhet të shtjellohen me rëndësi.

Mënyra e sjelljes dhe gjendja shpirtërore, e cila duhet të arrihet sipas përkufizimeve në ajetet e hadithet e mësipërme, janë domosdoshmëri e besimit dhe moralit islam. Siç duhet që njeriu ta adhurojë Allahun pa ndonjë kusht në çdo lloj situatë, po ashtu duhet të sillen mirë edhe ndaj prindërve.

NJERIU RRITET NË VATRËN FAMILJARE

Kur e shtjellojmë çështjen nga aspekti i fëmijëve, nuk mund të neglizhohet e vërteta se familjet më të gjera që jetojnë bashkë me të moshuarit, i kanë më të zhvilluara aftësitë fizike e shpirtërore dhe në këtë mënyrë, kanë fituar më shumë aftësi pozitive. Kjo ndodh për shkak të ndikimeve pozitive që transmetohen nga brezi në brez, në kulturën dhe civilizimin tonë. Sepse fëmijët i fitojnë në mjediset familjare përvojat e para sociale.

Në këtë periudhë, kur sjelljet janë më ndikuese se fjalët, vihet re se fëmija formon marrëdhënie më të mira me njerëz, ndërmjet të cilëve ka dashuri dhe bëhet më i bindshëm. Me ndihmën pozitive që të moshuarit japin në edukimin sensual të fëmijëve, forcohen më shumë lidhjet familjare. Këtë e theksojnë shumë specialistët e kësaj fushe.

Kur të moshuarit jetojnë në familje, respektohen, duhen dhe trajtohen mirë, fëmija për herë të parë shikon në mjedis familjar respektin ndaj më të madhit dhe se çfarë është bindja me kufijtë e saj të caktuar saktë. Kur të mendojmë se edukimi realizohet me anë të trashëgimisë dhe veçanërisht me metodën e shembullimit, mund të themi se prindërit po përgatisin të ardhmen e tyre me sjelljet që shfaqin ndaj të mëdhenjve në familje. Sepse secili prej nesh, mbart shumë gjëra prej atyre që na japin ata.

Kur fëmijët shijojnë dashurinë e gjyshërve dhe kur gjyshërit shijojnë dashurinë e nipërve, i bën këta të fundit të kapen më fuqishëm ndaj jetës. Kjo lidhje nuk duhet të zbehet, me pretekstin se "nuk kam kohë". Gjallërimi i gëzimit për jetën te të moshuarit dhe prindërit, të cilët i mbajnë sytë në rrugë duke pritur fëmijët dhe nipërit ditëve të festave, është një prej përgjegjësive që asnjë prej nesh nuk duhet ta neglizhojë.

3. Muslim, Birr, 9, IV, 1978.

KUJDESI NDAJ PRINDËRVE ËSHTË NJË DETYRË FETARE

Përgjegjësia që fëmijët kanë kundrejt prindërve, nuk është vetëm një përgjegjësi materiale. Për këtë arsye, në fenë islame nuk lejohet që fëmija, i cili e ka gjendjen e mirë, t'ua japë zekat prindërve të tij të varfër. Sepse, kur prindërit kanë nevojë, së pari fëmijët janë të obliguar t'ua plotësojnë. Zekati është thjesht një përgjegjësi financiare. Ndërsa përgjegjësia e plotësimi të çdo lloj nevoje të tyre materialo-shpirtërore, është më përfshirëse.

Të besosh dhe të bësh vepra të mira, është detyra e çdo njeriu. Edhe njëra prej punëve më të bukura në fenë islame, përsëri është sjellja e mirë ndaj prindërve. Respekti ndaj të moshuarve është vendosur si një rregull etik. Po ashtu, kërkohet të merren masat e nevojshme për t'ua mundësuar atyre që ta vazhdojnë jetën pa e shpëputur dialogun me njerëzit dhe pa i lënë në vetmi. Në lidhje me këtë çështje, i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, ka thënë:

Transmeton sahabiu Abdullah ibn Mes'udi, radijallahu anh: E pyeta të Dërguarin e Allahut (s.a.s.):

"Cila punë është më e virtutshme?" I Dërguari i Allahut (s.a.s.), më tha:

"*Namazi që falet në kohën e tij.*" Unë e pyeta:

"Po pas namazit, cila është?" Ai (s.a.s.), më tha:

"*Mirësia ndaj prindërve.*"⁴

Problemet si vuajtja, pikëllimi dhe sëmundja, që bëhen shkak për faljen e mëkateve të zotëruesit të tyre, janë një pjesë e sprovës, përballë së cilës gjendet njeriu. Durimi që shfaq fëmija ndaj vështirësive që sjell pleqëria, në të njëjtën kohë duhet të konsiderohet dhe vlerësohet si një mundësi për t'ua afruar te Allahu. Prindërit në të njëjtën kohë, janë amaneti i Allahut.

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, njofton se atyre që i respektojnë prindërit dhe sillen me mirësi ndaj tyre, u pranohen lutjet kur përballen me probleme dhe halle të mëdha. Në një hadith fisnik, i cili transmetohet në sahihun e Buhariut, thuhet se tre djem të rinj, kishin hyrë në një shpellë. Në ato momente, bie një shkëmb i madh dhe e mbyll daljen e shpellës. Djemtë e ri nuk kishin rrugëzgjidhje. Kështu që u lutën, duke përmendur mirësitë që kishin bërë. Në këtë mënyrë, u hap dalja e shpellës.

Njëri prej këtyre të rinjve, iu lut dhe iu përgjërua Zotit, duke përmendur njërën prej sjelljeve që shfaqnin respektin dhe nderimin e tij ndaj prindërve.⁵

Asnjëherë nuk duhet t'i neglizhojmë detyrat dhe përgjegjësitë që kemi kundrejt prindërve, duke parë disa qëndrime dhe sjellje të gabuara të disa prindërve tanë në jetën sociale,

4. Muslim, Iman, 137, I, 90.

5. Buhari, Edeb, 5, VII, 69.

sepse disa gabime që bëhen për shkak të padijenisë apo prej problemeve psikologjike e ekonomike, nuk janë sjellje që duhet të merren për shembull, por janë gjendje të veçanta që duhet të rregullohen. Prindërit duhen ndihmuar edhe në këtë aspekt. Veçanërisht, këtu duhet të shprehim se rregullimi i këtyre sjelljeve të gabuara, duhet të realizohet jo vetëm me një përgjegjësi individuale, por me një impenjim shoqëror.

Në shumë ajete dhe hadithe flitet me këmbëngulje për sjelljen e mirë ndaj prindërve. Nëse ata kërkojnë diçka që të shpie në gjynah, përsëri theksohet se duhet të sillësh mirë ndaj tyre, megjithëse nuk ua plotëson atë dëshirë që kërkuan. Allahu i madhëruar thotë në Kuranin fisnik:

"Ne e kemi urdhëruar njeriun që t'i nderojë prindërit e tij. Nëna e ka mbartur atë, duke duruar mundim pas mundimi. Ndarja e tij (nga gjiri) është brenda dy vitesh. Ne i thamë atij: "Bëhu falënderues ndaj Meje dhe prindërve të tu! Tek Unë do të ktheheni të gjithë". Nëse ata orvaten, që të më shoqërosh Mua (në adhurim) diçka, për të cilën ti nuk ke dijeni, mos i dëgjo, por sillu mirë me ta në këtë jetë dhe ndiq rrugën e atij që drejtohet tek Unë me devotshmëri; pastaj, tek Unë do të ktheheni dhe Unë do t'ju lajmëroj për atë që keni bërë."
(Lukman 31/14-15.)

Edhe njëra prej të drejtave që kanë prindërit ndaj fëmijëve, është plotësimi i nevojave materiale të tyre.

PRINDËRIT E MERITOJNË RESPEKTIN, EDHE NËSE NUK JANË MYSLIMANË

Bisedat ndërmjet Hz. Ibrahimit (a.s.) dhe babait të tij mohues, Azerit' që tregohen në ajetet 41-48 të sures Merjem, janë një shembull i shkëlqyer që tregon se si duhet të sillen një fëmijë në gjendje të tilla. Hz. Ibrahim (a.s.), çdo bisedë e fillonte me fjalën "babai im", që ta bënte atë të hiqte dorë nga adhurimi i idhujve dhe për ta ftuar në besim. Po ashtu, e përfundonte bisedën duke i dhënë selam dhe duke u lutur për të. Kjo është shumë tërheqëse për të treguar madhështinë e moralit islam. Allahu Teala, thotë:

"Trego në Libër për Ibrahimin! Ai ishte njeri i së vërtetës dhe profet. Ai i tha të atit: "O babai im, përse adhuron atë që, as nuk dëgjon, as nuk sheh e as që mund të të sjellë ndonjë dobi?"

O babai im, mua më ka ardhur prej diturisë, çfarë s'të ka ardhur ty; andaj ndiqmë mua dhe unë do të të udhëzoj në rrugën e drejtë!

O babai im, mos adhuro djallin, sepse ai është gjithmonë i pabindur ndaj të Gjithëmëshirshmit.

O babai im, unë kam frikë se mos të vjen ndonjë dënim nga i Gjithëmëshirshmi e bëhesh kështu i afërm i djallit!"

Problemet si vuajtja, pikëllimi dhe sëmundja, që bëhen shkak për faljen e mëkateve të zotëruesit të tyre, janë një pjesë e sprovës, përballë së cilës gjendet njeriu.

Ai u përgjigj: "O Ibrahim! Si guxon t'i hedhësh poshtë zotat e mi?! Nëse nuk heq dorë, unë do të të mbys me gurë; andaj, largohu prej meje për një kohë të gjatë!"

Ibrahimi tha: "Shpëtimi qoftë mbi ty! Do t'i lutem Zotit tim që të të falë. Me të vërtetë, Ai është i mirë me mua. Po largohem nga ju dhe nga gjithçka që ju adhuron në vend të Allahut. Do t'i lutem Zotin tim, sepse jam i sigurt se nuk do të jem fatkeq me lutjet që ia bëj Atij."

PRINDËRIT KANË NEVOJË PËR DASHURI

Respekti ndaj të mëdhenjve dhe dashuria ndaj të vegjëlve ndërmjet pjesëtarëve të familjes dhe të afërmve me në krye prindërit dhe fëmijët, është detyrë morale e çdo myslimani. Në të vërtetë, respekti dhe dashuria, janë dy faktorë që e plotësojnë njëri-tjetrin. Njeriu që do, duhet ta shprehë, sepse nuk ka dashuri pa u shprehur. Dashuria nuk formohet pa prekur, pa dëgjuar dhe pa ndarë, sepse dashuria ka nevojë për komunikim.

Dashuria shtohet duke komunikuar dhe ndarë me të tjerët. Përgjithësisht, fjalët e të mëdhenjve që thonë për të vegjëlit, "e dua, por nuk e shfaq", "nëse e shfaq, llastohet", janë një shenjë mangësie në këtë drejtim. I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, në hadithe të ndryshme të tij, ka theksuar se dashuria duhet të shfaqet, qoftë me një përhëndetje apo me një buzëqeshje kur njerëzit të takohen me njëri-tjetrin.

Transmetohet se një ditë, kur i erdhën nëna e qumështit, babai i qumështit dhe vëllai i qumështit, i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, për t'i respektuar ata, u ngrit në këmbë, e shtriu rrobën e tij në tokë dhe në një cep të saj uli babain e qumështit, në një cep tjetër nënën e qumështit dhe ndërmjet tyre vëllain e qumështit.⁶

Respekti duhet të tregohet me dashuri, ashtu siç ka vepëruar i Dërguari i Allahut (s.a.s.), në të gjitha sjelljet e tij. Një respekt pa dashuri, është shprehje e ndonjë frike ose shprehje e hipokrizisë. Të imponosh njerëzit që të bëjnë diçka, të cilën nuk e duan, duke i kërcënuar dhe shfaqur hipokrizi, janë sjellje të ndaluara në fenë tonë.

Përsëri transmetohet se, kur i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, shkante te vajza e tij, Hz. Fatimeja, Hz. Fatimeja ngrihej në këmbë, e puthte Hz. Pejgamberin dhe ulej pranë tij. Kur Hz. Fatimeja shkante te i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, Hz. Pejgamberi ngrihej në këmbë, e puthte dhe e ulte pranë tij.⁷

I Dërguari i Allahut (s.a.s.), në lidhje me çështjen e respektit ndaj të mëdhenjve dhe trajtimit me mëshirë të të vegjëlve, ka thënë:

6. Ebu Davud, Edeb, 129. Nr: 5145, V, 354.

7. Ebu Davud, 5217, V, 391.

*"Nuk është prej nesh ai që nuk i mëshiron të vegjëlit dhe që nuk i respekton të drejtat e të mëdhenjve."*⁸

Dashuria dhe respekti shtohen dhe përhapen, aq sa mund të shprehen. Edhe njëra prej sjelljeve që i gëzon prindërit dhe i kënaq ata, është respekti dhe nderimi që shfaq fëmija ndaj miqve të tyre të dashur. Transmetohet se i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, ka thënë: *"Mirësia më e mirë, është mirësia e vazhdueshme që njeriu bën kundrejt mikut të sinqertë të babait të tij."*⁹

Vizita dhe nderimi i miqve e i shokëve të prindërve, janë të vlefshëm aq sa dashuria dhe respekti ndaj prindërve. I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, e shtjellon kështu këtë çështje në një hadith të tij:

*"Mirësia më e virtytshme, është vizita që fëmija u bën miqve të babait."*¹⁰

PËRFUNDIM

Siç e pamë edhe më sipër, feja islame urdhëron sjellje të mirë ndaj familjes dhe ndaj prindërve që e formojnë atë, plotësimin e nevojave të prindërve, plotësimin e dëshirave të tyre brenda masave të lejuara, lumturimin e tyre dhe lutjen për ta, duke shtrirë ndaj tyre krahët e mëshirës. Po ashtu, e ndalon kategorikisht ndërprerjen e marrëdhënieve me ta, të folurit me ashpërsi, thyerjen e zemrës së tyre, fjalët dhe sjelljet e çdo lloji forme, që shfaqin mosbindje ndaj tyre.

Në të njëjtën mënyrë, respektin ndaj të mëdhenjve dhe mëshirën ndaj të vegjëlve brenda familjes dhe ndërmjet të afërmve, i konsideron si përgjegjësi etike.

Prindërit dhe të moshuarit tanë, më shumë se kurrë kanë nevojë sot për dashuri, interesim dhe afrimet në këtë jetë, të cilën po e jetojmë sikur kemi humbur në mekanikën e marrëdhënieve ndërnjerëzore në këtë shoqëri moderne. Nëse i bëjmë ata që ta ndajnë dashurinë tonë, ajo i rrethon ata shpirtërisht, i shpëton nga vetmia, u hyn në personalitet dhe u bëhet ushqim. Në këtë mënyrë, vatrat familjare bëhen vende ku merr frymë qetësia dhe japin shansin për të arritur mirësitë që nuk i kemi imagjinuar.

Aq sa ka nevojë toka për farë, fara për shi dhe shiu për re, po aq ka nevojë njeriu për prindërit. Kur në zemrat tona ta rrisim dashurinë ndaj tyre dhe këtë të fundit ta reflektojmë në fjalët dhe sjelljet tona, atëherë do t'i bëjmë të lumtur ata.

Nëse nënvlerësohet familja dhe individët që e formojnë atë, atëherë edhe shoqëria, detyrimisht do të shkatërrohet.

8. Tirmidhi, Birr, 15, IV, 1919.

9. Muslim, Birr, 12, IV, 1979.

10. Muslim, Birr, 11, IV, 1979.

PROBLEMI MË I VJETËR

Nureddin Jëlldëz

“Familja” u bë problemi i parë i njeriut para se të bëhej problem uria dhe strehimi. Nuk bëjmë gabim, nëse themi se shikimi i këtij problemi vetëm si grindje midis dy vëllezërve Habil/Kabil, reflekton një pikëpamje shterpë.

Ashtu siç shkruhet nga një gjynah për çdo vrasje që bëhet edhe në dosjen personale të Kabilit, edhe në lidhje me problemet familjare që jetojmë sot, nga pikëpamja e pikës së fillimit gjenden gjurmë të periudhës së njeriut të parë.

Nuk është e drejtë nëse vështirësitë me të cilat përballen dy të rinj që martohen ia atribuojmë vetëm mënyrës së jetesës që ka sjellë shekulli. Përderisa njeriu, kudo që të gjendet si njeri, gjendet i pashkëputur nga bota e tij e brendshme, është e natyrshe që, kur ai ndodhet në xhami duke kryer adhurimet, të mbruhet brenda problemeve që rrjedhin prej nefsit të tij dhe, kur ndodhet në shtëpi si mashkull apo femër, të mbruhet me problemet që mund të quhen “probleme familjare”. Si mund të pretendojmë që njeriu të ngelet edhe njeri, por edhe të bëhet si melek? Me gjithë problemet që i ngarkon fakti i të qenit njeri dhe me gjithë vlerat personale që i marrin atij ato probleme, këtu qëndron edhe e fshehta e gjendjes së njeriut në një pedestal ku ai mund të garojë me melekët.

Familja është epiqendra e problemeve më të vjetra dhe më rrënjësore. Por megjithatë, familja është edhe epiqendra e zgjidhjes së të gjitha problemeve themelore të njeriut.

Së pari, fillimi i jetës së njeriut në një themel pjellor dhe të begatë dhe vendi ku ai do të marrë edukimin për të fituar cilësinë e njeriut të mirë, është barku i nënës. Por edhe barku i nënës, është e pamundur të sigurohet jashtë familjes. Nga kjo pikëpamje, është kusht që para xhamisë, medresesë dhe sheshit të xhihadit, familja të shihet si qendra e parë dhe e vetme e edukimit. Ashtu siç femërizimi i atij që ka lindur mashkull i ngjan rrjedhjes së ujit në kah të kundërt, ashtu ngjan edhe ndryshimi i mëvonshëm i formimit fillestar të familjes. Edhe pse mund të bëhet fjalë për një shartim të mëvonshëm, esencjal është procesi i farës.

Ky fakt na çon në një përgjigje të qartë të pyetjes se përse familja është ajo, ndaj së cilës shejtani interesohet aq shumë dhe pika ku ai filloi luftën me njeriun. Shejtani, qëllimi i vetëm i të cilit është të çojë njeriun në humbjen e përjetshme, reali-

zimin e qëllimit të tij e ka filluar me familjen. Në këtë mënyrë, ai fillon prej rrënjëve. Pasi të kesh arritur të dëmtosh rrënjët, natyrisht që edhe degët do të bëhen më të lehta.

Nga një anë, ky fakt tregon qartë vendin që gëzon martesja dhe vlerat që e rrethojnë atë në sytë e një besimtarit. Martesa dhe vazhdimi i jetës familjare në përputhje me kënaqësinë e Allahut, vetëm me anë të kësaj logjike mund të konceptohet si “një ajet prej ajeteve të Allahut”. Madje, shfaqja e takimit të një të riu dhe një të reje në boshtin e plotësimit të kënaqësive trupore si “një ajet prej ajeteve të Allahut”, është një element shumë i mirë, përballë, urtësisë së të cilit duhet të qëndrojmë dhe të meditojmë.

Përmendja nga ana e Kuranit në mënyrë të hapur të “çështjeve private”, që për ne janë detaje, madje që nuk janë edhe aq të përshtatshme për t’u përmendur në tubime, kur është duke u folur në lidhje me koncepte të larta, si besimi, bota tjetër, adhurimi, dhikri apo xhihadi, p.sh., ndërsa është duke folur për agjërimin dhe Ramazanin, papritur futet në tema me “gra”, tregon se me çfarë serioziteti duhet ta shqyrtojmë familjen dhe çështjet që kanë të bëjnë me të.

Familja, përmban problemet më të vjetra dhe më gjithëpërfshirëse të njerëzimit. Gjithashtu, edhe zgjidhjet më të qarta dhe më të prera, ndodhen të fshehura në familje.

Sigurisht që për këtë arsye edhe konceptet si namusi, nikahu etj., të cilat përbëjnë vlerat që formojnë familjen, na janë kumtuar në mesin e gjërave të shenjta.

Për këtë arsye, nëse martesja nuk shihet si një lloj xhihadi, do të jetë e vështirë t’i japësh edhe hakun.

Mashkulli dhe femra që hedhin firmën në një kontratë martesore, duhet të jenë të vetëdijshëm se janë duke hedhur firmën për të zgjedhur një nga dy mundësitë shumë të vështira, siç janë mbajtja mbi supë e maleve me probleme që janë trashëguar që nga njeriu i parë ose shtypja prej tyre. Asnjë shekull dhe asnjë sistem nuk do të mund ta ndryshojë këtë formulë, sepse ky është kushti i të qenit njeri. Ky është çmimi i zgjedhjes së namusit dhe virtytit që më vonë do të shndërrohen në mirësitë e xhenetit.

Një nga problemet më të vjetra të njerëzimit, është problemi që një familje ka në gjirin e saj. Por familja është edhe ajo që të bën të fitosh xhenetin.



Udhëzimi i Kuranit për paqen familjare

Dr. Adem Ergyl

Allahu i Madhëruar, i cili e filloi historinë njerëzore me Ademin (a.s.), fill pas tij krijoi edhe shoqen e tij¹. Në këtë mënyrë, duke formuar jetën familjare dëshiroi që ata të gjenin paqen dhe qetësinë me miqësi, mëshirë dhe dashuri ndaj njëri-tjetrit.

Fjala “zeuxh / bashkëshorte” e cila përmendet në ajetet kuranore që flasin në lidhje me këtë temë, tregon një të vërtetë shumë të rëndësishme në shndërrimin e institucionit familjar në një vend paqeje dhe qetësie. Nga studimet që janë bërë në lidhje me këtë temë, kanë dalë këto përfundime:

“Nëse Kurani përmend fjalën “zeuxh”, kur bëhet fjalë për kompaktësinë e besimit, ndjenjave dhe vlerave midis bashkëshortëve, por në fakt kjo kompaktësi nuk është arritur, atëherë aty përdoret shprehja “gruaja e filanit”, që tregon se bëhet fjalë për një marrëdhënie martesore thjesht me fjalë. Në ajetet kuranore, në lidhje me bashkimin e Ademit (a.s.), me nënën tonë Hava² dhe marrëdhëniet familjare midis Rasulallahut (a.s.), dhe bashkëshortëve të tij³, përdoret fjala “zeuxh / bashkëshorte”. Ndërsa, kur përmenden gratë jobsimtare të Nuhut (a.s.) dhe Lutit (a.s.), përdoret fjala “grua”⁴. Kjo tregon se ata nuk kishin një familje, ku mbizotëronte paqja dhe qetësia. Gjithashtu edhe kur përmendet Faraoni me gruan e tij Asije, përdoret fjala “gruaja e Faraonit”⁵. Kjo, sepse Asija ishte jobsimtare, ndërsa Faraoni jobsimtar dhe për këtë arsye, familja e tyre nuk ishte kompakte në besim.”

Kjo hollësi, tregon se në paqen familjare, në radhë të parë vjen mendimi kompakt i të dyja palëve në besim dhe vlera.

1. Surja en-Nisa, 1.
2. Surja el-Bekare, 35.
3. Surja el-Ahzab, 6.
4. Surja et-Tahrim 10.
5. Surja el-Kasas, 9.

Prandaj, kushti themelor i paqes në një martesë, nuk është bukuria e trupave, por kompaktësia e vlerave dhe afërsia e shpirtave. Ky fakt shprehet më së miri edhe në këtë ajet fisnik:

“Mos u martoni me paganet, gjersa të bëhen besimtare. Skllavja besimtare është më e mirë se pagania, edhe nëse kjo e fundit mund t’ju pëlqejë. Mos i martoni myslimanet me paganë, gjersa ata të bëhen besimtarë. Skllavi besimtar është më i mirë se pagani, edhe nëse ky i fundit mund t’ju pëlqejë. Ata ju thërrasin në zjarr, kurse Allahu, me mirësinë e Tij, ju thërrret në Xhenet e falje (të gjynaheve). Ai ua shpjegon njerëzve shpalljet e Veta, që ata të mendojnë.” (el-Bekare, 221.)

Në rrugën e jetës, gëzimi dhe paqja familjare mund të arrihen vetëm me bashkim zemrash dhe karakter të mirë. Për këtë arsye dhe Profeti ynë (a.s.), në lidhje me zgjedhjen e bashkëshortes, ka tërhequr vëmendjen tek morali i bukur.

Këtë të fshehtë mund ta shohim edhe nga kjo pikëpamje. Të ndërtosh një folë të qetë familjare me dikë që nuk ka qetësi shpirtërore, është shumë e vështirë. Sipas Kuranit, shpirti i qetë, është shpirti që ka gjetur Allahun⁶. Ndërsa besimi, është shkalla e parë e kësaj gjetjeje dhe çdo ligj i islamit është një eliksir më vete i paqes dhe i qetësisë. Devotshmëria e jetuar me vetëdijen se je gjithmonë nën vëzhgimin e Allahut, është zhytje në detin e gjerë të paqes. Themeli i prishjes së qetësisë, është shpirtngushtësia. Ndërsa islami, është një nur, i cili zgjeron shpirtat.

Kurani Kerim shprehet se familja duhet të ruhet vazhdimisht nga ana e besimit dhe islamit, përndryshe jeta e përtjetshme do përfundojë me xhehenem⁷. Në veçanti, urdhëron

6. Surja er-Ra’d, 252.
7. Surja et-Tahrim, 6.

që të tregohemi të përpiktë në lidhje me faljen e namazit⁸, sepse namazi është një adhurim, i cili e ruan njeriun nga gjynahet dhe çdo veprim i pahijshëm⁹.

Dihet se gjynahet më të mëdha që e prishin qetësinë familjare, madje e shkatërrojnë atë, në të shumtën e rasteve bëhen si rezultat i mosfrenimit të epsheve. Për shkak se prish zemrat dhe cenon besnikërinë, Kurani Kerim e ka ndaluar shikimin e haramit. Kthimi i syve dhe i zemrave të bashkëshortëve nga njëri-tjetri dhe jo përreth, është e mundur vetëm me dëshirimin e të lejuashmes dhe zbatimin e të drejtave të njëri-tjetrit në mënyrën më të bukur. Kurani Kerim, i ka këshilluar shumë besimtarët edhe në këto çështje. Madje, mund të thuhet se ligjet më të detajuara në Kuran, janë ato që kanë të bëjnë me familjen.

Çdo njeri që nuk e ka gjetur shokun e shpirtit, është edhe i trazuar shpirtërisht, edhe i mbetur përgjysmë. Është i trazuar shpirtërisht, sepse, siç shprehet edhe Mevlana: "Nëse njëra prej këpucëve të shtrëngon, edhe tjetra nuk të hyn në punë". Është i mbetur përgjysmë, sepse bashkëshortët janë dy pjesë të veçanta që plotësojnë njëra-tjetrën. Mungesa e njërit, e lë përgjysmë edhe tjetrin. Ky është edhe shkak që një nga dëshirat e veçanta të robërve të mirë të Rrahmanit, ndaj Zotit të tyre, është që të kenë "bashkëshort/e dhe fëmijë, që do të bëhen drita e syrit dhe lumturia e shpirtit të tyre."¹⁰

Të bëhesh bashkëshort/e që e plotëson bashkëshortin e vet, duhet të jetë qëllimi kryesor i çdo bashkëshorti. Ndërsa kjo është e mundur, vetëm nëse çdo njëri prej bashkëshortëve luan me përpikëri rolin e tij. Nëse gruaja merr mbi supe rolin e burrit ose burri bën punët e gruas, paqja dhe qetësia e familjes nuk do të jetë e mundur, sepse çdo gjininie i janë dhënë aftësi të veçanta. Pikërisht në lidhje me këtë çështje, transmetohet një hadith i Profetit tonë (a.s.):

Një ditë, Ummu Seleme (r.anha.), i thotë Rasulallahut (a.s.): "O i Dërguar i Allahut! Burrat luftojnë, ne nuk mund të luftojmë dhe në trashëgimi marrim sa gjysma e tyre". Ajo i kërkon një shpjegim për këtë dhe veçanërisht për faktin se, përse hixhreti i grave nuk përmendet në Kuran. Gjithashtu, ajo e pyet edhe për faktin se përse për të dëshmuar duhen dy gra, në vend të një burri dhe se a do të marrin gratë shpërblim për punët e tyre njësoj si burrat. (Tirmidhi, Tefsir 4/8-9.) Në lidhje me këto pyetje, u zbrit ky ajet fisnik:

"Mos i lakmoni ato gjëra, me anë të të cilave Allahu i ka bërë disa nga ju të dallohen mbi të tjerët: meshkujt do të kenë pjesë prej asaj që kanë punuar e po ashtu edhe femrat do të kenë pjesë prej asaj që kanë punuar. Kërkoni prej Allahut nga mirësitë e Tij. Vërtet, Allahu është i Dijshtëm për çdo gjë." (en-Nisa, 32.)

8. Surja Ta-Ha, 132.

9. Surja el-Ankebut, 45.

10. Surja, el-Furkan, 74.

Ashtu si në çdo udhëtim, edhe në këtë udhëtim të jetës që fillon me martesën, gjithmonë është e mundur të përjetojnë gjëra të papëlqyeshme. Në këto raste, këshilla e parë e Kuranit, është që çështjen ta shohësh nga një pikëpamje pozitive:

"...Jetoni e silluni mirë me to (gratë)! Në qoftë se ato nuk ju pëlqejnë aq shumë, (duronit!) sepse është e mundur që juve të mos ju pëlqejë diçka, por që Allahu në atë do t'ju sjellë shumë të mira." (e-Nisa, 19.)

Ndonjëherë, në familje mund të ndodhin edhe ngjarje të papëlqyeshme, të cilat mund të shkojnë edhe deri në armiqësi ndërmjet bashkëshortëve. Në këto raste është këshilluar të tregohemi të matur dhe të jemi falës e tolerantë:

"O besimtarë! Në të vërtetë, ju keni armiq në radhët e grave tuaja dhe të fëmijëve tuaj, andaj ruajuni prej tyre! Por, nëse nuk i vini re fyerjet e tyre dhe ua falni, ta dini se Allahu është vërtet Falës dhe Mëshirëplotë." (et-Tegabun, 14.)

Por në rast se shtohen prishja e qetësisë dhe dobësitë morale, propozohen mënyra të tjera kurimi. Pikësëpari, këshillohet me butësi, pastaj ndahen shtretërit dhe më në fund rrihet lehtë.¹¹

Për të shpëtuar familjen dhe si zgjidhje e fundit, kërkohet ndërhyrja e dy personave dashamirës prej të afërmeve të bashkëshortëve, me qëllim pajtimi¹². Të gjitha këto mënyra, në Kuranin Kerim tregohen pjesë-pjesë dhe kjo tregon qartë rëndësinë që i ka dhënë Allahu institucionit të martesës.

Fëmijët, që janë edhe frytet e pemës familjare, njëkohësisht janë edhe elemente që plotësojnë lumturinë familjare. Në përgjithësi, prej atmosferës paqësore familjare, që formojnë bashkëshortët, rriten breza të shëndoshë. Ndërsa, në foletë familjare ku mungon dashamirësia dhe dashuria, është e vështirë të rriten fëmijë që do të bëhen drita e syrit.

Padyshim se edukimi i fëmijëve të mirë dhe jo plangprishës, varet nga marrëdhëniet e mira familjare. Nëse prindërit hapin krahët e mëshirës dhe dashurisë ndaj fëmijëve të tyre, edhe të vegjlit do të tregojnë mirësjellje dhe respekt ndaj më të moshuarve dhe kjo do ta kthejë familjen në një bahçe xheneti.


Si përfundim, duam të theksojmë edhe faktin se ndërtimi i një foleje të qetë familjare, në fillim, në vazhdim dhe madje, që të vazhdojë deri në xhenet, gjithmonë ka nevojë për ndihmën dhe mëshirën hyjnore. Për të arritur këtë, kërkohet që bashkëshortët dhe fëmijët të bëjnë një jetë të mbushur me lutje dhe adhurime. Kjo është një nga recetat udhëzuese që na ka treguar Kurani Kerim, për të arritur paqen dhe qetësinë familjare.

11. Surja en-Nisa, 34.

12. Surja en-Nisa, 35.

Leximi i ajetit Kursij

Xhafer Durmush



Ajeti 255, i sures el-Bekare, madhështinë e së cilës e ka vërtetuar edhe Profeti ynë (a.s.), është shprehja më e përmbledhur që tregon Madhështinë e Allahut Teala. Ajetu'l-Kursij...

"Allahu! Nuk ka zot tjetër (që meriton adhurimin), përveç Tij, të Gjallit, të Përjetshmit, Mbajtësit të gjithçkaje! Atë nuk e kaplon as dremitja, as gjumi! Atij i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në Tokë. Kush mund të ndërhyjë tek Ai për ndokënd, pa lejen e Tij? Ai di çdo gjë që ka ndodhur përpara dhe çdo gjë që do të ndodhë pas njerëzve, kurse ata nuk mund të përvetësojnë asgjë nga Dituria e Tij, përveçse aq sa Ai dëshiron. Kursi-u 43 i Tij, shtrihet mbi qiejt dhe Tokën dhe Ai nuk e ka të rëndë t'i ruajë ato. Ai është i Larti, Madhështori!" (el-Bekare, 255.)

Në Ajetu'l-Kursij, i cili përbëhet nga dhjetë fjali, deklarohet në mënyrë të përmbledhur besimi i teuhidit¹, duke na bërë të ditur njësinë e Allahut, gjallërinë dhe përjetësinë e Tij, të qenit larg prej dobësive njerëzore, si gjumi apo hutimi, menaxhimin e gjithësisë nga ana e Tij, domosdoshmërinë e lejes së Tij për të ndërhyrë tek Ai, dijen e Tij, që përfshin gjithçka, pa fillim dhe pa fund, shtrirjen e fuqisë së Tij, që përfshin gjithçka, në qiej e në tokë dhe Madhështinë e Tij.

1. Besimi në një Zot të vetëm.

Kuptimi i fjalës **"kursij"**, e cila përmendet në ajet, nuk është "froni" që njohim ne, por është diçka që i shkon për shtat vetëm Madhështisë së Allahut Teala dhe përbërjen e tij nuk e di tjetërkush, përveç Tij.

Hajj: Në fjalor shpjegohet me fjalën i gjallë. Kjo është një nga cilësitë e larta të Allahut dhe do të thotë se qenia e Tij është e vazhdueshme dhe e pandërprerë, pa fillim dhe pa fund.

Kajjum: Do të thotë se Allahu është Ai që i menaxhon dhe u kërkon llogari të gjitha krijesave.

Sine: Do të thotë dremitje. Në këtë ajet, pjesa mohore "la", që gjendet midis fjalëve "sine" dhe "neum", të cilat përkthehen: "Atë nuk e kaplon as dremitja, as gjumi!", i përfshin të dyja këto fjalë.

Pra, në çështjen e menaxhimit dhe kontrollit të gjithçkaje që ekziston, nuk mund të flitet për gabim, shkujdesje, mërzitje dhe ngathtësi të Allahut Teala. Këto dobësi, që u takojnë vetëm krijesave, nuk mund t'i atribuohen Atij, sepse Ai është cilësuar me veti të përsosura dhe është i pastër nga çdo të metë.

Aliu (r.a.), na tregon një kujtim të tij, në lidhje me përdorimin e emrave të Allahut "hajj dhe kajjum", në lutje:

"Në ditën e luftës së Bedrit, po shihja se çfarë do të bënte i Dërguari i Allahut (a.s.). Papritur, ai u ul në sexhede dhe filloi të thoshte "Ja hajju, ja Kajjum!". Iu afrova

dhe iu largova disa herë, por ai vazhdonte të thoshte të njëjtat gjëra. Ai vazhdoi t'i thoshte këto fjalë, derisa arriti fitorja."

Në veprën Ruhul Bejan, na jepen shembuj se, ashtu siç kërkoi Rasulallahu (a.s.), ndihmë prej Allahut, me emrat e Tij "Ja haju, ja Kajjum!", është e mundur që, nëse lutesh me sinqeritet të plotë, duke përdorur ndonjë emër apo cilësi të Allahut, ndihma hyjnore do të vijë patjetër.

Në lidhje me mirësitë e Ajetul Kursij, në hadithe të ndryshme, Profeti ynë (a.s.), ka thënë: "Ajetul Kursij është ajeti më madhështor i Kuranit Kerim². Ai që lexon Ajetul Kursij para se të flerë, Allahu do ta ruajë dhe nuk do ta lejojë shejtanin t'i afrohet atij³. Në këtë ajet gjendet emri më madhështor i Allahut⁴ dhe Ajetul Kursij, është zotëria i të gjithë ajeteve të Kuranit Kerim⁵."

Në një hadith tjetër, Profeti (a.s.), thotë: "Atij që e lexon Ajetul Kursij, Allahu i dërgon një melek, i cili shkruan veprën e tij të mirë. Shejtani e braktis për tridhjetë ditë shtëpinë ku lexohet Ajetul Kursij. Në atë shtëpi, për dyzet ditë nuk mund të hyjë as magjia dhe as magjistari". Gjithashtu, Profeti (a.s.), i ka kërkuar Aliut (r.a.), që këto t'ua mësojë fëmijëve, familjes dhe komshinjve të vet.

Në vendin tonë është bërë zakon që tesbihët, që bëhen pas namazeve farz, të fillojnë me Ajetul Kursij. Ky zakon është shumë i rëndësishëm për nga ana e zbatimit në bashkësi të një këshille profetike, e cila është nxjerrë nga këshillat që i ka dhënë Profeti (a.s.), Aliut (r.a.).

Gjithashtu, zakoni i leximit të Ajetul Kursij pas namazeve, na ndihmon që në çdo hap të jetës, të mbajmë gjallë vetëdijen që, para se t'i mbështetemi apo t'i besojmë ndonjë të vdekshmi si puna jonë, të mendojmë se ndodhemi nën vëzhgimin e Allahut Teala, ta kujtojmë Atë, t'i besojmë Atij, të presim ndihmë prej Tij, të strehohemi tek Ai dhe, sido që të jetë puna, të mundohemi të fitojmë kënaqësinë e Tij.

Zbatimi me korrektësi i këtij zakoni, duke qenë të vetëdijshëm se Allahu Teala vëzhgon çdo gjendje to-

nën, është edhe fillimi i çdo pune të mirë, por edhe pengesë ndaj çdo veprë të keqe. Dhe për ta përvetësuar sa më mirë, kemi nevojë ta lexojmë duke menduar edhe kuptimin e tij.

DREDHITË E IBLISIT

Zoti ynë, që është Erhamu'r-Rahimin, në suren el-Bekare, pasi thotë: "**Mos ndiqni gjurmët e shejtanit, sepse ai është armiku juaj i hapët**", na paralajmëron se "**Ai ju nxit vetëm në të këqija, në vepra të turpshme dhe të flisni për Allahun gjëra që nuk i dini.**"⁶

Në këtë ajet, ajo që kërkohet të thuhet me "nxitjet dhe vesveset e shejtanit", është shtyrja e fshehtë në vepra të këqija, që i bën ai nefsit të njeriut. Gjërat për të cilat shejtani e nxit njeriun, i kemi përmbledhur në gjashtë pika:

Pikësëpari, shejtani e fton njeriun për në kufur (mohim), për në shirk (t'i bëjë shok Allahut) dhe në armiqësi ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.). Nëse nuk arrin të ketë sukses në këto, e thërret njeriun në bid'atet më të dashura për të, prej të këqijave dhe gjynaheve. Pastaj, e thërret në gjynahet e mëdha. Por nëse nuk ka sukses edhe në këtë, e thërret në gjynahet e vogla. Profeti ynë (a.s.), ka thënë: "**Po ju paralajmëroj nga moskëçarja ndaj gjynaheve.**"

Nëse nuk arrin të ketë sukses në asnjë prej dredhive që përmendëm më sipër, nxit në bërjen e gjërave, që janë mu-bah (prej të cilave nuk merr as sevap dhe as gjynah), duke të privuar prej sevapeve. Por, nëse nuk arrin të ketë sukses as në këtë dredhi, nxit në punët që kanë më pak shpërblime, me qëllim që të pengojë punët më të virtytshme.

Sipas asaj që thuhet në Ruhul Bejan, "Allahu Teala e ka krijuar shejtanin për t'i ndarë njerëzit e mirë nga njerëzi e këqij. Ndërsa shejtani, pasi u merr peng organet, u jep të shijojnë diçka. Pas kësaj, gjymtyrët, nuk dëgjojnë as këshillat, kur u thonë se kjo botë është e pavlefshme dhe as nuk i vënë veshin e as nuk shohin të këqijat e saj."

Për të mos u mashtruar nga kurthet e tij tinëzare, duhet të njohim dredhitë e iblisit dhe të jemi gjithmonë të përgatitur.

2. Muslim, Musafirin, 258.

3. Buhari, Vekalet, 10.

4. Musned, VI, 461.

5. Tirmidhi, Fedailu'l-Kur'an, 2.

6. El-Bekare, 169.





BEXHISTENI
SHKODËR, MARUBI 1915

FOTOJA E MUJAJIT



Një Ajet

*Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshirplotit!*

“Ky (Kuran) është një libër i bekuar, që Ne ta kemi zbritur ty (Muhamed), për të përsijatur mbi vargjet e tij dhe për t’u këshilluar me të mendarët.” (Sad, 29)

Qëllimi kryesor i Kuranit është t’i sigurojë njeriut jetë të lumtur në këtë botë dhe në botën tjetër, duke e udhëzuar të veprjë brenda direktivave hyjnore.

Për të realizuar këtë qëllim, pra lumturinë e njeriut në të dyja botët, njeriu duhet të përvetësojë një mënyrë jetese në përputhje me parimet e Kuranit. Edhe pse herë pas here njeriu mund të bjerë në gabime, qëllimi kryesor dhe filozofia e jetës së tij duhet të jetë kënaqësia e Allahut.

Njeriu duhet të jetë në kontakt me Kuranin në çdo moment, për të kryer më sukses detyrimet që ka karshi Krijuesit, por edhe detyrimet që ka kundrejt shoqërisë. Sepse vetëm duke qenë në kontakt me Kuranin, mund të edukohet me frymën e tij. Edukimi i njeriut përmes Kuranit, është një process, që vazhdon gjithë jetën. Është e qartë se një zemër dhe një mendje, që ndërpret marrëdhëniet me Kuranin do të jetë e hapur ndaj çdo lloj tundimi. Është evident fakti se në shoqëritë që qëndrojnë larg boshtit të mësimëve Kuranore, tradita dhe zakonet fillojnë të pranohen si pjesë e fesë.

Nëse njerëzit, në përpjekje për të kuptuar Kuranin, nuk kanë një qasje të shëndoshë, fillojnë të formojnë marrëdhënie të ndryshme me Kuranin. Këto janë marrëdhënie që nuk kanë asnjë lidhje me qëllimin e zbritjes së Kuranit. Si shembull të këtyre marrëdhënive të gabuara që kanë krijuar njerëzit me Kuranin, mund të përmendim nuskat që përmbajnë ajete Kuranore, mbajtja e Kuranit në makinë për t’u mbrojtur nga fatkeqësitë. Me keqardhje vëmë re se përpjekjet e Myslimanëve për të kuptuar Kuranin, janë minimale. Nuk ka dyshim që leximi i Kuranit pa e kuptuar, shpërblehet tek Allahut, por qëllimi kryesor i Kuranit është të jetohet sipas udhëzimeve të tij. Të lexohet Kurani pa u kuptuar sot, në kohën kur literatura është e bollshme, nuk është një sjellje që mund të justifikohet lehtë. Kurani së pari i drejtohet arsyes, mendjes. Është nga synimet e kryesore të Kuranit vënia në lëvizje e arsyes së njeriut.

Kurani në shumë vende thekson rëndësinë që ka kuptimi si duhet i mesazhit kuranor, prandaj duhet të bëjmë përpjekje për ta kuptuar dhe jetuar Kuranin. Të mos qëndrojmë pasivë ndaj fjalës së Allahut. Marrëdhënien me Kuranin duhet ta shpëtojmë nga formaliteti, duke e ngritur në dimensionet e dijes, siç ka qenë në kohën e Pejgamberit (a.s) dhe shokëve të tij. Ajetet që nuk janë të qëndisur në mendje dhe në zemër, nuk mund të na ndriçojnë jetën tonë. Duhet patjetër që të mbruhemi me moralin e Kuranit.

Një Hadith

*Transmetohet nga Ebu Hurejra (r.a.)
se Resulullahi (s.a.v.s.) i ka thënë:*



“...Fjala e mirë është sadaka...”

Ndër organet shqisore, organi më kompleks është gjuha. Ndërsa organet e tjera, si syri, veshi, dora kanë një perceptim të anës së jashtme të sendëve ose të dukurive, që vjen si pasoje e veprimit të drejtpërdrejtë mbi këto sende ose dukuri, gjuha është shprehës e kumtues i mendimeve e i ndjenjave të njeriut. Ajo luan rolin e përkthyesit të mendimeve dhe besimeve tona. Pejgamberi (a.s.), duke treguar për rëndësinë e gjuhës mbi organet e tjera, thotë: “Kur zgjohet njeriu, të gjitha gjymtyrët e tij i drejtohen gjuhës, duke i thënë: “Ki frikën Allahut edhe për ne, sepse ne jemi të varura prej teje. Nëse ti je në rrugë të drejtë, edhe ne jemi në rrugë të drejtë e, nëse ti lajthit, edhe ne kemi lajthitur.” (Tirmidhiu, Zuhd, 60.)

Pejgamberi (a.s.), na informon se gjuha, në krahasim me organet e tjera, është në një pozitë më të rëndësishme, jo në aspektin e funksionit të saj biologjik, por etik. Gjuha e lartëson njeriun ose e ul përballë Allahut dhe përballë njerëzve. Një fjalë e bukur, siç bëhet shkak për të fituar kënaqësinë e Allahut, bëhet shkak për të fituar edhe mirënjohjen e njerëzve. Pejgamberi (a.s.), e shpreh kështu këtë fakt: “Njeriu për një fjalë që e pandeh të parëndësishme, por që Allahu është i kënaqur, bëhet shkak që të lartësohet nga Allahu; dhe për një fjalë të parëndësishme që thotë, por që Allahu nuk është i kënaqur me të, hidhet në xhehenem.”

Kurse Kurani na mëson se një fjalë e mirë është më e vlefshme se një lëmshë, që shoqërohet me fjalë fyese. Plaga e hapur nga gjuha, është shumë e vështirë të shërohet, sepse godet zemrën.

Muhamedi (a.s.), i ka shpjeguar Muadh ibën Xhebelit disa tema shumë të rëndësishme, që përfshijnë edhe rëndësinë e gjuhës në jetën e myslimanit. Muadh ibën Xhebeli tregon: “Isha me të dërguarin e Allahut, lavdërimi dhe shpëtimi i Tij qofshin mbi të dhe iu luta të më tregonte një vepër që do të më shpinte në xhenet dhe do të më largonte nga xhehenemi.”

Muhamedi (a.s.), tha: “Më ke pyetur për diçka shumë të vështirë, por që është e lehtë për atë që ia lehtëson Allahu: të adhurosh Allahun dhe të mos i shoqërosh ortak, ta falësh namazin, të japësh zekatin, ta agjërosh Ramazanin dhe të kryesh haxhin.”

Pastaj vazhdoi dhe tha: “A dëshiron të t’i tregoj dyert e mirësisë? Agjërimi është mburojë (nga zjarri i xhehenemit). Lëmshja i shuan mëkatet, siç shuan uji zjarrin. Namazi i natës është simboli i njerëzve të mirë.” Pastaj i Dërguari lexoi ajetet: “**Ata ngrihen nga shtrati, i luten Zotit të tyre me frikë e shpresë dhe japin nga ajo që iu kemi dhënë Ne.. Askush nuk di se çfarë gëzimesh janë fshehur për ata (në jetën tjetër), si shpërblim për punët e mira që kanë bërë.**” (Sexhde, 16, 17) “**Baza e çdo gjëje është Islami, ndërsa shtylla e tij është namazi, kurse kulmi tij është xihadi.**” (përpjekja për të lartësuar fjalën e Allahut)

- A të tregoj për më të rëndësishmen, nëpërmjet së cilës i zotëron të gjitha ato që përmendëm më sipër?

Ai kapi gjuhën e tij dhe tha: “Ruaje këtë.” I thashë: “A do të gjykohe mi për atë që flasim, o Pejgamber i Allahut?!”

Çfarë mendon se i hedh njerëzit në zjarr në ditën e gjykimit, përveç gjuhës dhe të korruarat e saj.

Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Një fjalë e bukur, thënë vëllait besimtar, është si t’u japësh lëmshë për nga shpërblimi.
2. Fjala e mirë është shkak për të hyrë në xhenet.
3. Fjala e rëndë mund të bëhet shkak për të shkuar në xhehenem.

Nga lulishita e zemrës

Osman Nuri Topbash



Nga morali shembullor i të dashurve të Allahut

ZOTËRUESI I KURANIT

Ajetet e Kuranit kanë zbritur pjesë pjesë në formën e mesazheve hyjnore, të cilat kanë thurur dalëngadalë jetën profetike prej 23 vjetësh. Kur zbriten ndonjë ajet, të Dërguarin e Allahut (a.s.) dhe shokët e tij të zgjedhur, herë i kapte një lumturi e papërshkrueshme, herë trembeshin dhe herë u shtohet devotshmëria. Në sajë të këtyre mesazheve që vinin prej Allahut Teala, ushqej bota shpirtërore e besimtarëve, rritej dëshira e tyre për të punuar dhe dashuria për besimin arrinte majat më të larta në zemrat e tyre.

Për të parët tanë të mirë, sahabët fisnikë, zbritja e shpalljes ishte një sofër hyjnore që zbriste nga qielli, prandaj dhe nuk ngopeshin kurrë me të. Sa herë që dëgjonin se ishte zbritur ndonjë ajet, vraponin menjëherë për tek ajo sofër hyjnore dhe me një entuziazëm të papërshkrueshëm, prej urdhrave të reja që zbrisnin mundoheshin të mësonin përgjigjen e pyetjes: "Në cilat punë është kënaqësia e Allahut?".

Abdullah ibën Mes'ud (r.a.), tregon:

"Kur një sahabi vinte në shtëpi (në mbrëmje), gruaja e tij i bënte më parë këto dy pyetje:

1- Sa ajete janë zbritur sot nga Kurani?

2- Sa prej haditheve të Profetit (a.s.), mësove përmendsh?.. (Abdulhamid Keshk, FiRihabi't-Tefsir, I, 26.)

TË APASIONUARIT E VAHJIT

Sahabët e nderuar ishin aq të lidhur me vahjin, sa që hidhërimi i tyre më i madh pas ndërrimit jetë të Profetit (a.s.), ishte ndërprerja e vahjit. Kjo ndodhi është shembulli më kuptimplotë i këtij fakti:

Ummu Ejmen (r.anha), ishte dadoja e Profetit tonë (a.s.). Për shkak të ndjenjës së madhe të dashurisë që kishte për të, Profeti (a.s.), e vizitonte shpesh dhe e respektonte shumë atë. Pasi i Dërguari i Allahut (a.s.), ndërroi jetë, Ebu Bekri (r.a.), i thotë Omerit (r.a.):

"Ngrihu të shkojmë tek e afërmja e të Dërguarit të Allahut (a.s.), Ummu Ejmenja. Ta vizitojmë edhe ne, ashtu siç e vizitonte i Dërguari (a.s.)."

Kur shkuan tek ajo, Ummu Ejmen (r.anha), filloi të qante. Ata pandehën se me këtë vizitë, i kishin kujtuar Profetin (a.s.), prandaj edhe ajo filloi të qante. Por më pas, e pyetën:

"Përse po qan? A nuk di se Profeti gjendet midis të mirave pranë Allahut Teala?"

Ummu Ejmen tha:

"Unë nuk po qaj për atë. Dhe sigurisht që e di se Profeti ndodhet midis të mirave pranë Allahut. Unë po qaj për ndërprerjen e vahjit".


Këto fjalë të mbushura plot me mall për vahjin, i prekën shumë dy sahabët e nderuar, Ebu Bekrin dhe Omerin (r.anhuma). Prandaj filluan të qanin së bashku me Ummu Ejmenen. (Muslim, Fedailu's-Sahabe, 103.)

Dashuria që kishin sahabët e nderuar ndaj Kuranit Kerim, ishte shumë e veçantë, sepse vlerën e Kuranit, mënyrën e leximit dhe respektin ndaj tij, e kishin mësuar drejtpërdrejt nga Profeti (a.s.). Dhe për këtë arsye, ata përfitonin në një mënyrë të veçantë prej Kuranit. Ata e lexonin shumë atë dhe nuk dëshironin t'u ikte ndonjë ditë pa e lexuar dhe pa parë faqet e tij. Ditën e fillonin me Kuran, ndërsa ata që kishin shqetësime nga sytë, këshilloheshin të shihnin Mushafin Sherif. (Shih. Hejthemi, VII, 165)

Një natë, Omeri (r.a.), nuk kishte mundur të lexonte Kuran. Të nesërmen, i Dërguari i Allahut (a.s.), i thotë:

"O biri i Hattabit! Allahu Teala ka zbritur një ajet në lidhje me ty" dhe më pas lexoi këtë ajet:

"Ai krijoi natën dhe ditën, që të vijë njëra pas tjetrës, si këshillë për ata që duan ta kujtojnë ose duan



ta falënderojnë.” (el-Furkan, 62)

“Adhurimet që të kanë ikur natën, plotësoji ditën, ndërsa ato që të kanë ikur ditën, plotësoji natën.” (Razi, XXIV, 93, në tefsirin e el-Furkan, 62.)

KURANI ËSHTË I SHENJTË, TË FISNIKËRON

NafibinAbdi'l-Haris ishte takuar me Omerin (r.a.), në Usfan. Omeri (r.a.), e kishte emëruar si vali në Mekë, prandaj dhe e pyeti:

- Kë ke lënë (si zëvendës) në krye të mekasve?

- Ibën Ebzan!- u përgjigj ai.

-Kush është Ibën Ebza?- pyeti Omeri (r.a.).

- Një nga sklllevërit që kemi liruar.- u përgjigj Nafu.

Kur Omeri (r.a.), i tha:

- Në vendin tënd ke lënë një skllav të liruar?- Nafu i dha një përgjigje shumë të bukur dhe mbresëlënëse:

- Ai e lexon Librin e Allahut (e jeton dhe e zbaton) dhe i njeh mirë farzet.

Pas kësaj, Omeri (r.a.), i mahnitur thotë:

I Dërguari i Allahut ka thënë: *“Allahu, me këtë Kuran, disave ua rrit vlerën, ndërsa disa të tjerë i poshtëron!”* (Muslim, Musafirin, 269.)

Lumturia e besimtarit dhe e shoqërisë arrihet me futjen



Kuranit dhe Sunetit që është edhe zbatuesi i tij, në çdo fushë të jetës. Kurani është një nur që i jep paqe botës së brendshme dhe të jashtme të besimtarit. Ai është i mbushur përplot me urtësi, mësim dhe këshilla. Është i vetmi udhëzues që të shpie tek Haku. Ajetet e Kuranit ndriçojnë errësirat historike dhe shpjegojnë të pashpjegueshmet. Kurani është një vend i mrekullive, ku mund të jetohet pranvera e lumturisë dhe e paqes së kësaj bote dhe botës tjetër.

Kurani është fjala e mrekullueshme e Zotit tonë. Është pasqyrimi në fjalë i shfaqjeve hyjnore të gjithësisë. Mirëpo, të ndriçohesh me nurin e tij dhe të përfitosh prej të vërtetave të tij, është privilegj vetëm për besimtarët me zemër të pastër, të cilëve Allahu u ka falur pjesë prej urtësisë.

Zemra e ndriçuar më së shumti me Kuran, ka më shumë vlerë pranë Allahut. Edhe Profeti ynë (a.s.), në çdo çështje u jepte më përparësi Zotëruesve të Kuranit. Kur ishte duke u përgatitur për fushatën e Tebukut, sanxhakun e bijve të Nexharit ia dha Umarebin Hazmit (r.a.). Mirëpo, kur pa Zejdbin Thabitin (r.a.), e mori sanxhakun prej Umares dhe ia dha atij. Umare (r.a.), pyeti:

“O i Dërguar i Allahut! Mos u hidhërove gjë me mua? (Bëra ndonjë gjë të papëlqeshme?)”

Profeti (a.s.), u përgjigj duke thënë:

*“Ai krijoi natën dhe ditën,
që të vijnë njëra pas tjetrës,
si këshillë për ata
që duan ta kujtojnë
ose duan ta falënderojnë.”*

(el-Furkan, 62)

"Jo! Uallahi nuk jam hidhëruar! Por edhe ju merruni më shumë me Kuran! Zejdi ka mësuar më shumë Kuran se ti. Njeriut që di më shumë Kuran, i jepet më tepër përparësi se të tjerëve, edhe nëse mund të jetë një skllav me hundë të prerë!" (Uakidi, Megazi, Bejrut 1989, III, 1003.)

Osman bin Ebi'l-As (r.a.), tregon:

Shkuam tek Profeti (a.s.), si përfaqësues të fisit tonë. Prej të gjithë shokëve të mi, unë isha më i zellshmi në mësimin e Kuranit. Me mësimin e sures el-Bekare, arrita të isha më lart se të tjerët. Për këtë arsye, Profeti (a.s.), më tha:

"Megjithëse je më i vogli prej të gjithëve, po të vendos i prijës të grupit. Mos e prek Kuranin, nëse nuk je i pastër!" (Hejthem, I, 277.)

Në Uhud, Ensarët pyetën:

"O i Dërguari i Allahut! Prej radhëve tona ka shumë shehidë. Çfarë na urdhëron të bëjmë?"

I Dërguari i Allahut (a.s.), urdhëroi të hapeshin varre të thellë dhe të gjerë dhe të varroseshin tre nga tre. Kur sahabët pyetën se cilët prej shehidëve të varrosnin më parë, Profeti (a.s.), tha:

"Varrosni më parë atë që dinte më shumë Kuran!" (Nesai, Xhenaiz, 86, 87, 90, 91.)

Shembujt e respektit të madh, që tregonte i Dërguari i Allahut (a.s.), për zotëruesit e Kuranit, janë të shumtë. Ne si umeti i Muhamedit (a.s.), kemi për detyrë të respektojmë edhe Kuranin, si librin e shenjtë të Allahut, por edhe zotëruesit e Kuranit, ata që e mbajnë Kuranin në zemrat e tyre, hafizët e vërtetë. Duhet t'u japim rëndësi dhe t'u dalim për zot, sepse ata janë shkak i mëshirës hyjnore në të dyja botët.

TË AFËRMIT E ALLAHUT: ZOTËRUESIT E KURANIT

I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

"Padyshim që ka prej njerëzve, të cilët janë të afërt me Allahun!"

Sahabët fisnikë e pyetën:

"O i Dërguar i Allahut! Kush janë ata?"

Profeti (a.s.), u përgjigj:

"Ata janë zotëruesit e Kuranit dhe robërit e mirë të Allahut!" (IbënMaxhe, Mukaddime, 16.)

Nuk ka nder dhe lumturi më të madhe se të jesh i afërt i Krijuesit të gjithësisë, Allahut Teala. Për të merituar këtë nder dhe lumturi, duhet plotësuar kushti i të qenit prej zotëruesve të Kuranit. Pra, ta lexosh Kuranin në mënyrë të përsosur, të hysh në atmosferën e tij duke u zhytur në një meditim të thellë, të marrësh mësimet e dhura dhe të ecësh në drejtimin që tregon ai. Besimtarët që arrijnë të bëhen zotërues të Kuranit me një përsosmëri të tillë, përfitojnë prej bujarisë dhe mirësisë së veçantë të Allahut Teala.

I nderuari Muhmud Sami Ramazanoglu (Allahu e mëshiroftë!), na ka treguar se në qytetin e Adanës kishte ndërruar jetë një hafiz me këto cilësi që përmendëm

më sipër. Pas 30 vjetësh, për shkak se në vendin ku ishte varrosur do të kalonte një rrugë, u detyruan ta zhvarrosnin për ta varrosur në një vend tjetër. Por për çudinë e të gjithëve, trupi i tij qëndronte aty i paprishur. Madje edhe qefini me të cilin ishte mbështjellë, qëndronte i pastër si ditën e parë.

Në një hadith fisnik, i Dërguari i Allahut ka thënë se

Allahu e ka urdhëruar tokën që të mos e tretë trupin e zotëruesve të vërtetë të Kuranit. (Shih. Dejlami, I, 284/1112; Aliel-Muttaki, I, 555/2488.)

Kurani Kerim sjell në zemrat dhe gjuhët e atyre që jetojnë sipas udhëzimeve hyjnore, butësi, delikatesë, bukuri dhe ëmbëlsi shpirtërore. Përveç kësaj, ai do të jetë shkak qetësie dhe lumturie në ditën e gjykimit, kur të gjithë të jenë mbledhur në mahsher dhe të fillojë peshimi i veprave.

Muhjiddin Arabiu (Allahu e mëshiroftë!), ka këshilluar kështu:

"Duhet ta lexosh shumë Kuranin dhe të mendosh për kuptimin e tij. Gjatë leximit, bëj kujdes në cilësitë me të cilat Allahu Teala ka cilësuar robërit e Tij të dashur! Shih edhe ato vepra të këqija, të cilat Kurani i qorton dhe Allahu i ka cilësuar si të humbura dhe ruaju prej tyre. Të gjitha këto, Allahu i ka zbritur dhe i



Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!
"Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (gjithçka)" (Alak, 1)

ka përmendur në librin e Vet, vetëm që ti të punosh me to dhe të bësh atë që kërkohet. Për këtë arsye, kur të lexohet Kurani, bëhu njësh me Kuranin, që të kuptosh brendësinë e tij!”

Që të arrish të përfitosh shpirtërisht prej Kuranit, kërkohet që gjatë leximit, zemra të mos jetë e shkujdesur, sepse leximi i Kuranit bëhet me zemër. Detyra e syrit është të veprojë si një lloj syze për zemrën. Të pasur e të varfër ulen në gjunjë dhe lexojnë Kuran përpara të njëjtës rahleje, por çdokush merr prej Kuranit sipas gjendjes së tij shpirtërore.

Allahu Teala, në lidhje me ata që janë të shkujdesur ndaj Kuranit dhe ata që përfitojnë shpirtërisht prej Kuranit, shprehet:

“Pastaj, Ne ua dhamë Librin robërve Tanë të zgjedhur (nga ndjekësit e Muhamedit (a.s.). Disa prej tyre i bëjnë dëm vetes (duke bërë vepra të ndaluara), disa janë në rrugë të mesme (duke kryer detyrimet dhe duke shmangur të ndaluarat), ndërsa disa, me lejen e Allahut, shkojnë përpara me të mira (përtej detyrimeve); kjo është dhuntia e madhe.” (el-Fatir, 32)

Pra, ka prej njerëzve që, kur lexojnë Kuran, nuk u kalon më poshtë se fyti. Ai nuk u reflekton as në zemër dhe as në vepra. Në këtë mënyrë, i bëjnë dëm vetes dhe humbasin mirësinë më të madhe. Disa të tjerë janë në rrugë të mesme. Bëjnë edhe punë të mira, por edhe neglizhojnë. Ndërsa, disa të tjerë përparojnë me hapa gjigandë në mirësi dhe në përfitimin shpirtëror të Kuranit.

Për të përfituar shpirtërisht prej Kuranit, duhet që përveç pastërtisë trupore, t’i japim rëndësi edhe pastërtisë shpirtërore. Përndryshe, sëmundjet e zemrës e pengojnë njeriun të takohet në mënyrën e duhur me Kuranin. Për këtë arsye, Osmani (r.a.), ka thënë:

“Nëse zemrat do të ishin të pastra prej papastërtive shpirtërore, nuk do të ngopeshin kurrë me Kuranin”.

Ndërsa i nderuari Mevlana Xhelaleddin Rumi, ka thënë:

“Kuranin e kuptojnë vetëm ata, të cilët u kanë vënë zjarrin dhe i kanë bërë shkumb e hi dëshirat dhe epshet e tyre dhe ata të cilët janë shkrirë përpara Kuranit duke sakrifikuar shpirtin e tyre”.

Kurani Kerim ua hap të fshehtat e veta vetëm zemra-

ve të pastra dhe të mbështjella me nur. Për këtë arsye, duhet që zemrat tona t’i mbështjellim me devotshmëri dhe me këto ndjenja t’i afrohem Kuranit, sepse Allahu Teala shprehet:

“...ruajuni Allahut! Allahu ju mëson ju...” (el-Bekare, 282.)

Nuk duhet harruar se Kurani nuk është vepër e një të vdekshmi, por është një udhëzues i rrugës së drejtë, të cilin Krijuesi i gjithësisë na e ka falur, me qëllim që të arrijmë lumturinë në këtë botë dhe botën tjetër. Prandaj, për të përfituar në mënyrën e duhur prej Kuranit, duhet që kapakun e tij ta hapim me ndjenja të larta respekti dhe ta lexojmë me vetëdijen që Allahu Teala u ka mësuar njerëzve. Pra, ta lexojmë Kuranin sikur është duke u zbritur në ato momente.

SIKUR JEMI DUKE FOLUR ME ALLAHUN

Kurani Kerim është rruga më e mirë për njeriun që të dëgjojë thirrjet e Rrahmanit, të ndjejë në shpirtin e tij fladët hyjnore dhe të flasë me Allahun që në këtë botë. Të lexosh Kuran duke medituar, me rregull dhe edukatë, është sikur të flasësh me Allahun. Profeti ynë (a.s.), ka thënë:

“Nëse dikush prej jush dëshiron të flasë me Allahun, le të lexojë Kuran me qetësi shpirtërore”. (Sujuti, I, 13/360)

Për të përfituar siç duhet prej Kuranit, duhet t’i hapësh zemrën atij. Përndryshe, ashtu siç nuk përfitojnë shkëmbinj të prej shirave të begatë të prillit, ashtu edhe zemrat e kyçura nuk mund të kenë dobi prej Kuranit. Mbase Kurani ua shton njerëzve të tillë edhe më tepër humbjen, sepse ata që nuk arrijnë të takohen me mëshirën dhe udhëzimin e Kuranit, bien në një humbje të madhe. Njëri prej mufesirëve më të famshëm të tabiinëve, Katade, ka thënë:

“Ata që lexojnë Kuranin Kerim ose përfitojnë, ose humbasin. Në një ajet fisnik urdhërohet:

“Ne shpallim nga Kurani atë që është shërim dhe mëshirë për besimtarët e që mohuesve keqbërës u shton vetëm humbje.” (el-Isra, 82.)”

Prandaj, gjatë leximit të Kuranit, nuk duhet të sillemi si të verbër e të shurdhër përpara tij. Në një ajet fisnik, në lidhje me gjendjen e të dashurve të Allahut, të cilët përfitojnë prej ndjenjave shpirtërore që u fal Kurani, urdhërohet:

“Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, fërgëllojnë dhe, kur u lexohen shpalljet e Tij, u forcohet besimi dhe mbështeten vetëm te Zoti i tyre.” (el-Enfal, 2.)

Detyra jonë si besimtarë është të bëjmë një jetë nën udhëzimin e Kuranit. Në të kundërtën, ndërsa presim që Profeti ynë (a.s.), të bëjë shefat për ne, mundet që ai edhe të ankohet për ne. Në një ajet fisnik, tregohet se Profeti ynë (a.s.), do të ankohet për ata që bëjnë një jetë në kundërshtim me parimet e Kuranit:

“Dhe i Dërguari do të thotë: “O Zoti im! Populli im e shpërfilli Kuranin, si (diçka) të urryer”. (el-Furkan, 30.)

Pra, për të mos rënë në këtë qortim profetik në ditën e gjykimit, duhet që Kuranin Kerim ta lexojmë shpesh dhe sipas rregullave të texhudit. Gjithash-tu, duhet të mësojmë kuptimet e tij të thella dhe të mendo-hemi ta zbatojmë atë me ndjenja të larta dashurie dhe respekti, siç i takon një myslimani të vërtetë, i cili pretendon se është prej umetit të Muahamedit (a.s.). Siç do të shprehej edhe vetë Gazaliu: “Gjuha duhet të lexojë. Mendja me urtësinë e saj duhet të përkthejë dhe të mendtojë. Ndërsa zemra, duhet të përvetësojë dhe të marrë mësim.” (Shih. Ihja’u-Ulumi’d-Din, I, 816.)

Profeti ynë (a.s.), dëshironte shumë që umeti i tij të ishte gjithmonë i lidhur me Kuranin. Madje ai jetonte me vetëdijen dhe shqetësimin se, në lidhje me këtë çështje, do të jepte llogari përpara Allahut në ditën e gjykimit. Për këtë arsye, ai merrej më shumë me ashab-i suffe, që ishin nxënësit e Kuranit. Madje edhe në kohët kur mbretëronte zia e bukës, ai lidhte gurë në bark dhe shkonte të jepte mësim Kurani.

Abdullah ibën Mes’udi (r.a.), i cili ishte prej nxënësve të ashab-i suffes dhe u edukua pranë Profetit (a.s.), ka thënë:

“Profeti ndikoi aq shumë tek ne, sa arritëm të dëgjo-

nim edhe dhikrin e kafshatave të bukës që kalonin në fytyrë tonë”. (Buhari, Menakib, 25.)

Brezi i sahabëve, të cilët morën shembull Profetin (a.s.), në lidhje me mësimin e Kuranit, e mbushi Medinën me mësues Kurani.

PËRGJEGJËSIA JONË NDAJ KURANIT

Kurani Kerim është i fundit i katër librave hyjnorë që e kanë burimin tek Allahu Teala. Ai është thirrja dhe mesazhi i fundit i Allahut për mbarë njerëzimin. Prej të gjithë librave që ka shpallur, Kurani Kerim është i vetmi libër për të cilin Allahu ka premtuar se do ta ruajë deri në ditën e kijametit. Për këtë arsye, ai është i vetmi libër hyjnor, i cili ka ruajtur origjinalitetin e vet pa iu ndryshuar qoftë edhe një germë. Mirëpo, megjithëse

Allahu ka premtuar se do ta ruajë Kuranin, nuk do të thotë se ne nuk kemi kurrfarë përgjegjësie ndaj Kuranit. Për këtë arsye, duhet të llogarisim veten se sa familjaritet kemi me Kuranin. Sa e lexojmë atë, duke e ndjerë dhe kuptuar mesazhin e tij? A i ndjejmë edhe ne emocionet që ndjente Profeti (a.s.), me sahabët e tij, kur e lexonin atë?

A kemi arritur ta transferojmë Kuranin Kerim në çdo pjesë të jetës sonë? Sa e marrim atë si kriter në jetën tonë familjare, në marrëdhëniet me

komshinjtë dhe në jetën tregtare? Sa e shohim veten tonë përgjegjës për kohën dhe shoqërinë?

A u japim edukatën e duhur fëmijëve tanë, në lidhje me njohjen e Allahut? Sa jemi duke punuar për të përhapur Kuranin në zemrat e të tjerëve dhe për të ndihmuar në udhëzimin e tyre?

Të mos harrojmë se lumturia e të dyja botëve është e mundur me edukimin e fëmijëve tanë, të cilët janë një amanet hyjnor, me kulturën e Kuranit. Prindi më i mëshirshëm është ai që e përgatit fëmijën e tij me edukatën Kuranore, që është edhe e ardhmja e vërtetë në botën tjetër. Dhurata më e bukur, që mund t’i bëjë njeriu fëmijës së tij, është edukimi i mirë.



“Ne shpallim nga Kurani atë që është shërim dhe mëshirë për besimtarët!” (Isra, 82)

Prindërit, të cilët nuk i ndihmojnë fëmijët e tyre të shijojnë prej mirësive të panumërta të Kuranit, për arsye se nuk i kanë shijuar as vetë, kanë mbi supet e tyre një gjynah shumë të madh. Fëmijët, që nuk edukohen me shpirtin e Kuranit dhe Sunetit dhe lihen analfabetë në çështjet shpirtërore, në ditën e kijametit do t'i akuzojnë prindërit e tyre në lidhje me këtë çështje. Ibën Omeri (r.anhuma.), thotë:

“Edukoje mirë fëmijën tënd, sepse je përgjegjës dhe do të japësh llogari se çfarë ke bërë në lidhje me edukimin e tij dhe çfarë i ke mësuar”.

Në një hadith fisnik thuhet:

“Edukojini fëmijët tuaj në tri çështje: në dashurinë ndaj Profetit, në dashurinë ndaj Ehl-i Bejtit dhe në leximin e Kuranit..., sepse shërbyesit e Kuranit (ai që mëson Kuran, ua mëson të tjerëve dhe shërben në këtë rrugë), do të jenë së bashku me profetët dhe të dashurit e Allahut nën hijen e Arshit, në ditën e kijametit, ku nuk do të ketë hije tjetër përveç hijes së Arshit”. (Munavi, Fejzu'l-Kadir, I, 226.)

Prandaj dhe një nga çështjet më të rëndësishme të besimtarëve të sinqertë, është edukimi i fëmijëve të tyre me shpirtin Kuranor.

Halifi II, Abbasi, Ebu Xhafer Mansur, i pyet Emevitët, që ishin burgosur gjatë trazirave politike të kohës:

“Çfarë vështirësish keni në burg?”

Ata përgjigjen, duke thënë:

“Jemi të privuar nga edukimi i fëmijëve tanë”. (Ibrahim Xhanan, Kutub-i Sitte, I, 381.)

Për këtë arsye, duhet t'i edukojmë fëmijët tanë me shpirtin Kuranor, pa na ikur rasti prej dore, sepse, nesër kur të jemi në varr, do të bëhemi shumë pishman se nuk arrijmë ta bëjmë. Prandaj dhe me fëmijët tanë duhet të interesohemi në kohën e duhur. Duhet që në zemrat e tyre të pastra të mbjellim dashurinë për Allahun dhe Profetin (a.s.), për kulturën Kuranore dhe profetike. Duke u nisur nga fakti se talentet dalin në pah me motivim, për të zhvilluar bukuritë shpirtërore të fëmijëve tanë, duhet t'i motivojmë ata me dhurata dhe komplimente.

Imam Maliku (Allahu e mëshiroftë!), thotë:

“Sa herë që mësoja përmendsh një hadith, babai

më jepte një dhuratë. Por erdhi një kohë, kur mësimi përmendsh i hadithit u bë dëshira ime më e madhe, edhe pse babai nuk më jepte dhurata”.

Imami Ebu Hanife (Allahu e mëshiroftë!), kur djali i tij Hamadi mësoi suren Fatiha, i dha mësuesit të tij pesëqind dirhem. Në atë kohë, me një dirhem mund të blihej një dash. Mësuesit iu duk e tepërt kjo bujari, sepse djali kishte mësuar vetëm suren Fatiha. Por Ebu Hanifa, tha:

“Mos e nënvleftëso suren që i mësove djalit tim! Nëse do të kisha me vete më shumë (para), do të t'i jepja të gjitha që të tregoja respektin e duhur ndaj Kuranit.”¹

Ndërsa Salahuddin Ejjubi, kur ishte duke shëtitur në kampin ushtarak, pa një djalë që po lexonte Kuran përpara babait të tij. Atij i pëlqeu leximi i djaloshit, prandaj i dha një pjesë prej ushqimit të tij. Përveç kësaj, babait dhe djalit të tij i dhuroi një pjesë prej tokës që zotëronte.²

Të gjithë këta janë shembuj të bukur, prej të cilëve duhet të marrin mësim të gjithë prindërit, në lidhje me edukimin e fëmijëve të tyre. Për mësimin e Kuranit duhen shfrytëzuar shumë mirë edhe pushimet e verës. Nuk duhet të mjaftohemi me dërgimin e fëmijëve në kurset e Kuranit apo në xhami, por si prindër, duhet të interesohemi më nga afër me ecurinë e edukimit të tyre. Duhet të kontrollojmë më shpesh nivelin e kulturës së tyre Kuranore, dituritë e tyre në lidhje

me besimin dhe fikhun dhe vazhdimisht t'i motivojmë me interesimin tonë.

Lum ata prindër që arrijnë shefatin e Kuranit dhe Profetit (a.s.), duke edukuar fëmijët e tyre me frymën shpirtërore të Kuranit!..

Allahu na ruajtë nga mbajtja e ngarkesës së rëndë të zemrave të sëmura, që janë shkatërruar për shkak të privimit nga Kurani. Na bëftë të gjithëve prej robërve të lumtur, që takohen në shërimin, udhëzimin dhe mëshirën e Kuranit dhe që vrapojnë të qetë drejt takimit hyjnor...

Amin!

1. Ebu Gudde, *Fethu Babi'l-Inaje*, Fq. 19; Muhammed Nûr Süveyd, *Peygamberimizin Sünnetine Çocuk Eğitimi*, s. 119-120.

2. Bundari, Ebu'l - Feth Ali, en - Nevadiru's - Sultanije (Siretu Salahuddin), fq. 9; Muhammed Nûr Süveyd, a.g.e, s. 120.



Vlerësimi në nivel shkolle domosdoshmëri për rritjen e cilësisë

Kujtim Dervishi

Sikundër pjesa më e madhe e përbërësve të arsimit edhe mbikëqyrja e shkollës është rezultat, sa i së shkuarës, aq edhe i të sotmes. Këtë aspekt e ilustron sado pak ndryshimi në vite i mënyrës së vlerësimit të punës së shkollës në përgjithësi dhe mësuesit në veçanti. Në etapat e hershme të zhvillimit të arsimit, vlerësimi i shkollës shihej si detyrë që siguronte monitorimin dhe gjykimin e cilësisë, përkundër standardeve të pranuar. Në vitet '60, u sugjerua që vlerësimi të pranohej edhe si detyrë që e pajis mësuesin me një plan pune për përmirësim. Duke filluar nga vitet 1990, procesi i vlerësimit të shkollave i ka ndërthurur këto dy pikëpamje. Ai mendohet tani bartës i një procesi gjykimi dhe i një informacioni përshkrues dhe korrektues, në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimit arsimor që ofrohet.

Ka dy lloje vlerësimesh të shkollës: vlerësimi i jashtëm dhe ai i brendshëm. Të dy këto vlerësime diskutohen prej një kohe të gjatë në literaturën pedagogjike. Specialistë të njohur përkufizojnë se vlerësuesi i jashtëm është dikush, i cili nuk është i përfshirë në stafin e shkollës që do të vlerësohet. Për shumë vite dhe në shumë vende, vlerësimi i shkollës është konsideruar i barazvlershëm me vlerësimin e jashtëm. Në disa vende, ai është realizuar kryesisht nga inspektorët (në Angli apo vende të tjera evropiane), në disa shtete (p.sh. në SHBA), ai është realizuar nga strukturat e shtetit apo programe vlerësuese të distriktit. Ideja e *përgjegjësise*, e cila ka qarkulluar për afro një çerek shekulli, si dhe idetë relativisht më të reja të vendosjes së standardeve dhe objektivave, si mjetet kryesore për përmirësimin e shkollës, në fund të fundit, i përkasin kësaj tradite të gjatë të kontrollit të shkollës me anë të instrumentave të vlerësimit të jashtëm.

Në vendin tonë vlerësimi i jashtëm është duke u kryer nga struktura inspektuese me dy nivele: Inspektoriati Kombëtar i Arsimit (IKAP) dhe specialistë të inspektimit në nivel Drejtori Arsimore Rajonale (DAR). Inspektimi Kombëtar Shqiptar, në përpjekje për të qenë pjesë e inspektoriateve moderne, është duke vlerësuar shkollat së jashtëmi, nëpërmjet një grupi

të përcaktuar treguesish të cilësisë së shërbimit arsimor që ofron shkolla.

Nga ana tjetër, në nivel shkolle, vlerësimi i brendshëm ose vetëvlerësimi realizohet nga drejtorja nëpërmjet realizimit të një norme të përcaktuar kontrollesh. Shpesh, në këtë proces, drejtorja e shkollës përfshin një mësues/grup mësuesish. Sidoqoftë, përvoja e deritanishme në këtë fushë tregon se jemi ende larg lëvizjes për vetvlerësimin e shkollës.

Procesi i vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të shkollës kërkon përdorimin e një metodologjie shkencore, të qartë, të besueshme dhe bashkëkohore, e cila siguron të dhëna reale dhe mundësi për të pasqyruar pikat e forta, pikat e dobëta, mundësitë që shkolla ka për të ofruar një shërbim arsimor cilësor dhe, në mënyrë të veçantë, nevojat për përmirësimin e saj në të ardhmen.

Sot, në shkollat e arsimit tonë parauniversitar, përdorimi i së njëjtës metodologji dhe i të njëjtëve tregues, si nga ekipet e vlerësimit të brendshëm të shkollës (drejtorja, komisionet lëndore, bordi i i shkollës etj) edhe nga ekipet e vlerësimit nga jashtë (nga Inspektoriati Kombëtar i Arsimit), është një mënyrë që përafron këto dy vlerësime që synojnë përmirësimin e punës së shkollës, por edhe përcaktimin e nivelit të cilësisë dhe të meritave të saj. E rëndësishme është të zhvillohet në shkollë, hap pas hapi kultura e vlerësimit të brendshëm (vetëvlerësim). Kjo është një rrugë profesionale dhe sfiduese, që kërkon njohje dhe zotërim të standardeve profesionale dhe etike të vlerësimit, angazhim dhe përgjegjësi të të gjithë personave të përfshirë në vlerësim, të ekipeve të vlerësimit, të autoriteteve dhe organizmave drejtuese të shkollës.

Politikanët, administratorët, prindërit dhe publiku i gjerë kanë kërkuar qartë që shkollat të vlerësoheshin nga jashtë, për të parë nëse ato ishin duke realizuar detyrat e tyre. Po kështu, është shpresuar se këto vlerësime të jashtme do t'i motivonin mësuesit dhe drejtorët e shkollave për të punuar

më shumë për përmirësimin e shkollave të tyre. Një gjë e tillë vlen të si për shoqëritë demokratike, ashtu edhe për ato jodemokratike, për sistemet arsimore të centralizuara ose jo të tilla. Kjo kërkesë nuk u shua asnjëherë edhe atëherë kur vlerësimi i jashtëm u kritikua ashpër nga mësues novatorë apo kur vlerësimi i jashtëm inkurajohej si një alternativë.

Paralelisht me fenomenin universal të vlerësimit të jashtëm të shkollës, shumë vende kanë tentuar të aplikojnë metoda të reja vlerësimi në nivel shkolle, në formën e vlerësimit të brendshëm apo të vetëvlerësimit. Këto përpjekje duken në përputhje me ide të tjera të tilla, si reflektimi dhe profesionalizmi i mësuesve dhe i administratorëve/liderëve të arsimit. Në një farë mënyre, reflektimi përfaqëson një lloj vetëvlerësimi. Një perceptim profesional i mësimdhënies e trajton këtë si një sipërmarrje komplekse dhe sugjeron që mësuesit duhet të identifikojnë nevojat, të analizojnë objektivat, të zgjedhin strategjitë mësimore, të planifikojnë dhe të monitorojnë punën e tyre. Në këtë mënyrë, vlerësimi shndërrohet në pjesë integrale të profesionit të mësimdhënies, duke u lidhur me aspekte të ndryshme të përgjegjësisë të mësuesve dhe duke mos mbetur i kufizuar vetëm me vlerësimin e rezultateve të nxënësve.

Në të njëjtën kohë, vlerësimi i brendshëm përfaqëson një komponent shumë të rëndësishëm të shkollave me autonomi, siç është edhe shkolla jonë. Shkollat autonome janë të vetënxitura të përcaktojnë objektivat e tyre arsimore, të marrin përgjegjësinë për procesin arsimor dhe të vlerësojnë veprimet e tyre. Në këto kushte, në shkollën tonë kërkohet një përqendrim më i madh për të qenë më të përgjegjshëm për veprimet që duhen ndërmarrë në lidhje me përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor që ne ofrojmë. Nxënësit e shkollës sonë janë më të ngarkuar se bashkëmoshatarët e shkollave publike. Ne e bëjmë më mirë se shkollat e tjera pranimin e mësuesve më të mirë në stafin e shkollës. Ne kemi bazë materiale mësimore më të admirueshme nga shkollat e tjera dhe mjedise të standardeve bashkëkohore. Pra, janë të gjitha kushtet, si për të organizuar një proces mësimor-edukativ me fokus zhvillimin e secilit nxënës, ashtu edhe për ta vetëvlerësuar atë në shërbim të procesit të konsolidimit të arritjeve dhe të përmirësimit të problemeve që kemi. Kjo është vlera që po fiton vlerësimi i brendshëm: jo vetëm mbështetës për përmirësimin e cilësisë, por edhe po u përgjigjet më mirë kërkesave për të cilat shkolla jonë ka përgjegjësi.

Vetëvlerësimi korrekt e ndihmon shkollën të përmirësohet. Nëse kryhet me pikësynime të qarta, vlerësimi i brendshëm shndërrohet në një proces aktiv gjithëpërfshirës, në një instrument të rëndësishëm për menaxhimin në bazë shkolle, duke i shërbyer vendimmarrjes në nivele të ndryshme administrative të institucionit. Ai bëhet një proces i ndër-gjegjshëm profesional, nëpërmjet të cilit shkolla ushtron përgjegjësinë e saj për ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë, për plotësimin e kërkesave që ka shoqëria për arsimimin e nxënësve. Ai kujdeset dhe ofron mjete më të mira për të

treguar se sa mirë jemi duke punuar për nxënësit dhe si mund të punojmë më mirë, cilat janë efektet e edukimit të tyre, cilat janë pikat e forta dhe të dobëta që ka shkolla në shërbimin që u ofron nxënësve .

Shkolla jonë e ka autoritetin e mjaftueshëm për këtë gjë. Prandaj, prej nesh kërkohet të merren vendime në mënyrë të pavarur. Pikërisht në këto situata, vlerësimi i brendshëm bëhet vërtet i dukshëm: ai furnizon me instrumentat për përmirësimin e proceseve të vendimmarrjes, i bën ato më efektive. Pra, përpunimi i një mekanizmi të vlerësimit të brendshëm në shkollë, përbën një investim të qëndrueshëm, i cili u shërben nevojave të informimit të shkollës (nxënësve, mësuesve, prindërve, autoriteteve qendrore etj., nëpërmjet të dhënave apo dokumentacionit të shkollës që prodhon ky vlerësim.


Në të njëjtën kohë, vlerësimi i brendshëm është shprehje e fuqizimit të shkollës dhe e transferimit të përgjegjësisë te mësuesit, nxënësit, prindërit. Pjesëmarrja në procesin e vlerësimit po kontribuon në fuqizimin e shkollës në tërësi, ngaqë jemi duke kërkuar aftësinë për të monitoruar vetveten në mënyrë me sistematike, gjë që na jep një besim më të madh në drejtimit e zhvillimit që kemi ndërmarrrë. Për më tepër, pjesëmarrja në procesin e vlerësimit do t'i fuqizonte individët, duke i pajisur me shprehje vlerësuese, të cilat më vonë mund të përdoren në kontekste të ndryshme. Drejtuesit dhe mësuesit e përfshirë në aktivitetet vlerësuese mund t'i përdorin aftësitë dhe njohuritë vlerësuese që fitojnë, në fusha të tjera të punës së tyre. Për shembull, një mësues që bën kërkime për problemet e cilësisë së mësimdhënies në lëndën e vet, do ta kishte të lehtë t'i përfshinte nxënësit në kryerjen e detyrave me karakter kërkues e krijues.

Një përfitim tjetër i pjesëmarrjes në vepërimtari vlerësuese, është rritja e përfshirjes së mësuesve në proceset vendimmarrëse jashtë klasës, përmirësimi i kolegjalitetit dhe bashkëpunimit midis mësuesve, duke shërbyer si mjet për të nxitur reflektimin. Të gjitha këto janë shumë të rëndësishme për zhvillimin e profesionalizmit të mësuesve në shkollë.

Megjithatë, pavarësisht nga theksi te rëndësia e vlerësimit të brendshëm apo vetëvlerësimit, nuk duhet ta injorojmë vlerësimin e jashtëm. Kontrolli, kërkesa për përgjegjësi si dhe e drejta e publikut për të njohur se si punon shkolla, duhen mbajtur mirë parasysh në sistemet demokratike. Pavarësisht nga fakti që vlerësimi i brendshëm u jep informacion prindërve dhe komunitetit, që rrit përgjegjësinë, besueshmëria e rezultateve të tij do të ishte e kufizuar pa vlerësimin e jashtëm.

Si përfundim, të dy vlerësimet janë të rëndësishëm dhe ata duhet të bashkëjetojnë. Pjesë e kësaj bashkëjetese është ftesa që vlerësimi i brendshëm i shkollës të kryhej me po ata tregues që kryhet vlerësimi i jashtëm, gjë që do të krijonte kushte për dialog me të njëjtën gjuhë vlerësuese dhe do t'i shërbente rritjes së cilësisë së shërbimit arsimor që ofrohet.





Gruaja shqiptare, faktor i rëndësishëm në konsolidimin e familjes dhe vlerave të saj

Zenepe Dibra

Gruaja shqiptare – si gratë e tjera apo ndryshe nga të tjerat? Gruaja shqiptare, e vuajtur si të tjerat, më shumë a më pak? Gruaja shqiptare, më e vlerësuar apo më e nënvleftësuar se gratë e tjera të botës? Nuk ka statistika, nuk ka një analizë, por janë shumë perëndimorë që po kërkojnë të marrin një grua shqiptare. Pse, i pyesim? Pse? Sepse, na thonë, janë gra që kanë vlerësim për familjen, janë gra që i edukojnë mirë fëmijët e tyre, që kanë respekt për bashkëshortët dhe njerëzit e familjeve të tyre. Po. Kjo është e vertetë, sepse me shekuj gruaja shqiptare ishte dhe mbeti faktori më i rëndësishëm i konsolidimit të familjes, përcuesja e traditave më të mira të popullit dhe vlerave të tij. Ishin ato, që lindën dhe mbajtën në prehërin e tyre kombin shqiptar, që ushqyen bijtë dhe bijat e tij me ndjenjat patriotike për të dashur vendin dhe tokën amëtare, ato që *"idhnim n'armikun nepër gji u qisnin", ato që me qumësht të pastër andjen e shpirtit diktojshin, që kobin e zvetnimit nga votra largojshin", "ato të urtat deri në amëshim, ato të thjeshtat deri në madhësi"* - ato ishin dhe janë nderi dhe lavdia e kësaj toke. Po pse gruaja shqiptare është faktor i rëndësishëm i konsolidimit të familjes shqiptare?

1. Së pari, gruaja shqiptare gjithmonë, gjatë shekujve, ka shfaqur vetinë me të mprehtë altrocriste të gruas në përgjithësi, duke vënë në qendër të vëmendjes kënaqësitë që asaj i dha ndjenja për të bërë për të tjerët, gëzimi për t'u përkujdesur për fëmijën, familjen, komshiun, sakrificën për t'u shtyrë për të bërë një nder, zbutjen e vuajtjes së të tjerëve, nëpërmjet kujdesit të saj. Ajo nuk ka ditur t'ia bëjë qejfin vetes, por veç të tjerëve. Ajo s'ka ditur t'i shërbejë kaq shumë vetes, por të tjerëve, ajo në shumë raste ka mohuar veten për sakrificat e pakufishme që ka bërë për të tjerët.

2. Ato kanë mbështetur idealet e djemve dhe bashkëshortëve të tyre, duke i ndihmuar në luftë e në paqe, në vështirësi dhe sakrifica, në idetë dhe në qëllimet e tyre. Ato lindën dhe edukuan kokat më të mëdha të kombit shqiptar të luftës, kulturës, shkencës. Dhanë për vendin loçkat e zemrës, dhjetëra dëshmorë të atdheut, heronj të lirisë e Rilindjes Kombëtare, të luftës kundër fashizmit, demokracisë dhe pluralizmit. Por

ato luftuan edhe vetë; dhanë jetën për këtë vend, për këtë komb Nënëloket dhanë të parat bekimin, kur i nisën fëmijët në luftë, dhuruan të parat urimin, kur i martuan dhe lëshuan kujën, kur ata u ikën nga jeta. I nisën djemtë dhe vajzat në luftë kundër çdo pushtuesi, por gjithmonë në mbrojtje të trojeve amëtare dhe jo për të pushtuar a sulmuar ndonjë vend tjetër. I ndihmuar në idealin e tyre, duke i bërë shtëpitë vende ku strehoheshin, ku mjekoheshin, ku kishin bazat luftëtarët e lirisë. Sipas Faik Konicës, *në kombin tonë duket se tërë hollësia e mendjes dhe e zemrës, tërë bukuria e karakterit dhe e sjelljes, kanë rënë në anën e gruas*; - sepse ato ditën edhe të jepnin edukatën e kulturën, ato ishin arsimdashëset e para të arsimit në shqip të kombit tonë, lindën artistët më të shquar të këtij kombi, duke ushqyer ndjenjën e një të ardhmeje të bukur e të ndritshme për vendin. Nënata shqiptare, që dërguan të parat jo vetëm djemtë, por edhe vajzat në shkollat shqipe, do të mbeten pishtarë të përjetshme të përhapjes së arsimit dhe diturisë. Ato i dërguan fëmijët për t'u shkolluar brenda e jashtë vendit, duke u dhënë këshillën: *"U bëfshi për vendin tuaj, të ktheheni e të punoni për të"*. Në luftërat e ndryshme që bëri populli ynë, nënata shqiptare përkrahën masivisht bijtë e tyre kundër armikut, duke kthyer shtëpitë, pasuritë dhe çdo gjë që kishin, në përkrahje të idealit të tyre. Ato ranë vetë dëshmore, por i dhanë kombit me mijëra dëshmorë, duke treguar një shembull të lartë të qëndrimit burror karshi humbjes së madhe që pësuan. Kishte nga ato që i dhanë luftës edhe dy e tre djem. Ato të papërkulurat, gratë më fisnike të botës, mbas luftës së 1944, do të ballafaqoheshin me një rrebesh të paparë komunist, ku bijat dhe bijtë e tyre, burrat dhe vëllezërit, ndër më të shquarit intelektualë të ndritur të kombit, arsimdashës, patriotë, guximtarë, shkencëtarë, do t'i vrisnin, do t'i varnin, do t'i burgosnin dhe internonin duke kaluar një vuajtje që vetëm ato dinin ta përballonin me stoicizëm, E bashkë me to, do të ngrysnin netët pa mbarim në dyert e burgjeve, në kampet e internimeve, ku kulmonte varfëria, poshtërimi dhe urrejtja. A nuk krijuan ato vlera të ruajtjes së familjes dhe mosprishjes së saj? Ato nuk u ndanë nga burrat e tyre edhe kur u thanë të divorcoheshin, por për të ruajtur familjen shkuan e i ndoqën burrat e tyre, fëmijët, kunetërit, vëllezërit burg më burg, internim më internim,

pa iu ndarë, pa iu shkëputur tringut familjar për të edukuar tek fëmijët e tyre një vlerë të madhe: *Familja është e shenjtë*, ajo nuk duhet prishur, ajo duhet mbajtur edhe atëherë kur ndodhin fatkeqësi, edhe atëherë kur të tjerët përpiqen ta rrënojnë atë. E kush më shumë se gratë shkodrane, krijuan traditën morale të durimit të një sakrifice të pashembullt, të një vuajtjeje të papërkohur dhe të një lufte për mbrojtjen e nderit të familjes, fisit dhe kombit. E ato pra, ishin gra, nëna, motra dhe bija të familjeve më të mira shkodrane, ato që kishin të stampuara në dyert e konaqeve, nderin, burrërinë, besën e mikpritjen. Ato që i kishin dhënë këtij vatani jetën e njerëzve më të dashur, u kishin dhënë pasurinë e shpirtit të tyre. Por dikush tentoi t'i damkoste me forcën e urrejtjes, me mizorinë satanike, duke u vrarë, internuar, burgosur dhe syrgjynosur, njerëzit më të dashur; u morën shtëpitë, pasuritë e fituara me djersën e ballit dhe deshën t'u merrnin edhe nderin dhe besën. Por deri këtu nuk arritën, nuk mundën t'i zhduknin ato virtyte, që u ishin ngulitur brez pas brezi në edukatën e tyre, në ndjenjat dhe gjakun e tyre. Ato nuk i mohuan njerëzit e tyre, por me një krenari të paepur, me një durim stoik dhe me një guxim të rrallë, i ndoqën dhe u kujdesën edhe atëherë kur i çuan në skajet më të largëta të Shqipërisë, në miniera, kënetë, zona të thella malore, në burgjet më të tmerrshme. Ja si i përshkruan një psikologe italiane, Xhina Lombrozo, gratë superiore: *"Nuk është pra vetëm në fushën e kulturës, të artit, të shkencës vendi ku duhen kërkuar gratë superiore. Sepse janë superiore edhe gratë bujare e të panjohura, që kanë krijuar me përpjekjet e tyre traditat morale që sot na drejtojnë, gratë që kanë fituar me vuajtjet e tyre, me sakrificat e tyre prestigjin dhe respektin që përfitojnë akoma edhe sot; gratë që kanë arritur të gdhendin burrat e t'u frymëzojnë atyre veprime bujare e qëllime fisnike"*.

Heroizmi, besnikëria, mbështetëse të përjetshme të familjeve të tyre, janë virtytet më fisnike që shfaqën gratë kosovare në luftën e Kosovës, të viteve 1998-1999, ku shumë prej tyre u organizuan dhe u rreshtuan në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Shumë gra dhe vajza u përfshinë edhe vetë në luftë, duke dhënë edhe jetën e tyre si dëshmore të atdheut. Rasti më heroik ka qenë i **femrave të familjes Jashari**, që megjithëse iu kërkua të dilnin nga rrethimi, ato pranuan më mirë të vdisnin me burrat dhe fëmijët e tyre, sesa të jetonin nën serbin. Pra, jo vetëm Oso Kuka u dogj në kullë të barotit për të mos u dorëzuar dhe për të u kënduan kaq këngë trimërie, por janë **12 gra** të familjes Jashari me fëmijët e tyre, që janë djegur dhe vrarë brenda kullës, ngjarje tepër e rrallë botërore, që do të mbahet mend gjatë për sakrificën, burrërinë dhe besën shqiptare të gruas së këtij kombi. Ato nuk e bënë këtë gjest për t'u dukur, as për t'u mburrur, por për të ngritur lart vetinë më të shenjtë të familjes shqiptare: luftën përkrah burrave dhe bijve të tyre, për të mos iu dorëzuar armikut. **Ana Di Lellio**, sociologe italiane, ish komisionere për mediat në Kosovën e pasluftës, do të shprehej, për t'i bërë të njohur botës atë çfarë nuk dihej për trimëritë e gruas kosovare: *"Të gjithë e dinë se kush ka qenë Adem Jashari, por askush nuk di se kush ka qenë gruaja e tij dhe si e ka pasur emrin. Askush nuk flet*

për këtë grua, për Adilen, e cila, në kohën kur Ademi po luftonte bartte municione, nga një vend në tjetrin dhe luftonte.

3. Gruaja shqiptare ka qenë kundër gjakmarrjes. Ajo ka pajtuar familje të tëra, duke mos e nxitur këtë plagë të keqe të shoqërisë, duke u përpjekur të shuajë grindjet, mosmarrëveshjet, ato që sjellin kobin. Ajo është lutur të mos ketë gjak midis shqiptarëve, sepse shqiptarët kanë armiq më të mëdhenj për t'u hakmarrë dhe jo njëri-tjetrin.

4. Gratë shqiptare për të mos prishur familjen, kanë duruar dhunën e të tjerëve, fyerjen dhe poshtërimin. Kanë suportuar stresse, paragjykime, patriarkalizma që i ndalonin të zhvilloheshin dhe ashtu të urta deri në amëshim, nuk e prishën familjen. Ishin të ndershme dhe shpesh duruan edhe tradititë e bashkëshortëve, duruan pijet alkoolike, ndoshta edhe bixhozin dhe nuk e prishën familjen. Ato e humbën jetën e tyre në emër të një sakrifice: *Familja nuk duhet prishur.*

5. Gratë shqiptare besuan fort te Zoti. Ishin besimtare dhe shpresonin te fuqia e Tij, në momentet më të vështira, kur u kërcënohej familja, kur ndaloheshin ritet fetare dhe ato i kryenin në fshehtësi të plotë, kur shumë gjëra thuheshin kundër të Plotfuqishmit dhe në shpirtin e tyre forcohej edhe më tepër besimi, shpresa për një ditë më të mirë, ku **Ai** do të merrte vlerësimin që i takonte.

Këto pra janë nënat dhe vajzat shqiptare, nderet e fiseve në mikpritje, duarartat në punë dore, gojëmblat në gëzime, këshillueset në mendime, punëtore, të pastra e të urta, që kudo kanë vulosur kulturën e lashtë shqiptare, duke e përcjellë brez pas brezi deri në ditët e sotme.

Të dashura nëna dhe motra, ju vajza të reja që do të krijoni familje!

Bota ka çfarë të marrë prej gruas dhe familjes shqiptare. Jo ne të marrim shembullin e tyre, se si çdo ditë degjenerohen familjet, duke kultivuar gjithfarë perversitetesh. Ju gra, ju nëna dhe motra e keni shumë në dorë familjen. Kultivoni traditat tona më të mira, kultivoni me durim respektin ndaj tjetrit, ndaj të dobët, të varfrit, dashurinë për njerëzit, nxitni veprimet e ndershme, kultivoni besnikërinë, siç e kemi pasur traditë, ashtu si na mësuam nënat tona. E keni të vështirë? Po, e keni të vështirë, sepse fëmijët tuaj sot rriten me një informacion të bollshëm që ka edhe elementë të dëmshëm, që merret nga televizionet, interneti, diskot, por edhe shoqëria etj., **por kurrë mos harroni që e para është familja.** Ju lutem, mos u lodhni, mos thoni që hoqa dorë nga djali dhe vajza, sepse nuk më vë vesh, por punoni me dashuri dhe durim. Ne nuk kemi nevojë të marrim shembullin e familjeve perëndimore, brenda të cilave ka shumë gjëra që nuk na pëlqejnë, edhe pse duken moderne, sepse ne kemi familjen tonë shqiptare. Të vijnë të huaj e të marrin shembull nga ne. Atyre iu duhet ky shembull. Ata kanë nevojë për modelin tonë. Të mos mendojnë se familja jonë nuk është moderne. JO. Familja jonë është moderne, se ka në bazë idealet më të pastra, nuk e ka harruar besimin te Zoti, e do shumë vendin, kombin e mbi të gjitha, as është asimiluar dhe kurrë nuk do të asimilohet në këto virtyte.

"Nuk është pra vetëm në fushën e kulturës, të artit, të shkencës vendi ku duhen kërkuar gratë superiore. Sepse janë superiore edhe gratë bujare e të panjohura, që kanë krijuar me përpjekjet e tyre traditat morale që sot na drejtojnë"



Kultura e paqes në fenë islame

Soc. Raimonda Draçini

Për të kuptuar më mirë marrëdhënien ndërmjet të drejtave të njeriut dhe paqes, duhet pasur një vizion pozitiv dhe dinamik për paqen dhe jo një vizion negativ dhe statik. Në këtë perspektivë, paqja nuk mund të reduktohet thjesht në mungesën e luftës, as në një ekuilibër të forcave kundërshtarë, por ajo mund dhe duhet të jetë rezultat i procesit të krijimit të një shoqërie, ku çdo person dhe çdo bashkësi njerëzore të shikojë që të realizohet në realitet dinjiteti dhe zhvillimi i lirë i njeriut. Vetëm kështu ndërtohet "paqja në drejtësi", e karakterizuar nga metoda e dialogut, me qëllim kapërcimin e tensioneve të pashmangshme dhe përdorimin e forcës vetëm në shërbim të së drejtës.

Kurani thekson se, që në fillimet e njerëzimit, njerëzit kanë pasur dije mbi revelacionet për t'u larguar nga rrugët e këqija dhe të fatkeqësive me ndërmjetësinë e profetëve. Islami i pranon këta profetë, sepse ata ishin bartës të mesazhit hyjnor. Para së gjithash, këto mesazhe janë shprehje të dashurisë së Zotit për njerëzit dhe është në interes të tyre për t'u ndjekur këto urdhëresa etike dhe fetare. Është tërë njerëzimi që thirret për të


ecur në rrugën e "strehuar në paqe", sipas shprehjes së Kuranit.

Për ta kuptuar më mirë marrëdhënien ndërmjet të drejtave të njeriut dhe paqes, duhet pasur një vizion pozitiv dhe dinamik për paqen dhe jo një vizion negativ dhe statik. Në këtë perspektivë, paqja nuk mund të reduktohet thjesht në mungesën e luftës, as në një ekuilibër të forcave kundërshtarë, por ajo mund dhe duhet të jetë rezultat i procesit të krijimit të një shoqërie, ku çdo person dhe çdo bashkësi njerëzore të shikojë që të realizohet në realitet dinjiteti dhe zhvillimi i lirë i njeriut. Vetëm kështu ndërtohet "paqja në drejtësi", e karakterizuar nga metoda e dialogut, me qëllim kapërcimin e tensioneve të pashmangshme dhe përdorimin e forcës vetëm në shërbim të së drejtës.

1. Paqen me vetveten.
2. Paqen me njerëzit e tjerë dhe tërë pjesën tjetër të krijimit.

3. Paqen me Zotin, që zotëron tërë pushtetin transcendent, që krijon dhe bën të mundur çdo gjë.

Islami i pranon fetë e zbuluara më parë dhe tregon se popujt e krijojnë paqen e Zotit, sa herë që përpiqen të kenë një sjellje morale dhe të ndihmojnë tjetrin. Vetë termi "islam", e ka rrënjën te fjala arabe *salam*, që do të thotë paqe dhe shpëtim. Myslimanët përshëndeten me shprehjen "paqja qoftë me ju" dhe në fund të secilës nga pesë lutjet e përditshme, besimtari kthehet djathtas dhe pastaj majtas, domethënë drejt dy gjysmave të botës dhe u uron atyre paqen.



Islami mëson se njeriu duhet të jetë pikënisja e paqes dhe, ashtu siç kërkon paqen për veten, duhet ta kërkojë edhe për të tjerët. Njeriu duhet të besojë se do ta marrë forcën shpirtërore të domosdoshme të shpallur nga revelacioni hyjnor. Në këtë vepër të rëndësishme të paqes, njeriu asistohet nga arsyeja, në masën që ia vë veshin. Arsyeja njerëzore, siç theksonte filozofi mistik Al Gazali, është një “shembull i dritës së Zotit”. Kurani i kërkon individit një meditim inteligjent mbi veten, mbi historinë dhe mbi objektivin e njerëzimit. Është kështu, sepse, sipas Kuranit, “kur Zoti formoi njeriun, ai i fryu shpirtin e tij.” (Sure 32/8) Duke ndjekur këtë shpirt brenda vetes, njeriu ndodhet në rrugën e paqes së vërtetë, ai ndjek atëherë prirjen për drejtësi dhe mëshirë. Kjo e nxit që të ndihmojë të shtypurit dhe t’u bëjë mirë atyre që e rrethojnë, faktorë themelorë të ekzistencës njerëzore.

Urdhëresat bazë të moralit, që i gjejmë në të gjitha fetë, në një formë ose në një tjetër, nuk kërkojnë t’u imponohen njerëzve si një strukturë e huaj. Përkundrazi, ato janë kushti themelor i humanitetit të njeriut dhe ndikojnë në zhvillimin e spiritualitetit dhe të paqes: “Duaj për të tjerët atë që do për veten tënde dhe ti atëherë do të jesh një mysliman i mirë”, ka thënë Muhamedi (në *Bukhari*). Ai e konsideronte si detyrën e tij për ta shpënë moralin në realizimin e plotë të tij. Ne mund të veprojmë në frymën e drejtësisë së vërtetë, në qoftë se veprojmë me shpirtmadhësi. Kjo është e vetmja mënyrë për të arritur në një zhvillim të plotë të humanitetit tonë, si te të tjerët dhe te ne. Sipas Muhamedit (a.s.), ai që nuk jep prova të shpirtmadhësisë kundrejt të tjerëve, nuk do të ketë as edhe të drejtë. Forca e brendshme e zemrës, që na shtyn të bëjmë mirë, mund të jetë aktive vetëm kur individ i kthehet me dashuri drejt të tjerëve, ashtu si zjarri që merr flakë vetëm kur vihet flaka në një substancë që merr flakë.

Një traditë që lidhet me profetin, na kujton se çdo


njeri është bari në sferën që i përket. Ashtu siç është përgjegjës bari për trupën e tij, individ i është përgjegjës për gjithçka që ndodhet në sferën e tij. Kjo nuk do të thotë që të injorohen detyrat që ndodhen jashtë kësaj sfere. Ekziston edhe një fjalë e Profetit, që insiston në faktin se kudo ku ne shikojmë padrejtësi, duhet të ndërhyjmë. Sapo e shikojmë të keqen, ne duhet të bëjmë çdo gjë të mundur për ta rregulluar. Në qoftë se nuk mund ta arrijmë përmes akteve, duhet të përipiqemi ta bëjmë verbalisht dhe, në rast mospasë, ne duhet të përdorim zemrën tonë. Por veprimi i zemrës, sipas Profetit, është “forma më e dobët e besimit”. Kjo do të thotë se fati i vërtetë i njeriut në këtë botë, është që të veprojë, jo vetëm në përputhje me besimin, por edhe me arsyen dhe një ndjenjë përgjegjësie.

Këto refleksione tregojnë se pse Kurani i kujton besimtarit se besimi i zemrës dhe veprimet e mira – dhe jo vetëm disa veprime dhe fjalë të mira – janë në gjendje ta drejtojnë njeriun në rrugën e mirë ose në rrugën e paqes. Pikënisja në rrugën e paqes, është ky premtim i paqes, ashtu si hëna e re, simbol i Islamit, është një premtim për hënën e plotë.

Kështu, bota me thesaret e saj nuk janë qëllimi i fundit për njeriun, të cilat janë të vdekshme. Objektivi është fitorja e drejtësisë dhe shpirtmadhësisë.

Në këtë kontekst, Kurani u bën thirrje përfaqësuesve të feve që të merren vesh për të “adhuruar vetëm Zotin dhe të mos i shtojnë atij të tjerë zotër veç Tij.” (Sure 3/57) Zoti na kërkon të praktikojmë drejtësinë dhe shpirtmadhësinë kundrejt të gjithë njerëzve. Feja duhet t’u tregojë njerëzve se si, duke ndjekur këto urdhëresa, ata nuk heqin dorë nga liria e tyre, por do ta gjejnë atë më shumë, në sajë të paqes dhe forcës së brendshme.

Megjithatë, ata janë të lirë të vendosin nëse dëshirojnë ta marrin këtë rrugë, sepse Kurani mëson: “Jo shtrëngim në fe.” (Sure 2/257) Ai kërkon nga njeriu një bashkim me të vërtetë të lirë dhe të arsyeshëm, që e bën të hyjë në qiellin hyjnor dhe e bën të denjë. Prandaj, ai “do t’i dërrmojë në turp ata që nuk aryetojnë”, por edhe ata që nuk i bëjnë asaj një përdorim të arsyeshëm. Për t’iu rikthyer idesë së shtrëngimit në besim, mund të themi se është në natyrën e besimit se është pa vlerë, në qoftë se ai nuk është bindje e lirë dhe intime. Pra, besimi është një zgjedhje, dhe një zgjedhje është zgjedhje, në qoftë se ajo është e lirë dhe e arsyeshme. Ajo është gjithashtu edhe një rrugë që fillon me lindjen e ndërgjegjes dhe arrin në lindjen e përjetësisë, të transfiguruar dhe të



realizuar në ideale të larta. Kjo rritje e njeriut është një rritje përmes ushtrimit shpirtëror të sinqertë. Kur Frojdi, më pas, do të na thoshte se sinqeriteti nuk është gjithmonë i sinqertë dhe një proverb na thotë se rruga për në ferr është e shtruar me qëllime të mira, nuk janë pa bazë. Në zemrat tona ka gjithmonë një "sëmundje", sëmundje që na zbulohet përmes një shqyrtimi vigjilent për ta penguar që të rritet. Nuk është e lehtë të jesh me të vërtetë besimtar.

A bëhet njeriu plotësisht i tillë?

Besimi, ashtu si e vërteta, është kërkues. Besimi është një tension i vazhdueshëm për ta shkullur të keqen nga zemra e besimtarit dhe për ta lidhur me një ideal. Besimi është i pafundëm, një ngjitje e pafundme dhe kështu e kanë kuptuar sufistët, mistikët myslimanë, duke piketuar itinerarin e tyre ngjites, që arrin në shkaktërrimin e së keqes. Në terma pozitivë, kjo do të thotë se rruga drejt paqes, ose lufta për paqen, nënkupton, nga ana e njeriut, përfitim e një spiritualiteti. Sipas termave të Kuranit, ky është "ushqimi i qiellit dhe përmban atë që ka qenë premtuar." (Sure 51/22) Ne duhet ta kërkojmë paqen jo vetëm si një rrugë, por edhe si një qëllim.

Kurani e justifikon ekzistencën e kaq shumë komuniteteve, nga fakti se ato mund të hidhen në një konkurrencë aktive në kërkimin e së mirës morale. Nga fakti që njeriu vendos lirshëm për të mirën, ai mund t'ia dalë mbanë, dhe jo duke zbatuar në mënyrë të thjeshtë udhëzimet – si në një shoqëri totalitare. Kjo do të thotë se forca vendimarrëse dhe vullneti, ndodhen brenda tij dhe ato mund të zhvillohen në sajë të një jete shpirtërore. Kurani shpall: "Në qoftë se Zoti do të kishte dashur, Ai do të kishte bërë vetëm një popull; por ka dashur të provojë besnikërinë tuaj në vëzhgimin e asaj që ju ka dhënë. Vraponi kush e kush më shumë drejt veprimeve të mira." (Sure 5/53)

Kjo do të thotë se diversiteti fetar dhe kulturor, në asnjë rast nuk duhet të bëhet shkak armiqësie ndërmjet njerëzve. Përkundrazi, duhet të shërbejë si nxitës i zhvillimit të njerëzimit, që përkthehet përmes tolerancës, respektit dhe fisnikërisë kundrejt të ndryshmeve. Historia na tregon se të gjitha kulturat e mëdha janë zhvilluar përmes shkëmbimeve me kulturat e tjera, përmes reciprocitetit të këtij shkëmbimi dhe jo përmes shtypjes dhe përbuzjes. Kurani shpall se një nga objektivat e krijimit, është që popujt e ndryshëm të tokës të njihen ndërmjet tyre. (Sure 49/13)

Është me interes të theksohet për argumentin tonë, se Kurani përmban edhe tregues empirikë për mënyrën se si mund të arrihet dhe ruhet paqja. Thelbësore është që vullneti për paqe të mos njohë asnjë limit. Është e qartë se kjo prirje për paqe duhet të karakterizojë edhe të tjerët, qofshin edhe armiq. "Në qoftë se ata prirën nga paqja, edhe ti gjithashtu duhet t'ua japësh." (Sure 8/63), por edhe në rast se armiku nuk shpreh vullnet paqej dhe një luftë bëhet e domosdoshme për të mbrojtur të drejtat e tua, nuk duhet të bëhet asnjë veprim amoral (2/190) Në këtë rast, tradita islamike jep udhëzime të sakta, pikërisht mbi mbrojtjen e popullsisë civile dhe trajtimin e të burgosurve. Në parim, antihumanizmi dhe terrorizmi janë të ndaluara.

Siç e theksuam në fillim, pikënisja e paqes është njeriu që përpiket të veprojë si një i drejtë. Në momentin që njeriu bën të vetën rrugën e paqes, ai do të gjejë edhe forcën e domosdoshme për të mos rrezikuar asnjë betejë për paqen. Sa më i fortë të jetë spiritualiteti i një individi, aq më të mëdha do të jenë edhe veprimet e tij. Lumturia më e lartë është të bësh mirë në vend të së keqes dhe të transformohet armiku i vjetër në një mik të ri. Ndryshe, si do të bëhet e mundur të thyhen zinxhirët e armiqësisë?

Prandaj, Muhamedi vërente se nuk duhet përbuzur edhe veprimi më i vogël i mirë, sepse udhëtimet e mëdha fillojnë gjithmonë me hapin e parë.

Paqja kërkon edhe solidaritetin njerëzor. Muhamedi e thekson këtë në një parabolë, ku e përshkruan njerëzimin të mbledhur në një anije, një pjesë në urën e sipërme dhe një pjesë në urën e poshtme. Ata që ishin poshtë, duhej të shkonin në urën e sipërme për të marrë ujë. Por ata u lodhën dhe hapën një vrimë në anije, për të marrë ujë. Ky veprim vuri në rrezik gjithë anijen, dhe pasagjerët e urës së sipërme duhej të ndërhnin për t'i ndalur ata poshtë. "Në qoftë se këta të fundit nuk do të kishin vepruar kështu, thotë Muhamedi, tërë njerëzimi do të kishte humbur". Kështu, njerëzimi ndodhet në anijen tokë, drejt një destinacioni që e bën të domosdoshme përparësinë e arsyes. Në një gjuhë pozitive, koha jonë kërkon drejtues të arsyes, por edhe të virtytshëm. Pa këto të dyja, nuk mund të ndërtohet një qytet i virtytshëm, siç shkruante Alfarabi (870 – 950) në veprën "Qyteti i virtytshëm". "Për pasojë, mund të kemi një numër kombesh të virtytshëm dhe një numër qytetesh të virtytshëm, fetë e të cilëve janë të ndryshme."





Mosha e tretë dhe respekti ndaj saj, vlerë e shoqërisë shqiptare

Donika Selimi

Familja është gjëja më e shtrenjtë në botë, sepse prindërit tanë janë gjëja më e vyer që ne kemi. Është folur shumë pak në këto vite për familjen, sepse koncepti për familjen e shenjtë, për qelizën e shoqërisë, sot ka marrë një konotacion tjetër. Ne jemi krenuar gjithmonë se familja shqiptare ka themele të forta dhe se do t'u bëjë ballë shumë dukurive negative të kohës. Por fatkeqësisht nuk më rezulton kështu.

Mosha e tretë është pika memorial në lakoren e gjatë të jetës.

Të moshuarit karakterizohen si një nga grupet më vulnerabel, me të ardhura të pakta të siguruar nga pensionet dhe mundësi të pamjaftueshme për të përdorur shërbimet bazë.

Margjinaliteti i kësaj shtrese të shoqërisë ndikohet jo vetëm nga të ardhurat e pamjaftueshme, varfëria dhe problemet shëndetësore, por edhe rreziku i braktisjes, vetmisë, abandonimit, mundësi të kufizuara për kontakte shoqërore, rënie graduale e aftësive fizike, rënie e vetëbesimit dhe vetëvlerësimit. Procesi i urbanizimit të shpejtë dhe lëvizja migratore, me kahje nga zonat rurale dhe periferike, drejt qendrave kryesore urbane, si një lëvizje spontane dhe e pakontrolluar, ka krijuar probleme të mprehta sociale – ekonomike. Viktimat e para të këtij procesi objektiv, natyrisht mbeten të moshuarit. Nën trysinë e faktorëve social-ekonomikë dhe ndikimin e modeleve perëndimore të mënyrës së jetesës, kanë ndodhur ndryshime të dukshme edhe në aspektet psiko-kulturore të funksionimit të familjes. Familja shqiptare, veçanërisht në zonat rurale, me tradita të forta në përkujdesjen ndaj të moshuarve, po tenton drejt familjes nukleare dhe shpërbërjes së bashkëjetesës ndërmjet brezave dhe shumë kurorave. Për rrjedhojë, pleqërimi në vetmi kërcënon, jo vetëm ata që fati apo mënyra e jetës i ka destinuar të jetojnë në vetmi, por edhe të moshuarit që kanë fëmijë. Në qytetin tonë prej **113.800** banorësh ka **22.416** pensionistë. Nga këta, $\frac{1}{4}$ jeton vetëm. Po paralel me këtë, ne nuk jemi ende gati për të mbështetur me shërbime komunitare. Kështu, rezulton se në qarkun tonë ka një qendër rezidenciale dhe një qendër ditore për të moshuar, që së bashku akomodojnë gjithsej 100 vetë. Pra, shërbimet sociale për të moshuar janë shumë pak, në raport me popullsinë e moshuar. Kështu

shohim që të gjitha lulishtet e qytetit janë të populluara nga të moshuar që luajnë domino dhe lojëra tavoline jashtë në natyrë, në ditë të ftohta dhe të nxehta. Një tjetër problem për këtë moshë, është edhe raporti midis të ardhurave dhe shpenzimeve. Nëse para 20 vitesh raporti pension / pagë ishte 70%, tani ky raport është 23 %. Çfarë u tepron të moshuarve, që të përballojnë shpenzimet e tyre? Pothuaj asgjë. Pra, shteti nuk ka para për t'i ndihmuar, shoqëria civile s'ka fonde të vazhdueshme për t'i mbështetur. Kush do të mendojë për këtë moshë? Lind për detyrë që gjatë gjithë jetës të heqim mënjane disa lekë për veten tonë, pasi vitet kalojnë shpejt dhe vjen mosha e pleqërisë. Në vendet e zhvilluara evropiane harxhohet 28 % e GDP për problemet sociale të grupeve në nevojë, kurse tek ne harxhohen vetëm 10%. Pra jemi vend i varfër dhe kemi shumë vështirësi në shtrirjen dhe modernizimin e shërbimeve. Por kujdesi për këtë grup moshe nuk duhet të jetë ekskluzivitet vetëm i shoqërisë civile dhe shtetit. Duhet të bashkëpunojnë shumë aktorë për të pasur më produktivitet. Duhet sjellë në vëmendje vullnetarizmi dhe stimulimi i filantropisë. Gjithashtu, një barrë e madhe i takon pushtetit lokal. Ai ka një detyrë të rëndësishme për përkujdesjen për grupet e margjinalizuara. Nuk mjafton vetëm hartëzimi i shërbimeve, por duhet bërë një buxhetim ndryshe. Hartimi i projektbuxhetit duhet të bëhet me pjesëmarrje dhe grupi konsultativ që do të marrë pjesë në hartim, duhet të përbëhet nga intelektualë që kanë dalë në pensin, por që janë aktivë ende. Sa më shumë që shteti, shoqëria dhe familja do të jenë të vëmendshëm ndaj moshës së tretë, aq më shumë do të rritet kënaqësia e kësaj moshe për të qenë të frytshëm, më aktivë, më produktivë dhe nuk do të bëhen më peshë për familjarët e tyre. Më pëlqen shumë thënia: "Kur vdes një i moshuar, digjet një bibliotekë." Atëherë, të dashura shoqe, të bëjmë më shumë avokati dhe lobing për këtë grup moshe, sepse të gjitha ne, aty do të shkojmë. Të edukojmë një brez të ri të përgjegjshëm, me dashuri për paraardhësit e tyre, me qëllim që t'u shërbejmë sa më shumë prindërve tanë të dashur. Kështu, familja do të jetë më e lumtur, fëmijët do të marrin më shumë dashuri dhe përkujdesje, duke ndërvepruar vrulli rinor me pjekurinë e të moshuarve.

Menaxhimi i sjelljeve të papëlqyeshme të fëmijëve

Prof. as. dr. Fatmir Vadahi

Ndërmjet veprimtarive të shumta që kryejnë njerëzit, përfshihet edhe edukimi. *“Edukimi është veprimi që kryhet nga breznitë e rritura, ndaj atyre që nuk janë pjekur ende për jetën shoqërore. Ai ka për objekt të shkaktojë tek fëmijët një numër gjendjesh fizike, psikike, intelektuale e morale në përputhje me kërkesat e shoqërisë politike në përgjithësi dhe të mjedisit shoqërore në të cilin bën pjesë”.*¹¹

Edukimi i fëmijëve është veprimtari e vazhdueshme, ku ndërthuren faktorë të natyrës biologjike e psikologjike, sociale e pedagogjike. Fëmijët u nënshtrohen gjatë jetës së tyre, si ndikimeve të organizuara, ashtu edhe atyre spontane. Të gjithë aktorët pjesëmarrës në edukimin e tyre, si mësuesit apo prindërit e të gjithë ata që në mënyrë direkte dhe indirekte japin kontributin e tyre në edukimin e fëmijëve, janë të ndërgjegjshëm se gjatë procesit të edukimit të tyre ka situata të vështira me të cilat ata përballen. Përditë e më shumë po ndërgjegjësohen se këto situata duhen trajtuar me kujdes të madh, me qëllim që të ruhet klima pozitive e ndikimit mbi fëmijët. Gjithashtu, ata janë të ndërgjegjësuar se fëmijët

që shfaqin sjellje të papëlqyera, duhet të ndihmohen. Ne do të përiqemi të prezantojmë shkurt se cila është përmbajtja e konceptit të menaxhimit të sjelljeve të papëlqyeshme të fëmijëve, përdorimi dhe ushtrimi i dhunës nga të rriturit, si pasojë e mosnjohjes e mospërdorimit si e sa duhet të strategjive të menaxhimit të sjelljeve të papëlqyeshme të fëmijëve dhe në fund, do të japim disa strategji që mund të përdoren nga të gjithë aktorët e edukimit, për të menaxhuar sjelljet e papëlqyeshme të fëmijëve.

Ç’PËRMBAN NË VETVETE TERMI MENAXHIM I SJELLJES SË FËMIJËS?

Menaxhimi i sjelljes së fëmijës evidenton faktin e nevojës që kanë të rriturit për të bashkëvepruar dhe për të realizuar integrimin e të gjitha strategjive të mundshme të administrimit të sjelljes së fëmijëve, me qëllim që të arrijë të zgjedhë nga një mori strategjish, atë që është më e përshtatshme për t’u zbatuar gjatë procesit të edukimit. Pra, menaxhimi i sjelljes së papëlqyeshme të fëmijës, nënkupton trajtimin e saj në disa rrafshë, duke i bërë analiza të drejta problematikës së sjelljes negative.

1. Gaston Mialaret, Pedagogjia e përgjithshme, Tiranë, 1995, fq. 6.

I rëndësishëm në këtë proces, është kuptimi i thelbit të menaxhimit të sjelljes, trajtimi i problemeve që lidhen me sjelljen e fëmijës, ndihma për t'i mësuar fëmijët si të sillen në të ardhmen, etj.

Mospërdorimi nga të rriturit si e sa duhet i strategjive të menaxhimit të sjelljeve të papëlqyeshme, nxit dhunën psikologjike, nganjëherë edhe atë fizike të fëmijëve.

Në jetën e përditshme, mësuesit e prindërit duhet të jenë të përgatitur që në situata të tilla, kur fëmijët e tyre, p.sh., flasin me zë të lartë, largohen pa leje nga shtëpia apo shkolla, kryejnë detyra të tjera, në vend që të kryjnë ato që u ka dhënë mësuesi apo prindi, bisedat jashtë temës së punës në grup etj., të ndërhyjnë shpejt, me qëllim që të rivendosin marrëdhënie normale në klasë apo në shtëpi, që aktiviteti të vazhdojë normalisht. Po të mos u kushtojmë që në fillim kujdes këtyre sjelljeve, mund të përhapen më tepër ose mund të rrezikojnë prishjen e procesit të edukimit të fëmijëve të përfshirë në këto lloj sjelljesh. Mësuesit dhe prindërit duhet të dinë edhe t'i parandalojnë ato, bile kjo është shumë e rëndësishme. Në të dy rastet duhet të minimizohen efektet anësore negative.

Mosmenaxhimi si e sa duhet nga të rriturit i këtyre sjelljeve, i bën ata të përdorin *dhunën fizike*, p.sh., një shpullë të lehtë, shkuljen e flokëve, etj., dhe atë *psikologjike*, që është më prezente në jetën tonë të përditshme.

Ç'është ndëshkimi? Ndëshkimi është një veprim (dënim), që merret ndaj një personi, i cili ka shkelur një rregull apo shfaq një sjellje të papëlqyeshme. Ndëshkimi synon të kontrollojë sjelljen përmes mjeteve negative. Dy janë llojet e ndëshkimeve që përdoren kundër fëmijëve:

1. Ndëshkim që bëhet përmes qortimeve dhe mosaprovimeve verbale negative; ky tip ndëshkimi njihet si disiplina negative.

2. Ndëshkim që bëhet duke shkakuar dhembje emocionale apo fizike, si në rastin e ndëshkimit fizik.

Fatkeqësisht, të dy këto forma ndëshkimi përqendrohen te sjellja jo e mirë dhe efekti i tyre është i vogël, duke mos e ndihmuar fëmijën të sillet më mirë në të ardhmen. Përveç kësaj, fëmija mëson se i rrituri është superior, se ushtrimi i forcës, qoftë verbale, fizike apo emocionale, është i pranueshëm, veçanërisht mbi më të vegjlit dhe personat më të dobët. Ky mësim mund të çojë në incidente zënkash dhe dhune në shkollë, shtëpi apo rrugë, ku më të rriturit sundojnë mbi më të vegjlit dhe i detyrojnë ata t'u japin para, ushqime, detyrat ose gjëra të tjera me vlerë.

Përveç kësaj, në vend që ta pajisë fëmijën me aftësinë e vetëkontrollit, një ndëshkim i tillë e bën inatçi, e fyen dhe e frikëson. Ai i shkakton, gjithashtu, ndjenjën e turpit,

fajit, ankthit, agresivitetit të lartë, mungesë pavarësie dhe mungesë kujdesi ndaj të tjerëve, duke u hapur kështu telashe prindërve e mësuesve, kujdestarëve dhe fëmijëve të tjerë.

Shumica dërmuese e të intervistuarve mendojnë se është më shumë i pranueshëm përdorimi i dhunës psikologjike, sesa i dhunës fizike, qoftë në shtëpi apo në shkollë. Forma e dhunës psikologjike, që tolerohet thuajse në mënyrë totale nga të gjithë të intervistuarit, ishte e bërtitura. Koncepti se fëmija nuk mëson dhe nuk ndryshon sjelljen, po nuk i bërtite, është i përhapur tek fëmijët. Në një masë të konsiderueshme, toleranca më e madhe për përdorimin e dhunës psikologjike, duket se lidhet me faktin se dhuna psikologjike nuk ka efekte imediate të natyrës fizike, siç mund të ketë p.sh., goditja e fëmijës. Fëmijët preferojnë shpesh të bërtiturat, për arsye se, sipas tyre, kjo nuk u shkakton dhimbje.

Në përgjithësi, prindërit dhe, diçka më shumë mësuesit, janë të vetëdijshëm për ndikimet dhe pasojat e dhunës, por më të ndjeshëm në këtë aspekt janë vetë fëmijët. Megjithatë, duket se informacioni për efektet negative të dhunës fizike dhe psikologjike është jospesifik. Ajo që prindërit dinë, është më tepër rrjedhojë e asaj që kanë nxjerrë nga përvojat individuale me fëmijët e tyre. Prindërit priren të vënë në dukje më shumë efektet imediate të dhunës fizike, si gjakosjen, etj. dhe më rrallë efektet afatgjata të dhunës në personalitetin e fëmijës së dhunuar.

Të intervistuarit shprehën se format më të përhapura të dhunës psikologjike në shkollë e jashtë saj, janë bërtitja, kërcënimi me thirrjen e prindit, kërcënimi me fjalë, nofkat dhe epitetet fyese, kërcënimi për nxjerrje nga mësimi, mëria, kërcënimi me denoncim, kërcënimi me rrahje, kërcënimi me objekt, kërcënimi me notë, kërcënimi me përjashtim nga shkolla ose me humbje të ndryshme privilegji etj. Por tashmë, opinioni i të gjithë studiuesve lidhur me këtë problem, është se përdorimi i dhunës lë pasojat e veta psikike si:

- Prekjen në nivelin e përgjithshëm të funksionimit emocional të fëmijëve. Këtu bëhet fjalë për kultivimin e frikës, kultivimin dhe zhvillimin e ndjenjave të fajit dhe të turpit, kultivimin dhe zhvillimin e ndjenjave të pakënaqësisë, vetmisë, nxitet pesimizmi, inferioriteti, vetmia, ndrojtja, nervozizmi, humbja e besimit në vetvete etj.

- Prekjen në mundësinë e zhvillimit të fëmijëve. Këtu bëhet fjalë për humbjen e aftësive psikike, si atë të vëmendjes, të kujtesës, të aftësive për t'u shoqëruar me të tjerët, të aftësisë për pavarësi dhe iniciativë etj.

- Kultivimi tek fëmijët i sjelljes së dhunshme dhe përvetësimi prej tyre i këtij modeli të sjelljes së dhunshme,



psh., mësuesit me përvojë ndër të tjera, kishin vënë re se sjelljet e dhunshme të fëmijëve të tyre janë shumë të ngjashme me sjelljet e dhunshme që prindërit e tyre kanë përdorur ndaj fëmijëve.

CILAT JANË DISA STRATEGJI QË MUND TË PËRDOREN PËR MENAXHIMIN E SJELLJEVE TË PAPËLQYESHME TË FËMIJËVE?

Këtë ide do ta materializojmë në ambientin e klasës, si ambienti që mund të shfaqen sjellje pozitive e negative të llojeve të ndryshme e mësuesi me përvojën e vet duhet t'i zgjidhë ato. Edhe nga prindërit mund të aplikohen këto strategji, në përshtatje me kontekstin në të cilën ndodh situata.

Të gjithë e dimë që klasa është vendi ku, krahas sjelljeve pozitive, shfaqet një shumëllojshmëri sjelljesh negative, të cilat mësuesi i përballon nëpërmjet përdorimit të strategjive të përshtatshme për menaxhimin e tyre. Njohja e disa strategjive menaxhuese të sjelljes së fëmijëve nga ana e mësuesit, është një veprim i suksesshëm, se e lejon atë që, kur strategjia e parë nuk funksionon, të përdorë një strategji të dytë, që të jetë e suksesshme në menaxhimin e klasës. Nga ana tjetër, njohja e strategjive administruese për sjelljen e fëmijëve në shkollë, i krijon mundësi mësuesit të marrë masa parandaluese për këto dukuri negative të fëmijëve, kështu, ai mund t'i përshtatet më mirë situatës, duke mënjeluar në maksimum ndërprerjen e procesit mësimor dhe duke rritur në këtë mënyrë kohën efektive të pjesëmarrjes së fëmijëve në procesin e mësimdhënies. Prandaj, është e dobishme për mësuesin të njohë strategji të ndryshme menaxhuese, me qëllim që të jetë i aftë t'i zbatojë ato në situata të veçanta. Disa nga strategjitë që rekomandojmë të përdoren gjatë punës së mësuesit, janë ato të grupit të ndërhyrjeve të vogla, që kërkojnë një harxhim të paktë të kohës nga ana e mësuesit dhe janë relativisht imponuese ndaj sjelljes negative të nxënësit. Ato mund ta ridrejtojnë sjelljen negative të nxënësit. Në të kundërt, kur situata nuk zgjidhet duke përdorur grupin e ndërhyrjeve të vogla, mësuesi duhet të manovrojë duke përdorur grupet e tjera të strategjive të menaxhimit të sjelljeve të papëlqyeshme. Strategjitë e menaxhimit të sjelljes mund të grupohen si më poshtë:

1. Ndërhyrjet e vogla, ku përfshihen strategji të tilla si:

Sugjerimet joverbale, ku mësuesi me një shenjë i kërkon nxënësit ndërprerjen e një sjelljeje të papëlqyeshme.

Vlerësimi i veprimtarive në klasë, kërkon që mësuesi të planifikojë mirë çdo veprimtari mësimore, me qëllim që

nxënësit të mos kenë hapësira boshe, për ndryshe, kur ai vëren lëvizje të nxënësve, nuk duhet të ndalojë, por të kalojë në veprimtarinë tjetër.

Afërsia, ku mësuesi me afrimin shumë afër nxënësit, i cili shfaq sjellje jo të pëlqyeshme, kombinon afërsinë me sugjerimet joverbale.

Përdorimin e përqendrimit në grup, mësuesi paralajmëron grupin, me qëllim që t'i kthejë nxënësit në punën e dhënë.

Ridrejtimin e sjelljes, në këtë rast mësuesi u kujton nxënësve se çfarë duhet të bëjnë.

Përcaktimi i udhëzimeve të nevojshme nga mësuesi përdoret në ato raste, kur nxënësit nuk e kanë kuptuar detyrën, ndërprerjet e shkurtra ndodhin në ato raste, kur sjellja e papëlqyeshme ka përfshirë klasën e mësuesi kërkon me ngulm kërkesën e tij.

Përdorimi i mesazhit "unë", etj.

2. Ndërhyrjet e moderuara kanë të bëjnë me zbatimin e një ndëshkimi të lehtë ose të një ndëshkimi me pak pasoja negative, me qëllim ndalimin e sjelljeve problematike të fëmijëve. Ky grup ka shumë mundësi të nxisë rezistencën e fëmijëve. Në këtë grup përfshihen strategji të tilla, si: *Ruajtja e një privilegj ose një aktiviteti të dëshiruar, izolimi ose ndryshimi i vendit, përdorimi i një dënimi, etj.*

3. Grupi i ndërhyrjeve më të gjera, përfshin strategji të tilla, si: *marrëveshje individuale me fëmijën, konsulta me prindërit, përdorimi i paralajmërimit, raportimi i sjelljeve të papëlqyera etj.* Ky grup strategjish përdoret, kur sjellja e nxënësit nuk mund të përmirësohet duke përdorur strategji nga dy grupet e para.

KONKLUZION:

Njohja e disa strategjive menaxhuese të sjelljes së fëmijës, është një veprim i suksesshëm sepse:

- Lejon mësuesit e prindërit të marrin masa parandaluese për dukuritë negative.
- Mësuesit dhe prindërit i përshtaten më mirë situatës dhe dalin më lehtë nga ajo.
- Mësuesit dhe prindërit mënjanojnë në maksimum ndërprerjen e aktiviteteve të ndryshme.
- Përdorimi i strategjive të përshtatshme lejon rritjen e kohës efektive të pjesëmarrjes së fëmijëve në aktivitet.
- Në të gjitha rastet mund të shmangët përdorimi i dhunës nga mësuesi e prindërit, nëse ai zgjedh drejt strategjitë dhe i menaxhon mirë ato.



Esma-i Husna

Dr. Metin Jurdagyr

“Allahut i përkasin emrat më të bukur, andaj thirreni Atë (lutjuni Atij) me to dhe largohuni nga ata që i shtrembërojnë emrat e Tij”. (el-A'raf, 180)

Ata të cilët kanë humbur rrugën e drejtë, në jetën e përditshme e harrojnë Allahun, por kur bien në vështirësi detyrohen të pranojnë ekzistencën e Tij dhe për fat të keq, këtë e bëjnë duke e përmendur Atë me emra dhe cilësi që nuk kanë kuptim. Prandaj, qëllimi i përmendjes së Allahut me shumë emra dhe cilësi në Kuranin Kerim është korrigjimi i këtyre gabimeve. Gjithashtu me anë të kësaj synohet mbjellja e filzave të trëndafilave të teuhidit në vend të barishteve të këqija të shirkut që kanë mbirë dhe kanë zënë vend si rrjetë merimange në themelet e besimit.

Besimi lind në zemër dhe pasi mbështjell me gradën e vërtetësisë të gjithë qenien tonë, drejtohet për në qëllime të rëndësishme si **besnikëria** dhe **sinqeriteti**. Nëse besimi arrin gradën e vërtetësisë, zotëron këto dy cilësi dhe identifikohet me to, atëherë bëhet shprehja e një deklaratë të sinqertë të pranimit të të vërtetave të cilat nuk pranojnë asnjë lloj diskutimi dhe larg çdo lloj dyshimi e ngurrimi. Pasi njerëzimi të zotërojë një besim të tillë, do të fillojë të kryejë detyrat që ka kundrejt Allahut dhe njerëzimit. Me kalimin e kohës, njeriu mëson se si t'i kryejë me devotshmëri detyrat ndaj Allahut. Mëson të jetë i moralshëm dhe besnik në marrëdhëniet me njerëzit e tjerë. Gjithashtu mëson edhe sjelljen ndaj egos së vet duke qenë gjithmonë në opozitë ndaj epsheve dhe dëshirave të tepërta. Më në fund do të kuptojë se të gjitha këto bëhen të mundura vetëm duke e lidhur zemrën me Zotin e botëve, i Cili është më afër nesh se sa damari i qafës.¹ Pra me një fjalë, do të fillojë të jetë një rob i vërtetë i Allahut. Mirëpo, nevojat e njeriut nuk kanë mbaruar. Në çdo moment ka nevojë për ndihmë. Ai gjithmonë duhet të jetë i vetëdijshëm se ndodhet nën vëzhgim dhe se një ditë do të japë llogari për gjithçka. Çelësi shpirtëror i cili do t'ia hapë dyert e këtij vetëdijesimi është “Besmeleja”.

Të gjitha punët tona duhet t'i fillojmë me Besmele, pra duke përmendur emrin e Zotit tonë të Plotfuqishëm. Këtë na e vërteton edhe profeti ynë (a.s.), kur thotë:

“Punët që fillojnë pa u përmendur emri i Allahut, nuk kanë fund.” (IbënMaxhe, Sunen, 1.610, hadithi no:1894)

Nën dritën e ajeteve kuranore dhe haditheve fisnike kuptojmë se janë përmbushjes së detyrave kundrejt Alla-

hut dhe njerëzimit, njeriu duhet ta ndjejë veten të obliguar që të përmendi emrin e Zotit.

Kur njeriu të përmendi emrin e Zotit në çdo punë të mirë, do të fitojë nderin e që qenit gjithmonë në lidhje të drejtpërdrejtë me Të. Përkrah Besmelesë, Allahu ka edhe shumë emra të tjerë me të cilët mund ta përmendin ata që duan lumturinë e botës tjetër. Këto emra njihen si “Esmau'lHusna” ose “Esma-i Husna”. Këto emra janë treguar për t'i kujtuar njerëzve të cilët janë larguar nga e vërteta e teuhidit dhe që adhurojnë idhuj që nuk kanë as nam e nishan, se Zotit të botëve, Allahut të Gjithëpushtetshëm i takojnë emrat më të bukur. Është e mundur që këto emra t'i konsiderojmë si çelësa shpirtërore që mund të hapin dyert e kyçura të zemrës njerëzore të cilat janë të mbyllura ndaj bukurive dhe mirësive të shpirtit njerëzor. Kjo, për arsye se si do që të jetë puna, njeriu gjithmonë ka nevojë për “esmau'l-Husna” të cilët i tregojnë për atributet e Allahut Teala, sepse në raste të ndryshme njeriu dëshiron t'i lutet Allahut të Madhëruar me njërin nga emrat apo cilësitë, kuptimi i së cilës përkon me problemin e tij. Ja pra, në këtë moment, këto emra bëhen një urë lidhëse midis botës hyjnore që nuk mund të konceptohet nga mendja njerëzore dhe botës ku njeriu jeton.

Nga ana tjetër, përmendja dhe mësimi i këtyre emrave me kuptimin e tyre, të forcon besimin, të bën të ndjesh qetësinë hyjnore, të bën të mos u japësh rëndësi fatkeqësive dhe të ulin hidhërimin që mund të ndihet gjatë humbjes së diçkaje nga kjo botë e vdekshme. Mbi të gjitha, xhenneti është premtuar si shpërblim për përmendjen e këtyre emrave duke e ndërë thellë në shpirt edhe kuptimin e tyre. Çdo njëri prej këtyre emrave është një eliksir më vete dhe një recetë shpëtimi. Kurimi i sëmundjeve që vrasin zemrat dhe të gjitha sëmundjeve shpirtërore me burim tek shirkut, është i mundur me përmendjen e shpeshtë dhe të vetëdijshme të këtyre emrave.

1.Kaf, 16

Ajetet dhe Suret e Kuranit

Ma. Gilman Kazazi

Kurani ndahet në sure; surja ndahet në ajete. Por çdo të thotë fjala "ajet" dhe "sure"? Sa është nr. i ajeteve dhe i sureve në Kuran? Cili është ajeti dhe surja më e gjatë dhe më e shkurtër e Kuranit?

KUPTIM I FJALËS "AJET".

Fjala "ajet" në kuptimin gjuhësor do të thotë shenjë, veçori dalluese, mrekulli, argument dhe mësim. Në terminologjinë fetare, fjala *ajet* do të thotë: "Njësi e sures, e përbërë nga dy shkronja, një fjalë ose nga një apo disa fjali.

Lidhja mes kuptimit gjuhësor dhe fetar ekziston në faktin se ajeti, kjo pjesë e sures, është mrekulli dhe argument për vërtetësinë e atij që i janë shpallur. Argument për vërtetësinë e Profetit Muhamed. Në këto pjesë të sureve ka mësim dhe argumente për ata që mendojnë dhe kërkojnë udhëzimin hyjnor.¹

KUPTIM I FJALËS SURE

Fjala *sure* në kuptimin gjuhësor, do të thotë: gardh, mur rrethues, pozitë e lartë. Në aspektin fetar, fjala *sure* ka kuptimin: "Pjesë e Kuranit, e cila përmbledh disa ajete."²

Lidhja mes kuptimit gjuhësor dhe fetar qëndron në faktin se, ashtu siç rrethohet shtëpia me murin e saj, rrethohen ajetet me suret e tyre. Ashtu siç përmbledh gardhi hapësirën rrethuese të tij edhe surja përmbledh ajetet e saj. Meqenëse çdo pjesë e Kuranit ka një pozitë të lartë tek Allahu dhe lexuesi fiton pozitë tek Allahu, kjo pjesë kuranore ka marrë emrin *sure*.³

Kurani përmban 114 sure dhe 6236 ajete. Ajetet dhe suret mund të jenë të gjata ose të shkurtra dhe zakonisht suret e gjata kanë ajete më të gjata, kurse suret e shkurtra kanë ajete të shkurtra.

Ajeti më i gjatë i Kuranit është ajeti 282 i sures el-Bekare.

1. el-Med-hal lidirasetil-Kuran, Muhamed Ebu Shuhbeh, Kairo 1922, fq, 278.

2. Po aty, fq, 285.

3. Ulumul-Kuranil-Kerim, Dr. Nurudin Itr, Damask, 1996, fq, 40-45.

Ky ajet quhet: "Ajeti i Borxhit", sepse përmban dispozitat e borxhit në Islam. Ky ajet përmban 182 fjalë. Ajeti më i shkurtër është: "Taha" dhe "Jasin". Fjala: "Mud-hammetan", në suren er-Rahman, është i vetmi ajet (ajeti 64) që përmban një fjalë të vetme të plotë.⁴

Ajeti më i madhërueshm është ajeti Kursij, ajeti 255 i sures el-Bekare. Ky ajet ka 50 fjalë, 185 shkronja dhe në të përmenden pesë emrat e bukur të Allahut: *Allah*, *el-Hajj* (I Gjalli), *el-Kaj-jum* (I Përrjetshmi), *el-Alij-j* (I Larti) dhe *el-Adhim* (I Madhi).

Ubej ibn Kab transmeton se Profeti e ka pyetur: "O Eba Mundhir, a e di cili është ajeti më i madh që ke mësuar?" I thashë: "Allahu lailahe il-la huvel-hajul-kajum." Profeti më goditi në gjoks dhe më tha: "Të lumtë dituria që ke, o Eba Mundhir." (Muslim)

Surja më e gjatë e Kuranit është surja el-Bekare, e cila përmban 286 ajete. Surja më e shkurtër është surja el-Keuther me tre ajete. Tri sure kuranore përfundojnë sipas emrave të tyre: El-Maun, El-Mesed dhe En-Nas. Pesë sure të Kuranit bartin emra, sipas emrave të të Dërguarve: Junus, Hud, Jusuf, Ibrahim, Muhamed. Gjashtë sure në Kuran bartin emra sipas gjallesave: el-Bekare (Lopa), en-Neml (Milingonat), el-Fil (Elefantët), en-Nahl (Bleta), el-Ankebut (Merimanga). Sureja el-Ihlas është e barabartë me një të tretën e Kuranit. Surja el-Muxhadele është e vetmja sure, ku në çdo ajet përmendet Allahu. Surja et-Teube është e vetmja sure, në fillimin e së cilës nuk ka bismillah. Surja en-Neml është surja me dy besmele, njëra në fillim, ndërsa tjetra në ajetin 30.

Surja më e madhërueshme është surja el-Fatiha, surja e parë e Kuranit.

"Ebu Seid ibnul-Muala thotë: "Kam qenë duke u falur në xhami, kur më thirri Profeti, por unë nuk iu përgjigja."

4. el-Med-hal lidirasetil-Kuran, Muhamed Ebu Shuhbeh, fq, 279.

I thashë: "O Dërguari i Allahut, isha duke u falur." Profeti më tha: "A nuk thotë Allahu: "Përgjigjuni Allahut dhe Profetit të Tij, kur t'ju thërrasin?" Pastaj më tha: "Para se të dalësh nga xhamia, do të ta mësoj një sure që është më e madhja sure e Kuranit"- dhe më mori për dore. Kur deshi të dilja nga xhamia, i thashë: "A nuk më the se do të ma mësosh suren më të madhe të Kuranit?" Tha: "Elhamdulilahi rabul-alemin ..." (el-Buhariu)

Emërtimi i sureve është transmetuar dhe dëgjuar nga Profeti Muhamed dhe sahabët e tij. Surja mund të ketë një emër të vetëm, si p.sh. surja en-Nisa, Merjem, Taha etj., por, ka sure që quhen me më shumë se një emër, si p.sh. surja el-Fatiha. Surja el-Fatiha quhet ndryshe edhe: Fatihatul-Kitab, Umul-Kuran, Umul-Kitab, es-Seb'ul Methani etj.⁵

Për nga gjatësia, suret klasifikohen në katër lloje:

1. *et-Tival*: në këtë klasifikim përfshihen 7 sure, el-Bekara, Ali Imran, en-Nisa, el-Maide, el-Enam, el-A'raf, el-Enfal. 2. *el-Miun*: quhen të gjitha ato sure që kanë më shumë se 100 ajete. 3. *el-Methani*: emërtohen të gjitha ato sure që kanë përafërsisht 100 ajete. 4. *el-Mufessal*: përfshihen suret relativisht të shkurtra deri në fund të Kuranit. Ky klasifikim i fundit fillon që nga surja el-Huxhurat.⁶

Radhitja e ajeteve dhe e sureve në Kuran, është bërë nga ana e Allahut. Sahabët kanë pasuar udhëzimin e Pejgamberit dhe Pejgamberi ndiqte urdhrin e Allahut, nëpërmjet Xhebrailit. Xhebraili e urdhëronte Pejgamberin të vendoste filan ajet në filan sure. Nuk ka ndërhyrje nga sahabët apo dikush tjetër në renditjen e ajeteve apo sureve të Kuranit.⁷

AJETET E PARA TË SHPALLURA NGA KURANI

Profeti Muhamed (a.s.), u urdhërua: "Lexo i ndihmuar prej Zotit, që krijoi çdo qenie në ekzistencë. Krijoi njeriun nga gjaku i ngjizur. Lexo se Zoti yt është më bujari. Ai e mësoi njeriun të shkruajë me pendë. Ai i mësoi njeriut atë që nuk e dinte..." Këto janë 5 ajetet e para të sures el-Alek, pjesa e parë që filloi t'i shpallej Muhamedit (a.s.), nga Kurani, kur gjendej në shpellën Hira.

Nuk është rastësi që në ajetet e para të përmendet *leximi dhe lapsi*, të cilët janë simbole të diturisë. Kurani është e vetmja shpallje hyjnore, që ka filluar me urdhrin "Lexo!". Këtij urdhri mund t'i kishin paraprirë urdhra të tjerë. Ymeti jonë është quajtur "Ymeti Lexo". Dhe nuk është vetëm syri, që lexon. Mendja, zemra, shpirti, gjuha dhe veshi të gjitha lexojnë, por në mënyra të ndryshme.

5. Po aty, fq: 288-289.

6. Po aty, fq: 291.

7. Shih: Ulumul-Kuranil-Kerim, Dr. Nurudin Itr, fq: 40-45. M - bahith fi ulumul-Kuran, Dr. Subhi Salih, Bejrut, 1988, fq: 70-73.

Gjithashtu, nuk është vetëm libri objekti i vetëm që duhet lexuar. Gjithësia, sendet, ngjarjet dhe vetë njeriu, të gjitha këto mund të lexohen.⁸

Me anë të leximit të dobishëm, koha shfrytëzohet, kultura zgjerohet, njohuria shtohet, perceptimi i çështjeve shpejtohet, mendja pasurohet dhe besimi forcohet. Leximi është çelësi i diturisë dhe metoda më efektive për të përvetësuar dituri.

Urtësia e Allahut ka dashur që lukthi i njeriut të jetë i kufizuar, nëse ushqehet tepër shkakton dëm. E kundërta me mendjen, sa më shumë ta ushqejmë me lexim, aq më mirë na bën. Leximi nuk ka moshë, nuk del njeriu në pension nga leximi. Nëse arrijmë ta bëjmë leximin educate, bëhet si buka dhe uji. Ashtu siç nuk mund ta kalosh ditën pa ushqim, të duket ditë e mangët ajo ditë pa lexim. Uria dhe etja mendore shuhet me lexim dhe studim. Është fatkeqësi që sot njerëzit, sidomos ata që janë të papunë, e kalojnë kohën e lirë duke parë telenovela ose nëpër lokale dhe jo duke lexuar ndonjë libër. *Argëtimi më i bukur për njeriun, është leximi dhe shoku më i mirë është libri.*⁹

Një dijetari mysliman i thanë: "Me kë shoqërohesh?" U ra librave dhe tha: "Me këta." I thanë: "Prej njerëzve?" Tha: "Me autorët e tyre."

I pyetën disa nxënës të dijës: "A nuk ndiheni të vetmuar duke lexuar gjithë kohën?" Thanë: "A ndihet i vetmuar ai, që kokat e njerëzimit janë me të!" "Cilët?" - i thanë. "Librat" - u përgjigjën.

AJETI I FUNDIT I ZBITUR NGA KURANI

Ajeti i fundit i zbitur nga Kurani, është ajeti 281 i sures el-Bekare, ku thuhet:

"Dhe ruajuni një ditë, kur të ktheheni tek Allahu, dhe secilit njeri i jepet ajo që ka fituar dhe, atyre nuk u bëhet padrejtësi." Mbas këtij ajeti, Profeti Muhamed (a.s.), ka jetuar edhe 9 ditë.¹⁰

"Dhe ruajuni një ditë, kur të ktheheni tek Allahu", ka kuptimin, kini frikë atë ditë, ditën e gjykimit.

"... dhe secilit njeri i jepet ajo që ka fituar", shpërblimi ose dënimi do të jepet në bazë të asaj që kemi punuar në këtë botë.

Mesazhet që përfitojmë nga ajetet e para dhe ajeti i fundit janë të shumta, por ai më i qarti dhe direkti, është domosdoshmëria e të lexuarit dhe frika ndaj Allahut. Nga ku kuptohet lidhja mes diturisë dhe devotshmërisë. Ajo dituri që nuk të nxit nga devotshmëria, nuk ka vlerë tek Allahu. Qëllimi i diturisë është arritja e mirësisë dhe drejtësisë për njeriun. Dituria nuk ka dobi, nëse nuk sjell rezultate të vlefshme në praktikë.

8. Shih: Këshilla drejt shoqërisë së virtytshme, Mustafa I - lamugllu, Shkup, 2011, fq: 56.

9. Filozofia e jetës, Xhetan Strazimiri, Tiranë, 2011, fq: 142.

10. Ulumul-Kuranil-Kerim, Dr. Nurudin Itr, fq: 36.

Kryengritja e patrona Halilit

Pas serialit "Sulejmani i Madhërishëm", në televizionin shtetëror turk ka nisur të shfaqet një serial i ri me titull "Kryengritja Osmane", e cila trajton Stambollin e fillimit të shek. XVIII dhe ngjarjen që tronditi atë periudhë zembrën e perandorisë, kryengritja e patrona Halilit. Normale është që në këta lloj filmash me temë historike, të përzihen ngjarjet reale me ngjarje fiktive, që krijohen nga skenaristët e filmave për të bërë më të fortë intrigën e filmit. Prandaj, në këtë artikull do të flitet në lidhje me këtë kryengritje, në versionin e njohur nga burimet historike.

Kryengritja e vitit 1730, u quajt kryengritja e patrona Halilit, me emrin e drejtuesit të kryengritjes. Patrona është një term ushtarak në gjuhën osmane. Kështu quheshin kapitenët e rangut të dytë në flotën osmane.

Kryengritja e vitit 1730 vinte si reagim i një sërë zhvillimesh të reja politike, ekonomike dhe shoqërore brenda shtetit osman, pas marrëveshjes së Pazarofcit, të vitit 1718. Politika pro gjendjes së paqes, që ndiqte sadrazami Ibrahim pasha Nevshahirasi (Damati), në mënyrë të veçantë pas humbjeve të rënda që kishte pësuar shteti osman përpara perandorisë Austriake, si rezultat i të cilave kishte pranuar një paqe me kosto për shtetin, binte në kundërshtim me hierarkinë ushtarake osmane, e cila ishte pro luftës tashmë me argumentin për të rifituar ato që ishin humbur në luftë. Gjithashtu, humbja e qyteteve të rëndësishme, si Beogradi dhe Tamishoara, lufta e nisur me Iranin, që po zhvillohej në dëm të perandorisë, qenë shkak i pakënaqësisë së shfaqur në shtresat e ndryshme të shoqërisë osmane. Nga ana tjetër, gjendja financiare e shtetit osman nuk ishte aspak e mirë.

Problemet financiare, si rezultat i luftërave të humbura, taksat e ndihmës ushtarake, që në fillim ishte vetëm një taksë e limituar, gjatë kohës së luftës, më pas u shndërrua në taksë të përhershme. Kalimi i të ardhurave fikse (mukataat) për buxhetin e shtetit nga taksa disavjetore në taksa të përhershme për tagrambledhësit, bënë që gjendja financiare të rëndohej edhe më shumë për klasën prodhuese.

Përballë këtij realiteti, gjendej realiteti tjetër i kundërt. Shpenzimet e mëdha të klasës drejtuese osmane, duke filluar që nga sadrazami. Kjo krijoi një hendek të madh ekonomik në shoqërinë osmane. Ndërkohë, në shekullin XVII, në shtetin osman përjetohej një emigrim i madh brenda për brenda shtetit, gjë e cila çonte nga një anë në zbrazjen e fshatrave, që shoqërohej me rënien e prodhimit dhe me uljen e të ardhurave. Numër të madh përbënin

të ardhurit nga Anadulli dhe nga Rumeli, në kryeqytetin e shtetit osman Stambollit, në kërkim të një jete më të mirë.

Ajo që në historinë osmane njihet si Periudha e Tulipanit (Lale Devri), kishte sjellë të reja në jetën shoqërore osmane, siç ishin krijimi i shtypshkronjës së parë zyrtare, gjatë detyrës si sadrazam të Ibrahim Pashës (Damat), formimi i një komisioni, me qëllim përkthimin e veprave më të rëndësishme nga gjuhët e lindjes dhe të perëndimit, shtimi i numrit të bibliotekave, krijimi i fabrikave së letrës dhe të stofit, formimi i një institucioni të ngjashëm me zjarrfikësen në ditët e sotme, nuk kishin bërë përshtypje tek masat e gjera të popullit.

Masave u bënë më shumë përshtypje kënaqësitë, sarajet e parisë osmane të ndërtuara sipas arkitekturës franceze, si dhe shpenzimet e mëdha që bënë ata për një jetë sa më të gjallë dhe plot luks. Rrethet fetare ndjeheshin të indinjua që jeta e luksit të vazhdonte madje edhe gjatë muajit të Ramazanit. Në mënyrë të veçantë, jeta argëtuese e grave dhe moda e rrobave të reja të tyre, që binin në kundërshtim me kulturën tradicionale, konsideroheshin si risi, për të cilat përgjegjës ishte sadrazami Ibrahim pasha.

Situata politike nuk ishte aspak e mirë, pasi shumë persona ndjeheshin të mënjanuar nga sadrazami dhe e akuzonin atë se postet e shtetit po i mbushte me të afërmit dhe përkrahësit e tij. Por edhe brenda rrethit të sadrazamit gjendja nuk ishte e mirë. Dy dhëndurrët e tij, Mustafa pasha, zëvendëskryeadmirali i flotës osmane dhe Mehmet pasha, kethyda e kryeministrit, ishin në garë politike mes tyre. Pas ngritjes në detyrë si kryeadmiral, Mustafa pasha projektoi një komplot të brendshëm kundër sadrazamit Damati Ibrahim pasha dhe favoritit të tij Mehmet pashës. Për të realizuar planin e tij, Mustafa pasha përzgjodhi patrona Halilin.

Për shkak të rëndësisë që pati ngjarja, burimet tregimtare historike osmane japin detaje në lidhje me figurën e patrona Halilit. Halili qe shqiptar nga Hurrpishi (lokaliteti i Korçës) dhe qe një jeniçer i mesëm i bylykut të 17, të oxhakut të jeniçerëve. Deri atëherë, patrona Halili qe përzier në disa ngjarje të errëta, kishte marrë pjesë në kryengritjet e Nishit dhe të Vidinit, kishte shpëtuar dy herë nga dënimi me vdekje (në sajë të Mustafa pashës) dhe njihej si njeri orator. Pas ardhjes në Stamboll, ai ishte marrë në fillim si shitës ambulant dhe më pas, si dollak në hamamet e kryeqytetit, me ç'rast kishte njohuri për

intrigat dhe gjërat e fshehta, të cilat i dëgjonte gjatë bashkëbisedimeve të ushtarakëve apo pushtetarëve, që vinin në hamam për tu larë. Së bashku me të, u bënë edhe vaizi i Shën Sofisë, Ahmet efendi Ispiri, kadiu i Stambollit Zylali Hasan efendi, Muslu Beshe nga Ruscuku dhe Ali Emir kahvexhiu. Të gjithë këta u bënë bashkë, falë edhe mbështetjes së Mustafa pashës dhe hartuan një plan për rrëzimin e sadrazamit.

Kryengritja e Stambollit nisi me datë 25 shtator 1730. Në fillim fare, kryengritësit përbëheshin nga shtresat e pakënaqura të shoqërisë, por më pas, me ta u bashkuan edhe jeniçerët. Kjo e bëri situatën edhe më të rëndë, pasi jeniçerët ruanin edhe rendin dhe sigurinë e Stambollit dhe të vetë sulltanit. Agai i jeniçerëve, Hasan aga, do të marshonte kundër kryengritësve, por ai dukej se e kishte nënvleftësuar situatën, përderisa kishte marrë me vete vetëm 300 vetë. Nga ana tjetër, Mustafa pasha ndiqte politikën e tij dyfytërshë: nga njëra anë takohej me udhëheqësit e kryengritjes, ndërsa nga ana tjetër mblidhej bashkë me sulltan Ahmedin III dhe i linte atij të kuptonte se situata nuk qetësohej pa u vrarë sadrazami dhe dhëndri i tij i vogël, Mehmet pasha.

Në mbledhjen e bërë me urdhrin e sulltanit, sadrazami kishte kërkuar të përdorej forca, por kjo kërkesë e tij nuk u miratua nga kazaskeri i Rumelisë, Abdullah efendi dhe nga motra e sulltanit, Hatixhe Sulltan. Kjo e përkeqësoi edhe më shumë situatën dhe tani, me kryengritësit u bashkuan edhe axhemi ogllanët dhe jeniçerët në rezervë. Numri i kryengritësve kapi shifrën katër mijë vetë.

Sadrazami damat Ibrahim pasha, e kishte kuptuar se organizatori i gjithë këtyre që ndodhnin ishte dhëndri i tij Mustafa pasha, prandaj kërkoi ekzekutimin e tij. Sulltan Ahmed III nuk e pranoi këtë gjë, por e shkarkoi Mustafa pashën nga detyra e lartë që kishte. Kryeadmirali i ri, dhëndri i sulltanit, Abdi pasha, u urdhërua që të bënte gati ushtarët e flotës kundër kryengritësve.

Ndërkohë që përgatitej t'i sulmonte kryengritësit, sulltani Ahmed III u ofronte atyre bashkëbisedime nëpërmjet të ngarkuarve që u dërgonte. I dërguari i sulltanit e njoftoi këtë për kërkesën e fundit që kishin kryengritësit. Ata i paraqisnin sulltanit një listë me emrat e tridhjetë e shtatë personave, mes të cilëve dhe të shejhulislamit dhe të kethyda Mehmed pashës, të cilët sulltani duhet t'u dorëzonte atyre.

Urdhri i sulltanit për t'u bashkuar nën flamurin perandorak, ra në veshë të shurdhër, populli i Stambollit ose nuk mori pjesë, ose u pengua të merrte pjesë nga ana e kryengritësve. Nga ana tjetër, dhëndri i sulltanit, Abdi pasha, i dërguar për të mobilizuar trupat ushtarake të flotës, u detyrua sa për sy e faqe të bëhej me kryengritësit, kur pa se edhe flota kishte ngritur krye kundër sulltanit. Përpara kësaj situatë, sulltan Ahmed III u detyrua të përmbushte kërkesën e kryengritësve. Me përjashtim të

ulemave, të cilët u nisën për syrgjynosje, figurat e tjera të shtetit osman, mes tyre sadrazam Ibrahim pasha dhe kethyda Mehmed pasha, u vendos t'u dërgoheshin kryengritësve. Këta kërkuan që të ekzekutoheshin dhe më pas kufomat e tyre t'u dërgoheshin kryengritësve. Sulltani e pranoi këtë gjë.

Por kërkesat e kryengritësve nuk mjaftuan me kaq. Së pari, ata kërkuan që sulltan Ahmed III të lëshonte fronin perandorak. I gjendur përpara një situatë pa zgjidhje, sulltani e pranoi këtë gjë, pasi mori garanci se nuk do të prekej as ai, as familja e tij dhe caktoi në vendin e tij nipin, Mahmudin, më 2 tetor 1730. Për herë të parë në historinë e shtetit osman, një person (patrona Halil), që kishte ngritur krye kundër sulltanit dhe e kishte detyruar atë të hiqte dorë nga froni, u prit me një pritje solemne nga sulltani i ri.

Por situata nuk do të përfundonte me kaq. Patrona Halil synonte të merrte në dorë pushtetin perandorak dhe të mbante nën kontroll sulltanin e ri. Kërkesat e kryengritësve për të emëruar në detyra të larta njerëzit e tyre, që nuk kishin asnjë cilësi të duhur për këtë gjë dhe duke sjellë përmbys traditën e strukturës hierarkike në shtetin osman, u ballafaqua me kundërshtimin e klasës drejtuese në shtetin osman. Nga ana tjetër, për dy javë me radhë kryengritësit kishin kryer një numër të madh aktesh të dhunshme që kishte paralizuar gjithë jetën ekonomike të kryeqytetit të perandorisë. Kërkesa për të regjistruar si jeniçer të gjithë kryengritësit, shkaktoi kundërshtimin e ashpër të jeniçerëve, të cilët ishin garantuesit e pushtetit qendror. Vrasja e një jeniçeri nga një kryengritës, e rriti edhe më shumë tensionin. Kështu, në situatën e re që u krijua, pakënaqësia e njerëzve të shtetit dhe e popullit të Stambollit ndaj kryengritjes, filloi të rritej dita-ditës.

Si brenda ashtu edhe jashtë sarajeve të sulltanit, nisën përgatitjet kundër kryengritësve. Agallarëve të jeniçerëve, që ishin kundër kryengritësve, iu dhanë nga pesë mijë monedha ari, në këmbim të shërbimit kundër kryengritjes. Në hierarkinë ushtarake dhe të sarajit u caktuan njerëz, që ishin kundër kryengritësve. Këta të fundit e kuptuan se tashmë situata po kthehej kundër tyre, prandaj filluan të kërkonin shpalljen e ndonjë fushate ushtarake, nëpërmjet së cilës do të arrinin të dilnin përjashta Stambollit dhe të arratiseshin. Pushteti qendror e konsideroi këtë një rast të mirë dhe u kërkoi një takim për të vendosur në lidhje me fillimin e një fushate të re. Kryetarëve të kryengritjes iu komunikua një takim me vetë sulltanin dhe sadrazamin, shpallja e një lufte të re kundër Iranit me këtë rast dhe dhënia e dekoratave.

Kur patrona Halili, Muslu Beshe, Mehmet aga Qerosi, Zylali Hasan efendi hynë tek dhoma e synetllëkut të shehzadeve brenda në sarajet e Topkapisë, u kapën dhe u vranë nga njerëzit e fshehur nën komandën e Halil aga Pehlivanit. Kështu mori fund edhe kryengritja e patrona Halilit.

Arti Islam

Arti islam është emri i përbashkët i të gjithë fushave të artit, që janë krijuar dhe zhvilluar në të gjitha shtetet islame, që me lindjen e Islamit gjer në ditët e sotme. Me përhapjen që bëri feja islame, fillimisht në Arabi, pastaj Egjipt, Siri, Mesopotami, Iran, Anadoll, Afrikë Veriore, Spanjë, Sicili, Kretë, Indi, Kinë etj., u krijua një art i ri me nuanca të ndryshme, i ndikuar nga raporti me artin që kishte zona dhe nga qasja transcendentë islame. Me nuanca të ndryshme, pasi të ndryshëm e bënte fakti i ndikimit që bënte tradita dhe kultura e zonës në të cilën zhvillohej, si dhe natyrshëm ky art ishte i ndikuar edhe nga qytetërimet e mëdha të kohës, si ai romak, pers, kinez etj.

Është më e vështirë të analizohet marrëdhënia art – fe, sesa marrëdhënia shkencë – fe apo etikë – fe, pasi shkencë kryesisht është *deskriptive*. Kurse etika është *normative*. Njëra merret me anën *konjitive*, kurse tjetra me atë *veprimore*. Kurse arti është më shumë një produkt *ndjesor* dhe *përfytyror* i njeriut.

Sot, kur bëhet fjalë për artin islam, për filozofinë e artit në Islam, nuk pranohet lehtësisht mundshmëria e një identiteti të mëvetshëm, të quajtur "arti islam". Kjo ndodh për një arsye shumë të rëndësishme:

Në kohën e Profetit Muhamed (a.s.), dominonte idhujtaria. Piktori dhe skulptori i kohës ishte vetëm një idhullbërës për politeistët e devotshëm dhe për të krishterët. Arti i pikurës dhe skulpturës ishte një profesion thuajse tërësisht, në shërbim të idhujtarëve. Ndaj, Profeti ndaloi bërjen e pikturave dhe skulpturave që paraqesin krijesat frymore të Zotit, pasi populli i sapokonvertuar në Islam, mund të mos kishte krijuar shkëputjen e duhur nga idolatrizmi i kaluar. Kështu, myslimanët për shekuj me radhë mbajtën një qëndrim ftohtë ndaj këtyre dy fushave të artit. Ata shpikën dhe zhvilluan arte të ndryshme alternative, siç janë arti i kaligrafië arabe, tez'hibi, qeramika, ebruja etj. Sidoqoftë, ky kujdes ndaj këtyre arteve në fjalë, që u ndaluan, bëri që nga radhët e myslimanëve të dilnin shumë pak numër historianë të artit islam. Ashtu sikurse shprehet edhe studiuesi turk Beshir Ajvazogllu (*Aşk Estetiği*, fq. 17), ata që paraqesin të dhënat kryesore rreth artit dhe estetikës islame, janë kryesisht orientalistët, gjë e cila krijon probleme të rëndësishme lidhur me strukturimin dhe shpjegimin e artit islam. Padyshim, kjo gjë është një tregues i krizës së botës islame në këtë pikë. Oksidentocentrizmi i përgjithshëm i orientalistëve, natyrshëm ka krijuar një barrierë që Perëndimi të mos njihet objektivisht

me llojet e ndryshme të artit në Islam. Shumica e historianëve të shkencave dhe të artit në Perëndim, mbajnë një qëndrim mjaft subjektiv ndaj kontributit të myslimanëve në shkencë dhe art dhe veçanërisht, ndaj mundshmërisë së një identiteti autentik të "shkencës islame", "filozofisë islame" apo "artit islam".

ESTETIKA ISLAME

Arti islam ka për qëllim t'i zbuqojë jetën njeriut. Çdo fe bën ndikimin e saj mbi artin, sipas doktrinave të saj. Përkundër artit antropomorfist grek dhe atij të krishterë, arti islam abstragon sipas parimit të besimit islam "*tavhid dhe tenzih*". Arti islam kundërshton idenë e "*artit për art*". Në artin islam dobia dhe estetika kanë të njëjtën vlerë.

Filozofia kryesore e artit islam është e vendosur mbi "*simbolizmin*" (temthil), ose me një shprehje tjetër, analogji. Veçoria kryesore e këtij arti, është zgjedhja e metodës përtej konkretes, abstragimi, pasi abstragimi në artin islam është një manifestim, që ka buruar nga parimi islam i tevhidit.

Sipas studiuesit turk të arteve, Turan Koç (Islam Estetigi,



Islam, Ist., 2008), arti islam bazohet mbi tre koncepte bazë islame: Tevhid, Ihsan dhe Kuran. Tevhidi, shprehja estetike e mesazhit. Ihsani, përmasa estetike e besimit dhe Kurani aorta e artit dhe estetikës islame.

Për t'u kuptuar, analizuar dhe vlerësuar veprimtaritë e artit islam, duhen pasur parasysh gjithmonë këto tre parime. Psikologjia e artistëve myslimanë, që punojnë të varur nga këto parime, padyshim është e ndryshme nga të tjerët.

Artisti mysliman beson se nuk ka *krijuar* të bukurën, por e ka *zbuluar* atë, si pasojë e cilësisë *Xhemal* të Zotit. Çdo lloj bukurie që ekziston, në një farë mënyre mund të preket, mund të shihet dhe mund të dëgjohet përmes punës së artistit.

Artisti mysliman beson se gjithçka që ekziston është e lidhur me Zotin, sepse Kurani thotë: **"Atë e madhërojnë shtatë qiejt, Toka dhe gjithçka gjendet në to. Dhe nuk ka asgjë që nuk e madhëron Atë"** (Isra, 44.) **"Allahu është Drita e qiejve dhe e Tokës."** (Nur, 35.)

Pra, detyra e artistit si një besimtar, nuk është vetëm shijimi i kënaqësisë estetike, por kryesorja është ndihmesa që u jep të tjerëve për të arritur tek e vërteta, duke i shpënë ata drejt *njësimit* (tevhid) dhe *ndriçimit* (nur).

PROVA ESTETIKE E EKZISTENCËS SË ZOTIT

Filozofët e fesë, kur shpjegojnë provën kozmologjike të ekzistencës së Zotit, shpeshherë i referohen edhe kërkimin kozmologjik të profetit Ibrahim (a.s.), i cili shpreh se kërkonte një qenie që *"nuk perëndonte"* dhe njëkohësisht që *"meritonte të dashurohej"*. Pra, këtu nuk mjaftohet ve-

tëm me kërkimin e një qenieje që mund të shprehet me termat *"e pafundme"*, *"infinite"*, *"e përjetshme"*, por në një farë mënyre, nis një rrugëtim estetik. Mund të themi që, nga teologjia natyrore, kalohet në teologjinë estetike.

Kurani Famëlartë ka përdorur këto fjalë, që janë të lidhura me estetikën: *Bedi, xhemal, ihsan (ahsane), husn, husna, zinet, rish*. Këto fjalë janë përdorur më shumë për të shprehur bukurinë fizike dhe atë etike. Kurse fjalët *"ferah"*, *"surur"* etj., janë përdorur për të shprehur ndjenjën estetike.

Kurani flet për zbukurimin qiellor me yje (Mulk, 5), për bukurinë e krijimit të njeriut (Tin, 4), për bukurinë e kafshëve (Nahl, 8), për bukurinë femërore (Ahzab, 52) dhe për durimin, ndarjen dhe takimin e bukur. Veçanërisht, bukuria e botës bimore përmendet shpeshherë në Kuran. Sikur të shtojmë këtu edhe shpjegimet rreth bukurive të xhenetit, atëherë mund të arrijmë në një konkluzion rreth terminologjisë estetike të Kuranit.

Ky qëndrim kaq pozitiv ndaj së bukurës, natyrisht ka ndikuar shumë tek mendimtarët myslimanë. Veçanërisht, literatura e mistikës islame është një thesar më vete i estetikës islame. Mjafton të përmendim mendimtarin e madh mysliman Imam Gazzalin (vd. 1111), për të vërtetuar se si ka ndikuar kjo atmosferë kaq frymëzuese.

Gazzali thotë kështu: *"Gjithçka që është e bukur, dashurohet. Vetëm perceptimi i së bukurës, të jep kënaqësi. Pra, e bukura është një vlerë më vete."* (Ihja, IV/371)

Në një vend tjetër, Gazzali e ndan të mirën në tri pjesë: e dobishme, e këndshme dhe e bukur (xhemil). Në kapitullin e Mendimit, të Ihsasë, kur përshkruan bukuritë e krijimit të njeriut, Gazzali përmend me dhjetëra herë fjalët estetike *"ahsene"*, *"zejjene"* etj. (IV/126, 129)

Madje, është mjaft e njohur prova e rendit dhe qëllimit (prova teleologjike), për të vërtetuar ekzistencën e Zotit. Ky argumentim është dhënë nga Gazzali dhe është me plot kuptimin e fjalës një provë estetike e ekzistencës së Zotit. Shkurtime, me këtë provë ai thotë këtë:

Njeriu mjafton të pranojë ekzistencën e një Krijuesi, vetëm kur sheh estetikën, rendin dhe madhësinë e qiejve, tokës, kafshëve, shpendëve, insekteve, bimëve e pemëve dhe gjithçkaje që ekziston, frymore apo jofrymore, dhe bukurisë mahnitëse që ka njeriu jashtë dhe brenda vetes së tij. (IV/546; I/144) Kush sheh një pëlhurë të qëndisur bukur apo një pikturë të pikturuar bukur, komplimenton artistin e tyre. Si mund të ndodhë që një njeri të vërejë veprën mahnitëse që gjendet tek vetja e vet dhe tek qeniet e tjera dhe të mos mendojë për Krijuesin dhe Artistin e tyre?! (I/148; IV/545-546)

Prova estetike e Gazzalit drejton njeriun të dashurojë një Krijues, që meriton të dashurohet (xhemil). Ndaj, Ai ka *"Emra të bukur"* (Esmaul-husna). Burimi i marrëdhënies besim – dashuri gjendet pikërisht në një qasje të tillë hyjnore. Kurani thotë: **"Ata që besojnë, e duan shumë më tepër Allahun"** (Bekare, 165)





NAMAZI ME IMAM, NAMAZI I XHUMASË DHE NAMAZI I BAJRAMEVE

Të falurit e namazit me imam është *sunet* i fortë për meshkujt. Falja e namazit me xhemat ka vlerë më të madhe se sa të falurit vetëm. Për këtë, kemi argument *hadithin* e Pejgamberit (s.a.v.s.): "Namazi me xhemat është më i vlefshëm se ai që falet vetmas për njëzet e pesë herë".

Po ashtu, kur lexojmë disa *ajete* kuranore, vërejmë se ato na urdhërojnë të bëjmë *ruku* e *sexhde* me ata të cilët bëjnë *ruku* e *sexhde*.

Vlera e *thevabit* të xhematit arrihet edhe me një xhemat, qoftë fëmijë apo edhe grua. Sa më i madh të jetë numri i xhematit, më i madh është *thevabi*. Xhemati mund të formohet në shtëpi, xhami etj., mirëpo xhemati i formuar në xhami është më i vlefshëm. Është mirë të mos lihet xhemati pa arsye të justifikueshme.

Kushtet e imamit

Imami, përveçse duhet të jetë mysliman dhe i mençur, duhet të plotësojë këto kushte:

1. Imami duhet të jetë i hyrë në moshën madhore. Pa e plotësuar këtë kusht, nuk lejohet falja e namazit pas tij, si imam.
2. Të jetë mashkull.¹ Femra nuk lejohet t'u bëhet imam meshkujve.

1. Argument për këtë është hadithi: "Nuk lejohet që femra të bëhet imam për mashkullin". (Transmeton Ibn Maxhe)

3. Të të lexojë Kuranin mirë, që namazi të jetë i vlefshëm dhe të mos ketë pengesa në shqiptim. Po qe se imami ka pengesa, të cilat gjatë shqiptimit ia humbin kuptimin fjalës, nuk lejohet të bëhet imam.

4. Të mos jetë *sahibi udhër*². Kur personi është *sahibi udhër*, nuk lejohet t'u bëhet imam atyre që nuk janë *sahibi udhër*, ndërsa *sahibi udhëri* mund t'u bëhet imam atyre që janë si ai.

Kush është më i denjë për imam?

Namazi si obligim, mund të falet në shtëpi, në xhami e në vende të tjera. Kur namazi falet në shtëpi, më i denjë për të qenë imam është i zoti i shtëpisë ose ai, të cilit i jep leje i zoti i shtëpisë që të bëhet imam. E po qe se namazi falet në xhami, atëherë më i denjë për të dalë imam, është ai që është imam i rregullt në xhami, me përjashtim të rastit kur në xhami është udhëheqësi i myslimanëve-*halif* apo *muftiu*.

Kur nuk është asnjëri prej këtyre si *halif*, *muftiu* apo i zoti i shtëpisë, nëse namazi falet në shtëpi, atëherë më i denjë është ai person, i cili plotëson këto kushte:

1. I njeh më së miri rregullat-dispozitat e namazit.
2. Lexon mirë Kuranin.

2. Sahibi udhër është ai person që ka diçka që ndikon vazhdimisht për t'ia prishur dhe duhet të marrë abdest për çdo kohë të namazit.

3. Është më i devotshmi.
4. Ai që është më i moshuar, si respekt ndaj tij.
5. Ai që e ka zërin më të bukur.

Mekruh është të bëhet imam *fasiku*, ai që bën *bidate*, ai që është injorant dhe i verbëri.

Kur vlerësohen të gjitha këto, atëherë ai që plotëson më shumë nga këto kushte.

Kushtet që duhet të plotësohen për të qenë e vlefshme falja me imam:

1. *Nijeti*. Nuk kushtëzohet që, kur imami ua fal namazin meshkujve, të bëjë *nijet* se është imam i meshkujve, ndërsa, kur ndodh që në mesin e xhematit të ketë edhe femra, imami duhet doemos ta bëjë *nijet* se është imam edhe i femrave. *Nijeti* mjafton të jetë i bërë vetëm me zemër. Nuk kushtëzohet që imami të bëjë *nijet* se është imam edhe i femrave në namazin e xhumasë dhe të bajrameve.

2. Që muktediu të mos qëndrojë para imamit, por pas tij ose së paku, të jetë krah për krah me të. Po qe se *muktediu* qëndron para imamit, namazi i tij konsiderohet i prishur.

3. Që namazi i imamit të mos jetë në gradë me të ulët se namazi i muktediut. Kur ndodh që imami është duke falur namaz *nafile*, ndërsa *muktediu* i bashkohet për të falur namaz *farz*, muktediu duhet ta përsërisë këtë namaz, ngaqë kategoria e namazit të tij ka qenë më e fortë se e imamit. Nëse ndodh që namazi i *muktediut* është i kategorisë më të ulët se i imamit, atëherë namazi i *muktediut* konsiderohet i pranuar.

4. Që namazi *farz* të jetë i njëjtë, si i imamit edhe i muktediut. Doemos duhet që imami dhe muktediu të falin *farzin* e njëjtë, p.sh. imami është duke falur *farzin* e drekës edhe *muktediu* duhet ta falë *farzin* e drekës. Pra, nuk lejohet që imami të falë *farzin* e drekës e *muktediu* t'i bashkangjitet imamit për të falë *farzin* e ikindisë.

5. Që *musaliu* të mos jetë i vonuar në namaz e t'i bashkohet imamit tjetër për t'i vazhduar rekatet e mbetura. Nëse ndodh që *musaliu* është vonuar në namaz dhe e i ka kaluar ndonjë rekat pa falur, nuk duhet që, pasi imami i tij të kryejë namazin, t'i bashkohet ndonjë imami tjetër për ta plotësuar *rekat*in e kaluar.

6. Që *musaliu* të mos falet prapa femrës, edhe nëse ata të dy janë duke u falur prapa imamit të njëjtë. Nëse femra falet para mashkullit, namazi i mashkullit konsiderohet i prishur dhe, për këtë arsye, nuk lejohet që mashkulli t'i bashkohet imamit, nëse femra është në rresht para tij.

7. Imamin s'duhet ta ndajë prej muktediut ndonjë rrugë frekuentive. Nëse ndodh që xhemati të bëjë rreshta në rrugë dhe kështu të bëhet lidhshmëria e rreshtave, namazi është i vlefshëm. Por, nëse në mes rreshtave të xhematit gjendet ndonjë mur, saqë xhemati që mbetet prapa murit nuk mund ta dëgjojë imamin, atëherë namazi konsiderohet i prishur. Po qe se ka mjete të zmadhimit të zërit, atëherë namazi mund të vazhdohet dhe konsiderohet i vlefshëm.

8. Namazi është i vlefshëm, kur muktediu falet në sipërfaqen e jashtme të xhamisë, me kusht që zëri i imamit të dëgjohej nga ana e muktediut.

9. Kur ndodh të jenë grumbulluar një numër i madh i xhematit, muktediut i lejohet të bëjë sexhde në shpinë të muktediut tjetër, me kusht që namazi i xhematit të jetë i rangut të njëjtë.

Shënim:

Namazi është i vlefshëm, po qe se imami është me *tejmum* e *muktediu* është me *abdest*. Po ashtu, kur ndodh që imami t'i ketë larë këmbët, ndërsa *muktediu* u ka dhënë *mes'h* këmbëve, namazi është i vlefshëm.

Namazi konsiderohet i vlefshëm edhe kur imami është udhëtar e *muktediu* vendas, por është e rekomanduar që imami ta lajmërojë *muktediun* se është udhëtar dhe se do të japë *selam* në *rekat*in e dytë, në mënyrë që *muktediu* të ketë mundësi të vazhdojë *rekatet* e tjerë vetmas. Po ashtu, namazi është i vlefshëm, kur ndodh që imami të jetë vendas e *muktediu* udhëtar, por në këtë rast, *muktediu*, edhe pse është udhëtar, duhet t'i bashkohet imamit deri në fund dhe nuk duhet ta shkurtojë namazin.

Lejohet që *muktediu* të falet pas imamit, i cili është i sëmurë dhe nuk mund të qëndrojë në këmbë, por falet ulur. Po ashtu, lejohet që *muktediu* të falet prapa imamit i cili konsiderohet *fasik*: pi alkool, merret me kamatë etj., pavarësisht se ai konsiderohet mëkatar.

Nuk lejohet që *muktediu*, i cili nuk është *sahibi udhër*, të falet prapa atij që është *sahibi udhër*, ndërsa lejohet që *sahibi udhëri* të falet para atij që nuk është *sahibi udhër*. Po ashtu, lejohet të falet *sahibi udhëri* para atij që është *sahibi udhër*.

Disa veprime të muktediut, kur është duke u falur me imam

Muktediu mund të jetë: *mudrik*, *lahik* dhe *mesbuk*.

Mudrik: konsiderohet ai *musali*, i cili e ka arritur namazin prej fillimit me imamin dhe e ka vazhduar deri në fund.

Lahik: është ai *musali*, i cili e ka arritur namazin prej fillimit me imamin, por e ka ndërprerë namazin për ndonjë shkak të justifikueshëm, pastaj i është bashkuar prapë imamit. Por, kur t'i bashkohet imamit, plotëson vetëm ato *rekat*e që i kanë mbetur prej momentit kur ka ndërprerë namazin, ndërsa ato që i ka falur me imamin, nuk i plotëson.

Mesbuk: konsiderohet ai *musali*, i cili është vonuar, por e ka arritur imamin së paku pa dhënë *selam*. Ky do t'i plotësojë ato *rekat*e që i kanë kaluar pa i falur.

Si veprime të *muktediut*, mund të përmendim:

1. Kur *musaliu* hyn në xhami, por *ikameti* për t'u falur *farzi* është bërë ose është duke u bërë, *musaliu* duhet t'i bashkohet xhematit e jo të fillojë faljen e ndonjë *suneti*. Nga ky rregull bën përjashtim vetëm *suneti* i sabahut që, nëse *musaliu* mendon se mund ta arrijë imamin pa e përfunduar *farzin*, do të fillojë të falë *sunetin*, e nëse frikësohet se nuk mund ta arrijë, menjëherë i bashkohet xhematit.



2. Kur *muktediu* hyn në namaz ndërkohë që imami ka filluar leximin, atëherë *muktediu* e ka për obligim të heshtë dhe të mos lexojë as *subhaneken*.

3. Po qe se *muktediu* e zë imamin në *ruku*, ai duhet të drejtohet në *saff*, të bëjë *tekbirin* fillestar e pastaj të shkojë në *ruku* dhe, nëse e arrin imamin në *ruku* veç, e ka arritur *rekatin*.

4. Kur ndodh që *muktediu* të jetë *mesbuk*, ai duhet ta bëjë *tekbirin* fillestar e pastaj të shkojë t'i bashkohet imamit.

5. Është *mekruh*, që nëse *musaliu* është vonuar dhe kur sheh se xhemati është formuar të vrapojë, sepse në këtë rast, mund të shkaktojë hutim në mesin e xhematit. Rekomandohet që, kur të arrijmë për të hyrë në xhemat, edhe nëse jemi vonuar, duhet të ecim në mënyrë të qetë, qoftë edhe nëse kalon *rekati*. Për këtë, Pejgamberi (s.a.v.s.), ka thënë:

*"Kur të bëhet ikameti për t'u falur namazi, mos shkoni duke vrapuar, por duke ecur dhe të jeni të qetë (gjatë ecjes), atë çka e arrini prej rekateve, faleni e atë që ju ka kaluar pa e falur, plotësojeni."*³

6. Kur të arrijë *musaliu* dhe e gjen imamin ulur në *sexhde* ose duke shkuar në *sexhde*, ai duhet ta bëjë *tekbirin* fillestar e pastaj të shkojë duke bërë *tekbir* për t'u bashkuar imamit aty ku e ka zënë. Për këtë të tillë ka shpërblim, edhe epe *rekatin* nuk e ka arritur.

7. Kur ndodh që *musaliu* e ka zënë imamin në *ruku*, por imami ngrihet pa thënë ende *musaliu subhane rabijjel adhim*, *musaliu* do ta ndjekë imamin dhe nuk do të ndalet për të thënë *subhane rabijjel adhim*, ngase ndjekja e imamit është *vaxhib*, e thënia *subhane rabijjel adhim* është *sunet*.

8. Po qe se imami ngrihet apo jep *selam* para se *muktediu* të lexojë *teshehudin*, ai duhet ta lexojë *teshehudin* dhe pastaj ta ndjekë imamin dhe nuk duhet t'i lexojë as *salavatet* e as *duatë*, sepse leximi i tyre është *sunet* e ndjekja e imamit është *vaxhib*.

9. Kur imami bën *sehvi sexhde* edhe *muktediu*, duhet të bëjë *sehvi sexhde*, pavarësisht nëse *muktediu* e di arsye e të bërit *sehvi sexhde* apo jo.

10. Kur ndodh që imami ndalet duke lexuar dhe nuk i kujtohet çfarë të lexojë në vazhdim, *muktediu* ka të drejtë t'ia rikujtojë leximin, por, nëse imami ka lexuar aq sa mjafton për t'u kryer *rukni*, nuk ka nevojë rikujtimi, por imami duhet të shkojë në *ruku* dhe të vazhdojë namazin në mënyrë normale.

11. Po qe se imami jep *selam*, *muktediu* që është *mesbuk*, duhet t'i plotësojë *rekate* e mbetura, menjëherë pasi imami të ketë dhënë *selam*. Kur ndodh që *mesbuki* të ketë falur *rekatin* e tretë dhe të katërt me imam, kur të ngrihet për t'i plotësuar dy *rekate* e mbetura, duhet të lexojë *fatihanë* dhe *suren*.

NAMAZI I XHUMASË

Obligueshmërinë e namazit të xhumasë e vërejmë qartë nga ajeti:

"O ju që keni besuar, kur të thirret për t'u falur xhumaja, nxitoni ta përmendni Allahun dhe lini shitblerjen..."

3. Transmeton Buhariu dhe Muslimi.

Namazi i xhumasë është *farzi ajn* për çdo *mukel-lef* që është mashkull, i shëndoshë, vendës në qytet ku ka prijës ose gjykatës.

Xhumaja nuk konsiderohet obligim për:

1. fëmijët, të cilët ende nuk kanë hyrë në moshën madhore,
2. femrat, nuk e kanë obligim faljen e xhumasë,
3. i sëmuri, i verbëri, plaku i moshës së thellë, që nuk mund të shkojë vetë në xhami, dhe
4. udhëtari.

Kushtet e xhumasë

Për të qenë e vlefshme, xhumaja duhet të plotësojë këto kushte:

1. Xhumaja të falet në vendbanime. Të falet në atë vend, ku ka udhëheqës ose *kadi*.

2. Para faljes së namazit, të bëhet hutbeja. Namazi i xhumasë konsiderohet i pavlefshëm, nëse falet pa u bërë hutbeja.

3. Imami dhe hatibi të jetë vetë prijës i myslimanëve ose zëvendësi i tij apo person, të cilin e ka autorizuar vetë prijësi.

Autorizimin e imamit dhe hatibit e ka bërë prijësi i myslimanëve, por tani institucioni i *halifatit*, për fat të keq, nuk ekziston, kështu që autorizimin e bëjnë organet kompetente fetare të secilit vend⁴.

4. Xhumaja të jetë e lirë që ta falin të gjithë. Me këtë kusht, nënkuptohet se, nëse dikush prej njerëzve pengohet që të mos e falë xhumanë, namazi i xhumasë në këtë rast nuk është i vlefshëm.

5. Nuk kushtëzohet të ketë numër të madh të xhematit. Kërkohej që së paku, të jenë tre veta xhemat dhe imami, për t'u konsideruar namazi i xhumasë i vlefshëm. I këtij mendimi është Ebu Hanifja (r.a.), dhe imam Muhamedi (r.a.), ndërsa Imam Ebu Jusufi (r.a.), mendon që mjafton të jenë dy veta xhemat dhe imami, mirëpo mendimi i parë është më i pranuar.

6. Namazi i xhumasë të falet në kohën e namazit të drekës.

DISA RREGULLA TË VEÇANTA PËR XHUMANË

1. Kur të thirret *ezani* për të shkuar në namazin e xhumasë, duhet nxituar për namaz dhe duhet lënë shitblerjen.

2. Nuk është detyrim namazi i xhumasë, për atë që ka arsye të justifikueshme si, i verbëri, i sëmuri, mjeku kujdestar, i cili doemos duhet të jetë pranë pacientit, ai që ka frikë se do ta dëmtojë nxehtësia e madhe apo të ftohtit e madh. Po ashtu, xhumaja nuk është detyrim edhe për atë person që është në armiqësi me dikë dhe ka frikë se, po doli, do të vijë deri tek ndonjë problem serioz etj.

3. *Mekruh* është dalja nga qyteti pasi të jetë thirrur *ezani*, për atë person, i cili e ka detyrim xhumanë.

4. Kur imami është duke ligjëruar në *minber*, të falurit dhe të folurit konsiderohet *mekruh*. Për këtë, Pejgamberi (s.a.v.s.), ka

4. Në këtë rast tek ne, autorizimet i ka në kompetencë, Bashkësia Islame e Kosovës.

thënë:

*"Kur dikush prej jush hyn në xhami dhe imami është duke ligjruar në minber, nuk lejohet të falet namaz e as të flitet, derisa imami ta kryejë hutben"*⁵

5. Kush e arrin imamin në namazin e xhumasë, pa dhënë ende *selam*, duhet t'i bashkohet dhe, pasi imami të japë *selam*, ai duhet t'i falë dy *rekate* të xhumasë.

6. Ai i që nuk e ka arritur xhumanë, duhet ta falë namazin e drekës.

7. Po që se imami bën ndonjë lëshim, për të cilin duhet bërë *sehvi sexhde*, nuk duhet bërë *sehvi sexhde*, sepse ka numër të madh të xhematit.

8. Rekomandohet që në ditën e xhumasë, myslimani të pastrohet. Transmetohet nga Enes bin Maliku (r.a.), se Pejgamberi (s.a.v.s.), ka thënë:

"Kush ka marrë abdest, ka bërë mirë, ndërsa kush është larë është më mirë".

9. Është mirë që të vishen rrobat më të bukura dhe të përdoren erëra të mira.

10. Rekomandohet të shkohet në xhuma, para se imami të ketë hipur në *minber*.

11. Preferohet të mbulohet koka me ndonjë kapuç, kur të shkohet në xhami. Për këtë, mund të përmendim transmetimin e Amr bin Hurejthit, i cili ka treguar:

*"Në të vërtetë, Pejgamberi (s.a.v.s.), e mbajti hutben para njerëzve dhe në kokë kishte një kapuç të zi"*⁶

12. Nuk preferohet të veçohet vetëm dita e xhuma për të agjësuar.

Hutbeja e xhumasë

Kemi përmendur më lart se të mbajturit e *hutbes* është kusht për t'u plotësuar dhe konsideruar i plotë namazi i xhumasë. Nëse nuk bëhet *hutbeja*, namazi i xhumasë nuk është i kryer.

Ajo që më së paku duhet të shprehet në zbatimin e *hutbes*, është që të shprehet lartësimi dhe falënderimi ndaj Allahut (xh.sh.). *Hutbeja* e xhumasë përbëhet prej dy *hutbeve*; në mes dy *hutbeve* bëhet një ulje e shkurtër, sa të lexohen tri *ajete* të shkurtra. E pëlqyer është që, duke hipur shkallëve të *hutbes*, të hipet vetëm me këmbën e djathtë. Kur *hatibi* të ngrihet për të mbajtur *hutben*, duhet vepruar sipas *sunetit* të Pejgamberit (s.a.v.s.): të fillojë *hutben* me falënderim ndaj Allahut (xh.sh.), të shprehë dëshminë se Allahu është i vetëm, i pa shoq, po ashtu të konfirmojë se Muhamedi (a.s.), është pejgamber i Zotit dhe t'i dërgojë *salavate* atij e pastaj të hyjë në shpjegimin e temës për të cilën është përcaktuar *hatibi*.

NAMAZI I BAJRAMEVE

Namazi i bajrameve është *vaxhib* për atë, për të cilin është *farz* xhumaja. Pra, namazi i bajrameve është *vaxhib* për këta persona:

1. - Për atë që është mashkull. Femra nuk e ka *vaxhib* namazin e bajrameve.

2. - Ata që janë vendës në atë vend ku ka prijës, kadi apo myfti. Namazi i bajrameve nuk është *vaxhib* për atë që konsiderohet udhëtar dhe jeton në ato vende ku nuk ka prijës, kadi apo myfti.

3. - Që personi të mos jetë i sëmurë. Personi i cili është i sëmurë dhe nuk mund të shkojë në xhami, nuk e ka obligim faljen e

5. Transmeton Taberaniu në "el-Kebir".

6. Transmeton Myslimi.

namazit të bajrameve.

Koha e namazit të bajrameve

Namazi i bajrameve mund të falet afërsisht njëzet minuta pasi të ketë lindur dielli e deri para se të hyjë koha e namazit të drekës.

Mënyra e të falurit të namazit të bajrameve

Për namaze të bajrameve nuk këndohet *ezani* e as *ikameti*. Ky namaz përbëhet prej dy *rekateve*, njëlloj si namazi i sabahut, por dallon, se në këtë namaz është *vaxhib* të këndohen *tekbiret*. Këto *tekbire* këndohen në këtë mënyrë: tri *tekbire* këndohen pas leximit të *subhanekes* në *rekatin* e parë, pastaj lexohet *fatihaja* dhe *sureja*, ndërsa, kur të ngrihem në *rekatin* e dytë, pasi të lexohet *fatihaja* dhe *sureja* këndohen tri *tekbire*. Po që se *tekbiret* lexohen para leximit ose pas leximit, namazi konsiderohet i vlefshëm. Sa herë që të bëhen *tekbiret*, duhet të ngrihen duart.

Disa rregulla që kanë të bëjnë me namazin e bajrameve

1. Namazi i bajrameve ka *shartet* dhe *ruknet* si edhe namazet e tjera të zakonshme, mirëpo, nëse namazi i bajramit është duke u falur dhe *musaliu* nuk ka *abdest* dhe nuk i mjafton koha për të marrë *abdest*, atëherë, ai duhet të marrë *tejemmum*, për shkak se i është ngushtuar koha e faljes së bajramit.

2. Kur ndodh që *musaliu* të arrijë imamin pasi t'i ketë kryer *tekbiret*, *musaliu* do ta bëjë *tekbirin* fillestar e pastaj do t'i bëjë *tekbiret* e namazit të bajramit, pa lexuar fare *subhaneken*. Nëse e arrin imamin në *ruku*, po pati mundësi i kryen *tekbiret* dhe shkon në *ruku* e, nëse nuk mundet, i bën në *ruku*.

3. Po që se *musaliu* e arrin imamin në *rekatin* e dytë, ai duhet ta plotësojë *rekatin* duke i kënduar edhe *tekbiret*.

4. Kur ndodh që imami të këndojë më tepër se tri *tekbire*, *muktediu* duhet ta ndjekë *doemos* imamin.

5. Atij që i kalon namazi i bajramit pa e falur me imam, nuk duhet ta falë *kaza*.

6. Konsiderohet *mekruh* të falurit e namazeve *nafile*, qoftë në shtëpi apo në xhami, para se të falet bajrami. Po ashtu, *mekruh* është të falet *nafile* pasi të jetë falur bajrami në xhami, ndërsa në shtëpi, pasi të jetë falur bajrami, nuk është *mekruh* të falësh namaz *nafile*.

7. *Sunet* është që, pasi të falet bajrami, të mbahet *hutbeja*.

Këndimi i tekbirit të teshrikut

Me shprehjen *tekbiri teshrik* nënkuptohen ato *tekbire*, të cilat fillojnë të këndohen pas namazit të sabahut të ditës së *Arefatit*, d.m.th. natës së kurban bajramit dhe këto *tekbire* vazhdojnë të këndohen pas çdo namazi *farz* deri në *farzin* e ikindisë, të ditës së katërt.

Forma e *tekbirit teshrik* është kjo:

"Allahu është më i madhi. Allahu është më i madhi. Nuk ka zot tjetër, veç Allahut. Allahu është më i madhi. Allahu është më i madhi. Të gjitha falënderimet i takojnë Allahut".

Të kënduarit e *tekbiri teshrikut* është *vaxhib* vetëm një herë e, po që se këndohet më tepër, është *mustehab*. Gruaja kur të këndojë *tekbiri teshrikun*, duhet të këndojë me zë të ulët.

Hutbeja e bajrameve

Të mbajturit e *hutbes* është *sunet*. *Hutbeja* e bajramit përbëhet prej dy *hutbeve*, sikurse *hutbeja* e xhumasë. *Hatibi*, *hutben* e bajramit e fillon me *tekbire*.

IMAM MUHAMED SHEJBANI

KODIFIKUESI I LITERATURËS BAZË SË MEDHHEBIT HANEFI

Lindi në qytetin e Vasitit, në vitin 750. Pas themelimit të kalifatit abasi, familja e tij u shpërngul nga Vasiti dhe shkoi në Kufe. Muhamed Shejbani filloi të mësonte fik-hun, që në moshën 14- vjeçare, nga Ebu Hanife, deri në moshën 18 vjeç, kur Ebu Hanife vdiq. Më pas, mësimet e fikhut i mori nga nxënësit e tjerë të Ebu Hanifes, me në krye Ebu Jusufin.

Përveç mësimave të fikhut, Muhamed Shejbani merrte pjesë edhe në rrethet që mbanin muhadithët në Kufe. Pasi përfundoi mësimet në Kufe, Muhamed Shejbani u nis për në Medine, ku thelloi njohuritë e tij në fushën e hadithit. Aty qëndroi tre vjet dhe dëgjoi prej vetë imam Malikut veprën e tij, *Muvata*. Mësimet e tij në hadith i vazhdoi më pas, duke marrë pjesë në tubimet e hadithit të Sufjan b. Ujeines, në Mekë, të Evzaiut në Damask, të Abdullah b. Mubarekut, në Horasan dhe të dijetarëve të hadithit, në Basra. Pasi përfundoi udhëtimin tij për dije, u vendos të jetonte në Bagdad.

Aty u bë i famshëm për njohuritë e tij dhe studentë të shumtë vinin të merrnin pjesë në rrethet e tij të hadithit dhe të fikhut. Me njohuritë e gjera që kishte dhe stilin orator me të cilën shpjegonte, Muhamed Shejbani tërhoqte interesin dhe kureshtjen e të gjithëve, aq sa Bagdadasit filluan të preferonin të merrnin pjesë në rrethet e tij të dijes, më shumë sesa në rrethin e Ebu Jusufit. Me vdekjen e Ebu Jusufit, Muhamed Shejbani u bë udhëheqësi i shkollës së logjikës (ehli rej), në mesin e fakihëve.

Muhamed Shejbani jetoi gjatë sundimit të pesë kalifëve abasidë, prej të cilëve ai pati marrëdhënie vetëm me Harun Reshidin. Ndërmjetës për këtë miqësi mes tyre, qe bërë imam Ebu Jusufi, i cili ndërhyri që kalifi ta emëronte Muhamed Shejbanin si kadi në qytetin e Rakasë, qyteti ku kalifët abasidë kalonin verën. Vetëm se një bashkëbisedim mes Muhamed Shejbanit dhe kalifit Harun Reshid, në lidhje me kryengritjen e imamit zejdi Jahja b. Abdullah, bëri që kalifi të dyshonte se mos Muhamed Shejbani ishte përkrahës i pasardhësve të Aliut (r.a.) dhe dëshironte që ata të vinin në pushtet.

Kalifi urdhëroi që Muhamed Shejbani të shkarkohej nga detyra e kadiut të Rakasë, madje e ndaloi të jepte edhe fetva. Më vonë, kalifi kuptoi se kishte vepruar gabim dhe dyshimet e tij kishin qenë pa vend, kështu që e afroi prapë Muhamed Shejbanin, madje e shpalli atë kryekadi, kur ky post mbeti vakant me vdekjen e Ebu Jusufit. Në këtë detyrë, ai qëndroi deri sa vdiq, në vitin 805.

Ashtu si Ebu Jusufi, edhe imam Muhamed Shejbani pati arritur shkallën e muxhtehidit në njohuritë e shkencës së fikhut, por që të dy këto personalitete të jurisprudencës islame, do të pranohen si ndjekësit e Ebu Hanifes dhe dy imamët më të mëdhenj pas tij, për shkak të shërbimit që bënë në kodifikimin dhe përhapjen e medhhebit hanefi.

Studentët që ndoqën mësimet tek ai, u bënë brezi i juristëve klasikë hanefitë në historinë e së drejtës islame. Në mesin e tyre ishte edhe juristi i njohur islam, nxënësi i imam Malikut dhe autori i veprës së rëndësishme *Mudevene* në fikhun maliki, Esed b. Furati.

Shërbimi më i madh që bëri imam Muhamed Shejbani ndaj medhhebit hanefi, qe kodifikimi i së drejtës sipas kësaj shkolle. Veprat e tij janë burimet bazë të medhhebit hanefi. Veprat e tij kryesore qenë:

1. *el-Asl*. Kjo vepër njihet edhe me emrin *el-Mebsut*. Kjo vepër, të cilën Muhamed Shejbani e regjistroi përmes nxënësve të tij përpara se shpërngulej nga Kufe për në Bagdad, është raportuar nga shumë studentë të tij. *el-Asl* konsiderohet vepra më e vëllimshme dhe më e rëndësishme, e shkruar nga imam Muhamed Shejbani dhe përbën bazën më të madhe të literaturës hanefitë, që njihet me emrin *Dhahiru rivaje*. Vepra është hartuar në formën e pyetje-përgjigjeve, në lidhje me temat e së drejtës islame.

2. *Xhamiu sagir*. Muhamed Shejbani e pati shkruar këtë, si vepër në të cilën gjenden raportimet e Ebu Hanifes në fushën e fikhut, të cilat Muhamed Shejba-

ni i kishte mësuar nëpërmjet Ebu Jusufit. Në shumë vende të librit, autori ka regjistruar edhe pikëpamjet e tij apo të Ebu Jusufit, në lidhje me çështjet e fikhut, që raportoheshin nga Ebu Hanife.

3. *Xhamiul Kebir*. Në këtë vepër, përveç regjistrimit të pikëpamjeve juridike të medhhebit hanefi, Muhamed Shejbani ka dhënë edhe aspektin gjuhësor të së drejtës hanefite, duke nxjerrë në pah edhe njohuritë e tij të thella në gjuhën arabe.

4. *Zijadat*. Këtu janë regjistruar disa çështje, që nuk gjenden në veprat e mëparshme.

5. *Sijeru sagir*. Kjo vepër ka të bëjë me të drejtën ndër-kombëtare, më saktë, në marrëdhëniet mes kalifatit islam dhe mbretërive të tjera jomyslimane.

6. *Sijerul Kebir*. Kjo është vepra e fundit, e shkruar nga imam Muhamed Shejbani. Ajo është njëkohësisht edhe vepra e parë gjithëpërfshirëse në të drejtën islame, në lidhje me marrëdhëniet mes kalifatit dhe mbretërive të tjera, e cila nga aspekti i analizave juridike sipas shëriatit islam, është më e pasur sesa vepra *Asl*. Origjinali i veprës së Muhamed Shejbanit nuk ka mbërritur, por ajo njihet, falë veprës komentar (sherh), që juristi i mëvonshëm hanefi, Serahsi pati shkruar.

7. *Kejsanijat*. Kjo është një vepër me vëllim të vogël, që na ka mbërritur në ditët e sotme, në të cilën trajtohen shumë shkurtimisht zgjidhjet juridike, në lidhje me disa veprime të jetës së përditshme, në fushën e marrëdhënieve ndërpersonale.

8. *Meharixh fil hijel*. Vepra e parë që njihet deri më sot, e shkruar veçanërisht për çështjen e zgjidhjeve juridike (hijel). Megjithatë, autorësia e Muhamed Shejbanit, në lidhje me këtë vepër, është e paqartë ende. Një version i shkurtuar (muhtasar) i kësaj vepre, u përgatit nga juristi hanefi, Hakim Shehid, ndërsa një komentar i zgjeruar mbi këtë vepër, shkroi imam Serahsiu. Vepra flet për zgjidhjen e situatave delikate, që krijohen si rezultat i procedurave ligjore, të cilat mund të çojnë në marrjen e vendimeve të drejta de jure, por jo gjithmonë de facto. Pikërisht për të shpëtuar nga situata të tilla, në të drejtën islame njihen zgjidhjet juridike, që njihen si dredhitë juridike (hijeli sherije).

9. *Huxhexh ala ehli Medine*. Në këtë vepër janë përmbledhur çështjet e diskutuara mes tij dhe dijetarëve të Medinës, veçanërisht me imam Malikon. Vepra në fjalë është fryt i këtyre diskutimeve mbi çështje juridike. Në përgjithësi, në vepër jepen pikëpamjet e Ebu

Hanifes dhe të dijetarëve të Medinës. Për këtë arsye, kjo vepër njihet edhe me emrin tjetër, *Huxhexh fi ihtilafi ehli Kufe ve ehli Medine*.

10. *Athar*. Në këtë vepër janë përmbledhur hadithet, që imam Muhamed Shejbani raportoi prej Ebu Hanifes, ai prej mësuesit të tij Hamad b. Ebu Sulejman, ai prej Nehaiut, ai prej Abdullah ibn Mesudit. Në vepër janë dhënë edhe pikëpamjet juridike të Ebu Hanifes dhe të Nehaiut, me të cilat imam Muhamed Shejbani pajtohet në të shumtën e rasteve, me përjashtim të rasteve kur ai ndan mendim të ndryshëm nga dy imamët e tjerë. Pjesa dërrmuese e temave dhe haditheve që gjenden këtu, i përkasin të drejtës juridike, por ka edhe hadithe nga fusha e edukatës së përgjithshme dhe të akaidit.

11. *Muvata Imam Malik*. Kjo vepër është versioni i raportuar nga imam Muhamed Shejbani, i veprës *Muvata* të imam Malikut, gjatë qëndrimit trevjeçar në Medine. Ky version i *Muvatasë* është i rëndësishëm, sepse aty gjenden përveç haditheve, të transmetuara nga imam Maliku edhe disa raportime të muhadithëve irakenë dhe nga Hixhazi, si dhe pikëpamjet juridike të imam Muhamed Shejbanit. Raportimet e regjistruara nga imam Muhamed Shejbani, janë hadithe që mbështesin pikëpamjet juridike të shkollës së logjikës (ehli rej) dhe jepen si alternativë ndaj raportimeve të shkollës tradicionale të Medinës, të përfaqësuar nga imam Maliku. Në këtë mënyrë, vepra është nga punimet e para të së drejtës së krahasuar islame.

Gjashtë veprat e para të imam Muhamed Shejbanit formojnë literaturën bazë të së drejtës hanefi dhe njihen si raportimet e qarta (dhahiru rivaje), sepse janë raportuar nga persona të ndryshëm, ndërsa veprat që kanë mbetur të vetme në transmetimin e tyre nga imam Muhamed Shejbani, njihen në literaturën juridike hanefi, si raportimet e rralla (nadiru rivaje). Juristi i njohur hanefi, Hakim esh-shehid el-Mervezi, i përmbledhi dhe i sistemoi çështjet juridike që ndodhen në literaturën *Dhahiru rivaje*, në veprën e tij *el-Kafi*, ndërsa juristi tjetër eminent hanefi, Shemsuleime Serahsi, e komentoi këtë vepër në librin e tij të titulluar *el-Mebsut*.

Pjesa më e madhe e veprave të njohura të imam Muhamed Shejbanit u botuan nga Ebu Vefa el-Efgani. Megjithatë, një punë më e madhe pret të kryhet, në mënyrë që të realizohet një botim kritik i këtyre veprave, që përbëjnë literaturën bazë të njërës prej shkollave më të njohura juridike islame, medhhebit hanefi.

Vlera e punës në Islam

Nëse ne si myslimanë kërkojmë dhe dëshirojmë më të mirën për veten dhe për njerëzimin mbarë, atëherë duhet të ndërjegjësohemi edhe më shumë që secili ta fillojë ndryshimin, së pari nga vetja e tij. Zhvillimi dhe përparimi i vendit tonë kërkon punë dhe sakrificë. Allahu (xh.sh.), nuk ia përmirëson situatën në të cilën ka rënë popullit përtac, të plogësht, i cili nuk e do punën.

Pejgamberi (a.s.), lutej: "O Zot! Të lutem të më mbrosh nga hallet dhe shqetësimet, nga paaftësia dhe përtacia!" Sahabët, shokët e Pejgamberit (a.s.), tregonin se Pejgamberi (a.s.), e bënte shpesh këtë lutje. Këtë lutje Pejgamberi (a.s.), e bëri pasi një ditë prej ditësh hyri në xhami dhe gjeti aty Ebu Umamen në një kohë, përjashta kohës së namazit. Kur e pa në xhami, Pejgamberi (a.s.), u mërzi. Përse duhej të qëndronte në xhami në një kohë që ishte kohë pune dhe jo kohë namazi?!

Kur e pa Ebu Umamen ashtu vetëm në xhami në kohë pune, Pejgamberi (a.s.), e pyeti atë me habi:

- Çfarë të ka sjellë këtu në këtë orë, o Ebu Umame?

Ai iu përgjigj:

- O i Dërguari i Allahut! Borxhet dhe hallet e shumta që kam.

Atëherë Pejgamberi (a.s.), i tha:

- O Ebu Umame! Kërko prej Zotit mbrojtje nga përtacia!

Pastaj i mësoi fjalët dhe lutjen e mësipërme. Pejgamberi (a.s.), sikur dëshironte t'i thoshte: "Shko puno! Kjo është kohë pune dhe nuk është kohë për të qëndruar në xhami." Me lutjen që i mësoi, Pejgamberi (a.s.), synonte t'ia ndryshonte mentalitetin këtij personi, dëshironte ta nxirrte atë nga dembelizmi, që

ai të bëhej aktiv dhe të punonte. Borxhet dhe hallet nuk mund të zgjidhen vetëm duke thënë: "O Zot më mbro nga dembelizmi" dhe të mos përpiqesh të bësh asgjë për të mirën dhe avancimin e vetes, familjes dhe shoqërisë.

Kur Pejgamberi (a.s.), u takua me një burrë, i cili i kishte duart gjithë kallo dhe me plagë nga puna që kishte bërë, ia kapi duart, e ngriti lart dhe tha: "Një dorë të tillë, do Allahu."

Dijetari i njohur mysliman, Muhamed Sharavij thotë: "Ai që nuk ushqehet me atë që fiton nga puna e tij, nuk mund të marrë vendime me mendjen e tij".

Mënyra se si prezantohen nganjëherë në literaturë dhe botime të ndryshme sahabët, shokët e Pejgamberit (a.s.), të lë përshtypjen e gabuar, sikur ata qëndronin gjithë ditën me Pejgamberin (a.s.) dhe nuk merrshin me asgjë tjetër. Vetë Omer Ibn Hattabi (r.a.), tregon: "Unë kam pasur një parcelë toke që e mbillja. Punën që duhej të bëja në parcelë, e ndaja me një mikun tim. Unë shkoja një ditë për të punuar, ndërsa shoku im merrte pjesë në xhami në faljen e namazeve. Të nesërmen, unë merrja pjesë në xhami gjatë faljeve, kurse ortaku im kryente punët e duhura tek toka. Çdo ditë, pas namazit të sabahut, i tregonim njëri-tjetrit mësimet e Pejgamberit (a.s.) dhe të rejat nga parcela."

Për Ebu Bekrin (r.a.), tregohet se e ka shpenzuar tri herë në rrugën e Zotit të gjithë pasurinë që kishte. Nëse nuk do të merrej me punë dhe tregti, nga do ta merrte Ebu Bekri pasurinë që do ta shpenzonte për bamirësi!

Të parët tanë kanë thënë: "Besimi nuk është me fjalë, as me veshje, por besimi është në zemër dhe atë e vërteton puna". Ka mbi 70 ajete në Kuranin famëlartë, ku fjala besim shoqërohet me fjalën veprim, punë.

Puna dhe veprimtaria është obligim për çdo besimtar dhe vetëm ato mund ta vërtetojnë se sa besimtar je.

Islami nuk është streha e njerëzve përtacë, që thonë: “Ne presim rizkun prej Zotit, s`ka kush ta marrë rizkun tonë” dhe ulen e presin që rizku t`u vijë vetë.

Omer ibn Hattabi (r.a.), pasi fali namazin, pa një grup njerëzish që nuk u ngritën për të dalë e për të punuar, por qëndruan ulur në xhami. Omeri (r.a.), i pyeti: “Po ju, pse nuk dilni të punoni”? Ata iu përgjigjën me krenari: “Ne i mbështetemi Zotit, prandaj nuk kemi frikë për rizkun tonë. Rizku do të na vijë, kudo që të jemi”. Atëherë Omeri (r.a.), u përgjigj ashpër: “Ngrihuni dhe dilni, sepse ju nuk i jeni mbështetur Zotit, por jeni parazitë në tokë. Ngrihuni dhe punoni, se qielli nuk do të lëshojë as flori dhe as argjend”. Pasi tha këto fjalë, i nxori nga xhamia.

Omeri (r.a.), ka thënë: “Dua që, kur vdekja të vijë të më marrë, të jem duke bërë njërën prej këtyre dy gjërave: ose të jem në luftë në rrugën e Zotit, ose duke punuar për të siguruar jetesën.”

A dini ndonjë ditë të javës, të cilën besimtarët e kanë vetëm për adhurim dhe jo për punë?! Unë nuk di ndonjë ditë të tillë. Dita e xhuma është dita më e shenjtë që kemi, por ajo është ditë pune si gjithë ditët e tjera, prandaj njëri e dëgjon ezanin duke qenë në dyqanin e tij, tjetri e dëgjon ezanin duke punuar e kështu me radhë. Allahu (xh.sh.), në Kuranin famëlartë thotë:

“Kur të përfundojë namazi, atëherë shpërndahuni nëpër tokë, kërkonin për begatitë e Allahut dhe përmendeni shumë Allahun...”. **(Xhuma, 10.)**

Xheneti, që e duam aq shumë, nuk fitohet me fjalë, por me punë. Sa herë që Zoti përmend Xhenetin në Kuran, thotë:

“...Ky është shpërblimi për atë që punuat”. **(Zuhruf, 72.)**



*Omer ibn Hattabi (r.a.)
pasi fali namazin, pa një grup njerëzish
që nuk u ngritën për të dalë e për të punuar,
por qëndruan ulur në xhami.*

*Omeri (r.a.), i pyeti: “Po ju,
pse nuk dilni të punoni”?
Ata iu përgjigjën me krenari:
“Ne i mbështetemi Zotit,
prandaj nuk kemi frikë për rizkun tonë.*

*Rizku do të na vijë, kudo që të jemi”.
Atëherë Omeri (r.a.), u përgjigj ashpër:
“Ngrihuni dhe dilni, sepse ju
nuk i jeni mbështetur Zotit,
por jeni parazitë në tokë.*

*Ngrihuni dhe punoni,
se qielli nuk do të lëshojë
as flori dhe as argjend”.*

Shëndoshja në mënyrë të shëndetshme

Duket e pabesueshme, por në të kundërtën e preparateve për t'u dobësuar, në treg nuk ekziston asnjë preparat për t'u shëndosur. Megjithatë, ekzistojnë metoda, të cilat mund të aplikohen për të arritur rezultatet e kërkuara.

Arsyet e dobësimit mund të jenë metabolizmi i shpejtuar, jeta me stres, problemet me absorbimin e ushqimit, hiperaktiviteti, depresioni, ushtrimet e tepruara, çrregullimet e ushqimit, si anoreksia dhe bulimia, hipertireoza dhe ushqimi jo i balancuar.

Nëse keni metabolizëm të shpejtë, do të ndihmojë më shumë në rritjen e konsumimit të ushqimeve të shëndetshme, disa herë gjatë ditës. Hani gjashtë vakte në ditë, por më të vogla dhe rrisni konsumin e karbohidrateve.

Rregullat e ushqimit të shëndetshëm, duhen ndjekur edhe kur dëshironi të shëndosheni. Kjo do të thotë që duhet të hani në mënyrë të rregullt dhe gjatë çdo vakti të konsumoni ushqime që përmbajnë niseshte, siç janë pastat, patatja dhe orizi. Pastaj, hani shumë fruta dhe perime, fruta arnore dhe fara. Gjithashtu, çdo ditë konsumoni vitaminë B12.

Shtoni numrin e kalorigave në vaktet e ushqimit tuaj,

duke përdorur

vaj kualitativ, si ai i ullirit. Nëse vazhdimisht jeni të nënshtruar ndaj stresit në punë ose në shtëpi, duhet të përballeni me këtë problem, duke u konsultuar me psikologun, i cili do t'ju ndihmojë të përballeni më mirë me sfidat e përditshme.

Nëse problemi juaj është absorbimi i ushqimit, mjeku do t'ju ndihmojë në përshkrimin e ilaçeve të nevojshme, të cilat përshpejtojnë tretjen. Është i gabuar besimi që duhet të ushtrojnë vetëm ata që dëshirojnë të dobësohen. Aktiviteti i lehtë fizik është i dobishëm edhe për të dobëtit, nëse bëhet si duhet.



Teknologjia dhe shëndeti

Hulumtuesit shpjegojnë se, përdorimi i tepërt i teknologjisë, mbingarkon trurin e individëve me stimuj emocionalë dhe vizualë shumë të fuqishëm, të cilët e pengojnë organizmin dhe trurin tonë të kryejë një gjumë të qetë e të plotë dhe e detyrojnë atë të qëndrojë gjithnjë e më shumë zgjuar.

Çrregullimet e gjumit ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e shëndetit dhe jetës së individit. Shumica e njerëzve mendojnë se gjumi është pjesa më pasive e kohës. Mirëpo, shkencëtarët, të cilët studiojnë procesin e gjumit, pohojnë se ai është një proces aktiv dhe tejet i dobishëm për organizmin. Ata theksojnë se gjumi është një element shumë i rëndësishëm për jetën e përditshme, sidomos në çështjen e akumulimit të energjive, në atë të rregullimit të peshës trupore, në procesin e të menduarit, medituarit, rritjen e përqendrimit dhe aftësimin e komunikimit.

Sipas shkencëtarëve, prishja e regjimit të gjumit ndikohet drejtpërdrejt nga llojet e aktiviteteve që ne kryejmë përpara se të flemë. Ky kërkim nxori në pah se personat që përdorin shumë mjetet e teknologjisë së lartë, flenë më pak sesa u nevojitet dhe preken më shumë nga pagjumësia, sëmundjet fizike dhe mendore.

Filmi "Armagedon" mund të bëhet realitet

Një ekip astronautësh janë duke u trajnuar për një mision që ka të bëjë me uljen dhe eksplorimin e sipërfaqes së një asteroidi, për të studiuar sipërfaqen e tij, për të kërkuar minerale, si dhe për të studiuar mundësitë e shkatërrimit të tyre, nëse ata përbëjnë një kërcënim për tokën.

Vizita në një asteroid është pjesë e qëllimeve afatgjata të NASA-s, të dërgimit të njerëzve në Mars dhe do të jetë një nga misionet më të guximshme deri me sot, duke i dërguar astronautët shumë me tutje se sipërfaqja e Hënës. Ndërsa planet për udhëtim janë ende në fazat fillestare, siguria që astronautët të jenë të aftë dhe të gatshëm kur të vijë koha, është një konsideratë e rëndësishme.

"Me teknologjinë që kemi në dispozicion dhe që

është duke u zhvilluar, një mision në një asteroid, të paktën për një kohë njëvjeçare është padyshim i arritshëm,"- tha Majori Tim Peake, një ish pilot i cili është një nga astronautët që po trajnohen. "Asteroidet janë interesante, sepse në thelb, ata janë të dhëna historike miliardave të universit tonë, nga ku ne mund të marrim mostra."



Shkencëtarët kanë zhvilluar adn-në artificiale

Në një laborator, është realizuar një material gjenetik artificial, që mund të zhvillohet dhe të ruajë informacione si të ADN-së.

Hulumtuesit në Laboratorin MRC, të Biologjisë Molekulare në Kembrixh, kanë arritur një qëllim që mund të hedhë dritë se si molekulat e para janë mbledhur për të krijuar format e jetës miliarda vjet

më parë. "Ndërtimi i sistemeve gjenetike, bazuar në platformat kimike alternative, mund të çojë në sintezën fillestare të formave të jetës,"- tha Gerald Joyce i Institutit të Kërkimeve Scripps.

Shkencëtarët shpresojnë se zhvillimi i kësaj ADN-je alternative, mund të ndihmojë në kërkime të mëtejshme mbi mjekësinë dhe biocenologjinë. Shkencëtarët në Laboratorin MRC të Biologjisë Molekulare në Kembrixh, kanë zhvilluar procese kimike për ta kthyer ADN në ARN, shenjat molekulare të të gjithë jetës në Tokë, në gjashtë polimere alternative gjenetike e njohur si XNA.

Për çdo minutë në internet

- Në të gjithë botën, dy milion kërkime në motorin e kërkimit Google.
- Në You Tube vendosen tridhjetë deri në gjatëdhjetë orë video të reja. Ndërsa videot në këtë shërbim, shikohen mesatarisht 1,3 milion herë.
- Në rrjetin social Facebook bëhen gjashtë milion klikime, ku prej tyre janë 277.000 hyrje në rrjet brenda një minute.
- Në Twitter regjistrohen së paku 320 shfrytëzues të rinj dhe 100.000 cicërima të reja.
- Dërgohen 204 milion e-mail.
- 135 pajisje infektohen me ndonjë lloj virusi keqbërës.
- Ndodhin rreth njëzet vjedhje identiteti.

Sot numri i pajisjeve që përdorin Internet, është i njëjtë me numrin e njerëzve, pra 7 miliardë. Deri në vitin 2015, parashikohet që numri i këtyre pajisjeve të dyfishohet. Deri në vitin 2015, do të na duhen plot pesë vjet të shikojmë të gjithë video-materialin që dërgohet përmes internetit vetëm në një sekondë.



Kryeparlamentari turk vizitoi Shqipërinë

Kryetari i Kuvendit të Madh Popullor të Turqisë, Xhemil Çiçek, muajin e kaluar zhvilloi një vizitë zyrtare në Tiranë me ftesë të Kryetares së Kuvendit të Shqipërisë, Jozefina Topalli.

Kryeparlamentari turk dhe delegacioni i parlamentarëve që e shoqëronin zhvilluan një sërë takimesh në Shqipëri. Fillimisht ai u takua me Kryetaren e Parlamentit të Shqipërisë, Jozefina Topalli, në selinë e Kuvendit me cilën folën për marrëdhëniet vëllazërore midis dy vendeve.

Çiçek tha se paqja dhe stabiliteti në Ballkan është shumë i rëndësishëm për nga ana e këndvështrimit të tyre dhe shtoi se Shqipëria është një vend kyç për sigurimin e tyre. Kryetari i Parlamentit të Turqisë foli qartë edhe në lidhje me pavarësinë e Kosovës dhe dha mesazhin se “ne jemi pranë shqiptarëve”. Ai ndër të tjera tha: “Me në krye Kosovën, Turqia është duke përparuar së bashku me vëllazërit shqiptarë në shumë çështje”.

Çiçek, u takua edhe me Presidentin e Shqipërisë Bamir Topi dhe më pas realizoi një takim me dyer të mbyllura për shtypin me Kryeministrin e këtij vendi, Sali Berisha.

Programi e tyre vijoi me vizitën në Universitetin turk në Tiranë, EPOKA ku ai mbajti një fjalim të shkurtër për studentët dhe shprehu kënaqësinë që ndjen për shkollat turke të hapura në Shqipëri.

Kryetari i Asamblesë së Madhe Kombëtare të Turqisë, Xhemil Çiçek, i shoqëruar nga pjesëtarë të delegacionit turk, në vijim të programit vizituan edhe qytetin e Shkodrës, ku fillimisht u takua me kryetarin e bashkisë, Lorenc Luka si edhe drejtues të tjerë të qeverisjes vendore.

Gjatë takimit me kryebashkiakun Luka, kryeparlamentari turk Çiçek vlerësoi Shkodrën si një qytet i veçantë,

me vlera të shumta historike. Duke folur për marrëdhëniet mes dy vendeve, ai tha se produkt i kësaj marrëdhënie të mrekullueshme është edhe shtimi i punës dhe investitorëve turq në Shqipëri.

“Ne dëshirojmë t’i zhvillojmë sa më shumë këto marrëdhënie, sepse ato janë në të mirë të të dy vendeve tona, në të mirë edhe të rajonit”, tha z. Çiçek.

Më pas, delegacioni turk bëri homazhe dhe vendosi lule pranë memorialit të dëshmorit Hasan Riza Pasha, figura e të cilit vlerësohet për kontributin e dhënë në ruajtjen e kufijve të Shqipërisë, duke luftuar deri në vdekje për mospushtimin e Shkodrës nga forcat e atëhershme malazeze.

Kryetari i Asamblesë së Madhe Kombëtare të Turqisë, Çemil Çiçek, bëri më pas një xhiro në këmbë përgjatë rrugës kryesore të qytetit të Shkodrës, ndërsa u ndal edhe në Qendrën Kulturore Turke “Junis Emre”, e dyta pas asaj të Tiranës, e hapur tre muaj më parë në qytetin verior. Duke e vlerësuar hapjen e kësaj qëndre, Kryetari i Asamblesë së Madhe të Turqisë, Xhemil Çiçek, tha se “vizita në qendrën kulturore është mjaft e rëndësishme dhe do t’i japë një dimension të ri marrëdhënieve kulturore mes dy vendeve”.



Putini mbështet qëndrimet e Serbisë ndaj Kosovës



Serbia nuk e ka ndërmend të njohë Kosovën si shtet të pavarur, ka thënë presidenti i zgjedhur serb, Tomislav Nikolliq.

“Ne nuk mund ta njohim Kosovën, edhe me kushtin e ndërprerjes së negociatave me Bashkimin Evropian. Megjithatë, unë nuk kam

dëgjuar se duhet njohur Kosovën, para se t’i bashkohemi BE-së”, ka thënë Nikolliq, transmeton DPA.

Ai i ka bërë këto komente në Moskë, gjatë takimit me presidentin rus, Vladimir Putin. Ky i fundit ka premtuar se do të vazhdojë të mbështesë qëndrimet e Serbisë ndaj Kosovës. Putin po ashtu është zotuar se do të lëshojë 800 milionë dollarë kredi për Serbinë.

“Ne e shohim Serbinë jo vetëm si partner tonin tradicional dhe shumë të rëndësishëm në Ballkan, por serbët janë edhe vëllazërit tanë shpirtëorë”, ka thënë Putin.

Ish-ultranacionalisti serb është zotuar se do të vazhdojë të ndjekë rrugën evropiane për Serbinë, porse, në të njëjtën kohë, do të vazhdojë të mbajë edhe lidhjet tradicionale të forta me Rusinë.